



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 419/11 prot.

Tiranë, më 16.01. 2026

URDHËR
Nr. 17, datë 16.01. 2026

PËR
MIRATIMIN E STANDARDEVE PROFESIONALE TË MËSUESIT PËR SHKOLLAT
ARTISTIKE ME STATUS TË VEÇANTË, DEGA: BALET, ART FIGURATIV DHE
MUZIKË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shkronjës "d" të pikës 5, të kreut III të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar", të pikës 8 të vendimit nr. 149, datë 13.03.2024 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve të posaçme dhe procedurave për dhënien e statusit "Shkollë me status të veçantë"", si dhe urdhrit nr. 578, datë 11.11.2025, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit, znj. Orjana Osmani",

URDHËROJ:

1. Miratimin e standardeve profesionale të mësuesit për shkollat artistike me status të veçantë, dega: balet, art figurativ dhe muzikë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Politikave të Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe shkollat artistike me status të veçantë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTËR

ORJANA OSMANI






STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT

Për shkollat artistike me status të veçantë

Dega: Art figurativ



Tiranë, 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

I. PJESA E PARË: TË PËRGJITHSHME	3
1.1 Hyrje	3
1.2 Përse kanë rëndësi këto standarde?.....	3
1.3 Struktura e standardit.....	5
II.PJESA E DYTË: STANDARDET PROFESIONALE TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM ARTISTIK TË MËSUESIT.....	6
Standardi 1. Njohja dhe zbatimi i dokumenteve arsimore.....	10
Standardi 2. Përgatitja shkencore: Dega Art Figurativ.....	11
Standardi 3. Kurrikula artistike dhe mësimdhënia	12
Standardi 4. Vlerësimi	14
Standardi 5. Zhvillimi profesional dhe personal	15
Standardi 6. Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët.....	16
Standardi 7. Bashkëpunimi me komunitetin.....	18
Standardi 8. Mjedisi mësimor.....	19
III.PJESA E TRETË: STANDARDET PROFESIONALE TË VETËVLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË MËSUESIT.....	21
3.1 Përshkrimi i përgjithshëm i niveleve	21
3.2 Vetëvlerësimi për standardet e përgjithshme profesionale	24
IV.PJESA E KATËRT: STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT SIPAS TRE GRUPE LËNDËSH: TEORIKE - ARTISTIKE, TEORIKE – PRAKTIKE, SPECIALITETET	26

I. PJESA E PARË: TË PËRGJITHSHME

1.1 Hyrje

Standardet profesionale të mësuesit të shkollës artistike me status të veçantë, dega Art Figurativ, përshkruajnë kriteret që priten nga mësuesit e kësaj fushe. Përmes këtyre standardeve, shkolla krijon kushte dhe mundësi që nxënësi:

- të ndërtojë dhe të zhvillojë kompetencat artistike në degën Art Figurativ, nëpërmjet lëndëve të kurrikulës artistike: teorike artistike, praktike artistike dhe specialiteteve të ndryshme, në përputhje me nevojat dhe interesat e shoqërisë;
- të zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe të gjithanshme;
- të kontribuojë në ndërtimin dhe në mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare;
- të përballë në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Standardet profesionale të mësuesit për shkollën artistike me status të veçantë kërkojnë që zhvillimi profesional i mësuesve të fokusohet fuqishëm në përmirësimin e rezultateve të nxënësve. Të gjithë mësuesve u ofrohen mundësi për të marrë pjesë aktive në zhvillimin profesional, duke u mundësuar rritje të vazhdueshme dhe përkushtim ndaj progresit dhe suksesit të nxënësve në fushën e artit figurativ. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional, i orientuar drejt standardeve dhe treguesve të matshëm, ndihmon mësuesit të përmirësohen në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të vlerësojnë ecurinë e realizimeve të tyre artistike dhe profesionale si mësues. Dokumenti i standardeve profesionale të mësuesit të shkollës artistike me status të veçantë, dega Art Figurativ, i hartuar nga grupi i punës dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), përmban:

1. Standardet profesionale dhe kriteret e **formimit të përgjithshëm** të mësuesit të shkollës artistike me status të veçantë, dega Art Figurativ;
2. Standardet profesionale dhe kriteret sipas **specifikave të kurrikulës artistike** për mësuesin, të ndara sipas lëndëve;
3. Standardet profesionale dhe kriteret për mësuesin, të ndara sipas lëndëve.

1.2 Përse kanë rëndësi këto standarde?

Rëndësia e standardeve profesionale të mësuesit për shkollën artistike me status të veçantë, dega Art Figurativ, qëndron në faktin se ato përshkruajnë çfarë pritet të dijë, të kuptojë, të zotërojë dhe të demonstrojë mësuesi si specialist në fushën dhe lëndën e tij,




bazuar në kurrikulën artistike. Standardet profesionale për mësuesit e shkollës artistike me status të veçantë vlejné, para së gjithash, për vetë mësuesin. Ky dokument e ndihmon atë të vlerësojë performancën e tij në mësimdhënien artistike, duke identifikuar anët e forta dhe nevojat për përmirësim, si dhe për të kuptuar më mirë progresin e tij profesional, pedagogjik dhe artistik pra, për t'u vetëvlerësuar. Përmes standardeve profesionale të mësuesit jepet një vizioni i qartë **për mësimdhënien**, një panoramë e objektivit ku duam të arrijmë. Ato përfshijnë një sërë treguesish të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve, si në aspektin pedagogjik ashtu edhe në atë artistik, përmes të cilave mësuesi **angazhohet** për të përmbushur me sukses rolin e tij. Çdo profesionist punon duke u mbështetur në këto standarde që tregojnë nivelin e kompetencës në punë. **Nivelet e performancës pedagogjike dhe artistike** pasqyrojnë mënyrën se si një mësues, në secilën lëndë apo specialitet të degës Art Figurativ, arrin të përmbushë këto standarde. Mësuesi që ka të qartë objektivin e punës, angazhohet në mënyrë të qëndrueshme për rritje dhe zhvillim profesional. Duke qenë se mësues të ndryshëm kanë nevoja dhe fusha të ndryshme trajnimi, përmbushja e standardeve i mbështet ata në progresin e tyre në karrierë dhe në procesin e kualifikimit. Mësuesi që arrin një performancë të kënaqshme dhe rezultate të larta në kualifikim ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Standardet profesionale të mësuesit në shkollat artistike me status të veçantë i vijnë në ndihmë edhe drejtuesit të institucionit arsimor për: përmbledhjen e nevojave profesionale të stafit; hartimin dhe zbatimin e planeve për zhvillim profesional. Gjithashtu, standardet pedagogjike dhe artistike i shërbejnë drejtuesit të shkollës për:

- vlerësimin periodik të performancës së mësuesve;
- kuptimin dhe monitorimin e zhvillimit profesional të tyre;
- identifikimin dhe porositjen, së bashku me mësuesit, të formave më të përshtatshme të zhvillimit profesional dhe të literaturës përkatëse për këtë qëllim.

Përzgjedhja e një mësuesi për të punuar në një institucion arsimor artistik duhet të bazohet në përgjigjen e pyetjes: **"Në çfarë mase kandidati përmbush të dyja llojet e standardeve të mësuesit, ato pedagogjike dhe ato artistike?"**

Këshilli i mësuesve, ekipet lëndore dhe komisioni psikosocial mund t'i përdorin këto standarde për të përmirësuar klimën në shkollë dhe cilësinë e procesit mësimor. Ato shërbejnë gjithashtu për të përcaktuar temat e diskutimeve profesionale dhe për të analizuar arritjet e nxënësve. Përfaqësuesit e komunitetit të shkollës, si bordi dhe këshilli





i prindërve, mund t'i shqyrtojnë këto standarde për të kuptuar më mirë cilësinë e shërbimit arsimor që ofron institucioni.

Ministria e Arsimit mbështetet në këto standarde për të hartuar politikat mbarëkombëtare të zhvillimit profesional të mësuesve që zbatojnë kurrikulën artistike. Ajo i përdor standardet gjithashtu për të përgatitur udhëzime, urdhra dhe rregullore që lidhen me mësuesit. Kualifikimi dhe trajnimi i tyre bazohet pikërisht mbi këto standarde. **Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)** identifikon nevojat për zhvillim profesional të mësuesve të Artit Figurativ në shkollat artistike me status të veçantë, harton programe dhe module trajnimi në nivel kombëtar dhe përgatit modele për vlerësimin e performancës së mësuesit.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) i mbështet mësuesit në përmbushjen e këtyre standardeve përmes procesit të vlerësimit të jashtëm të performancës. **Njësitë arsimore vendore (DRAP/ZVA)**, të mbështetura në standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe ato sipas profileve artistike, hartojnë planet e zhvillimit profesional të mësuesve dhe planifikojnë veprimtaritë e rrjeteve profesionale.


Fakulteti i Artit Figurativ i referohet këtyre standardeve për të hartuar në mënyrë të koherentë standardet e formimit fillestar të mësuesve, përmes kurrikulës së formimit shkencor dhe artistik. Ky fakultet përgatit studentët jo vetëm për procesin e licencimit, por edhe për zhvillimin e tyre profesional afatgjatë.

Këshillat dhe shoqatat e mësuesve marrin parasysh të dy llojet e standardeve për të identifikuar nevojat më të rëndësishme profesionale dhe artistike në nivel shkolle, si dhe për të planifikuar veprimtari të zhvillimit profesional dhe këshillimit për anëtarët e tyre.

OJF-të, donatorët dhe shoqatat e interesuara për zhvillimin profesional të mësuesve të arteve dhe të Artit Figurativ, kanë nevojë për një dokument të plotë të standardeve profesionale të mësuesit të shkollave artistike. Ky dokument u mundëson të ndërtojnë bashkëpunime të suksesshme me institucionet arsimore dhe të përcaktojnë më saktë kontributet e tyre në fushën e arsimit.

1.3 Struktura e standardit

Struktura e standardit **pedagogjiko- artistik** përfshin titullin dhe përshkrimin përmbledhës të tij. Çdo standard shoqërohet me një grup treguesish të detajuar dhe të matshëm, të cilët i referohen në mënyrë të harmonizuar njohurive që duhet të zotërojnë





mësuesi i specialiteteve të ndryshme në Artet Figurative. Këta tregues klasifikojnë aftësitë që mësuesi duhet të demonstrojë dhe pasqyrojnë qëndrimet dhe vlerat që e karakterizojnë atë gjatë procesit të mësimdhënie-nxënies në lëndët e ndryshme të kurrikulës artistike. Treguesit vlerësohen sipas niveleve përkatëse, të përshkruara në këtë dokument.

II.PJESA E DYTË: STANDARDET PROFESIONALE TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM ARTISTIK TË MËSUESIT

Standardet profesionale të formimit artistik për mësuesit e shkollave artistike me status të veçantë, Dega Art Figurativ

Standardet profesionale për shkollat artistike, **dega Art Figurativ**, përshkruajnë kriteret që priten të përmbushen nga mësuesit. Këto standarde trajtojnë në mënyrë të detajuar aspektet e mësimdhënies artistike, të cilat përfshijnë:

- a) Aspektet që lidhen me zbatimin e dokumenteve arsimore;
- b) Aspektet e përmbajtjes së kurrikulës artistike në lëndët teorike, praktike dhe në ato të specialiteteve të ndryshme si: Pikturë, Vizatim, Skulpturë, Perspektivë, Qeramikë, Gdhendje në gur dhe dru, Grafikë, Skenografi-Kostumografi, Tekstil-Mode, Fotografi, etj., përmes demonstrimit të njohurive dhe aftësive artistike;
- c) Zbatimin e metodologjive artistike bashkëkohore në procesin mësimor dhe krijimin e një mjedisi pozitiv që nxit kreativitetin dhe pjesëmarrjen aktive të nxënësve;
- d) Aftësinë për të aplikuar njohuritë në funksion të një vlerësimi të drejtë, objektiv dhe të paanshëm të nxënësve;
- e) Zhvillimin e aftësive për krijimin e një mjedisi të sigurt, miqësor dhe bashkëpunues, brenda dhe jashtë shkollës, në bashkëpunim me kolegët, drejtuesit dhe komunitetin.

Standardet profesionale të mësimdhënies janë gjithsej tetë (8) dhe ofrojnë kriteret specifike për mësuesit e Degës së Artit Figurativ. Ato përcaktojnë nivelin e kërkuar të kompetencës profesionale në këtë fushë dhe përbëjnë bazën për vlerësimin dhe zhvillimin profesional të mësuesit, në përputhje me kërkesat e shkollave artistike me status të veçantë. Më poshtë paraqiten përshkrimet e detajuara për secilin prej këtyre standardeve:



Standardi 1. Njohja dhe zbatimi i dokumenteve arsimore

Mësuesi zotëron njohuritë e nevojshme për dokumentacionin që duhet të ketë çdo mësues i Degës së Artit Figurativ, pa të cilin zhvillimi i procesit mësimor, në përputhje me këto standarde, nuk do të ishte i mundur. Ky standard lidhet ngushtësisht me zotërimin dhe përdorimin e dokumentacionit bazë, që është i domosdoshëm për mësuesin në planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies. Mësuesi planifikon punën e tij mbi bazën e disa dokumenteve themelore, të cilat ndahen në dy kategori: ***Dokumente të përgjithshme ligjore dhe ndërkombëtare***, që ndonëse nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me procesin mësimor, përbëjnë themelet e tij, si: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Karta Evropiane e të Drejtave të Njeriut; Konventa për të Drejtat e Fëmijës; Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, etj. ***Dokumente specifike arsimore***, që janë të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor sipas standardeve profesionale, si: Ligji për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë; Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar; si dhe Udhëzime dhe rregullore të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, që lidhen drejtpërdrejt me procesin e mësimdhënie-nxënies. Njohja dhe përdorimi i këtyre dokumenteve ndihmon mësuesin të veprojë në mënyrë të ligjshme, profesionale dhe me fokus në të drejtat e nevojat e nxënësit.

Standardi 2. Përgatitja shkencore

Ky standard i kushtohet zotërimit të përgatitjes shkencore dhe artistike nga ana e mësuesit, si parakusht thelbësor për mësimdhënie cilësore në Degën e Artit Figurativ. Ai kërkon që mësuesi të demonstrojë njohuri të thelluara, si në aspektin pedagogjik, ashtu edhe në atë artistik, për lëndët teorike dhe praktike, si dhe për specialitetet përkatëse të kësaj dege. Mësuesi duhet të zotërojë njohuri të avancuara teorike dhe praktike në fushën e tij, përfshirë: Histori e Artit Shqiptar dhe Botëror, Pikturë, Vizatim, Perspektivë, Qeramikë, Gdhendje në gur dhe dru, Grafikë, Skenografi-Kostumografi, Tekstil-Mode, Fotografi, etj., Ai duhet të demonstrojë nivel të lartë interpretimi dhe krijimtari në disiplinën përkatëse, duke qenë në gjendje të lidhë konceptet artistike me praktikën. Gjithashtu, mësuesi njeh vepra artistike dhe autorë përfaqësues nga lëvizje të ndryshme kulturore, epoka dhe kontekste historike. Ai përditëson vazhdimisht njohuritë në fushën e specialitetit përmes pjesëmarrjes në veprimtari artistike profesionale. Këto përvoja



përkthehen më pas në aftësim të nxënësve në vëzhgim, krijim, realizim teknik, analizë dhe vlerësim kritik të veprave artistike të tyre, apo të të tjerëve.

Standardi 3. Kurrikula artistike dhe mësimdhënia

Mësuesit përdorin njohuritë e tyre pedagogjike në fushën e Artit Figurativ për të aftësuar nxënësit në zotërimin e njohurive mbi veprat artistike shqiptare dhe botërore, të realizuara nga vetë ata ose nga artistë të tjerë. Ky standard kërkon që mësuesit të zbatojnë metoda bashkëkohore të mësimdhënies së Arteve Figurative, të përshtatura sipas nivelit dhe moshës së nxënësve; të hartojnë plane mësimore individuale në përputhje me programin mësimor dhe nevojat konkrete të nxënësve; të inkurajojnë mendimin kritik dhe kreativitetin përmes interpretimit dhe krijimtarisë në lëndën apo në specialitetin përkatës; si dhe të integrojnë mjete digjitale, medime dhe teknologji të ndryshme në procesin mësimor. Mësuesit gjithashtu demonstrojnë aftësi ndërkurrikulare, si: menaxhimi i informacionit artistik, puna e pavarur, bashkëpunimi në grup, si edhe mbajtja e një qëndrimi etik ndaj fenomeneve dhe ngjarjeve artistike. Zhvillimi i këtyre aftësive tek nxënësit është i mundur vetëm nëse mësuesi i ka përvetësuar dhe i demonstroi vetë ato në praktikë.

Standardi 4. Vlerësimi

Ky standard, përmes treguesve të tij, kërkon që mësuesit të hartojnë dhe zbatojnë me saktësi nivelet e arritjeve të nxënësve, duke u bazuar në kritere të matshme dhe të qarta artistike. Çdo mësues, pavarësisht nga lënda apo specialiteti që zhvillon, duhet të vlerësojë nxënësit për njohuritë e tyre artistike, aftësitë e demonstruara dhe për interpretimin ose realizimin e veprave të artit figurativ. Treguesit kërkojnë zbatimin e kritereve objektive, të ndershme dhe transparente në vlerësimin e punës artistike; dokumentimin e progresit individual të nxënësve përmes portofolëve artistikë dhe regjistrimeve të detyrave të përfunduara; si dhe kryerjen e vlerësimeve të vazhdueshme që i ndihmojnë nxënësit të identifikojnë fushat për përmirësim dhe të përgatiten në mënyrë të suksesshme për konkurse, ekspozita apo provime pranimit në institucionet e arsimit të lartë artistik.



Standardi 5. Zhvillimi profesional dhe personal

Ky standard thekson rëndësinë e rolit të mësuesit cilësor, i cili angazhohet në një proces të vazhdueshëm përmirësimi përmes reflektimit të vetëdijshëm, përvojës së përditshme, shkëmbimit profesional me kolegët dhe kërkimeve në literaturën artistike, kombëtare dhe ndërkombëtare. Zhvillimi profesional dhe personal kërkon përfshirje aktive në veprimtari zhvillimore si: trajnime, seminare brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunim me kolegë dhe drejtues të shkollës, partneritete me institucione kulturore, si dhe reflektim të vazhdueshëm mbi përmirësimin e praktikës mësimore dhe rritjen profesionale të mësuesit si udhëheqës artistik dhe pedagogjik.

Standardi 6. Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët


Ky standard kërkon që mësuesit të zotërojnë aftësi të zhvilluara në komunikim dhe bashkëpunim profesional me kolegët. Mësuesi i lëndëve të kurrikulës artistike nuk është thjesht një transmetues njohurish, por një anëtar aktiv i një komuniteti profesionistësh, që punojnë së bashku për përmirësimin e institucionit në tërësi. Standardi përfshin tregues që lidhen me etikën profesionale, parimet e komunikimit efektiv dhe sjelljen në punë, elementë thelbësorë për ndërtimin e të gjitha cilësive të tjera profesionale dhe për ruajtjen e një kulture bashkëpunimi të shëndetshme në institucion.

Standardi 7. Bashkëpunimi me komunitetin

Ky standard nënvizon rëndësinë e ndërtimit të marrëdhënieve të qëndrueshme dhe të frytshme me komunitetin, në veçanti me prindërit e nxënësve. Prindërit janë mësuesit e parë të fëmijës, të cilët njohin dhe ndihmojnë në zhvillimin e talentit dhe aftësive të tij artistike, ndaj konsiderohen bashkëpunëtorët më të afërt dhe më të natyrshëm të mësuesit. Komunikimi i vazhdueshëm, i hapur dhe efektiv ndërmjet mësuesit dhe prindërve është thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe për ndërtimin e një partneriteti të qëndrueshëm edukues midis shkollës dhe familjes.

Standardi 8. Mjedisi mësimor

Ky standard kërkon nga mësuesit dhe drejtuesit e shkollës krijimin e mjediseve mësimore të përshtatshme me natyrën dhe kërkesat e arteve pamore, ku nxënësit të mësojnë në mënyrë aktive dhe të zhvillojnë individualitetin e tyre artistik. Mjedisi mësimor duhet të nxisë vlerësimin dhe ekspozimin e veprave të realizuara nga nxënësit,





të frymëzojë krijimtari inovative dhe të mbështesë ndërtimin e një identiteti artistik personal. Ai duhet të jetë funksional, i sigurt, estetikisht i stimuluar dhe i përfshirë në dinamikën e procesit edukativ-artistik.

Standardi 1. Njohja dhe zbatimi i dokumenteve arsimore

Përshkrimi i standardit

Mësuesi zotëron njohuritë e nevojshme për dokumentacionin që duhet të ketë çdo mësues i Degës së Artit Figurativ, pa të cilin zhvillimi i procesit mësimor, në përputhje me këto standarde, nuk do të ishte i mundur. Ky standard lidhet ngushtësisht me zotërimin dhe përdorimin e dokumentacionit bazë, që është i domosdoshëm për mësuesin në planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies. Mësuesi planifikon punën e tij mbi bazën e disa dokumenteve themelore, të cilat ndahen në dy kategori:

Dokumente të përgjithshme ligjore dhe ndërkombëtare, që ndonëse nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me procesin mësimor, përbëjnë themelet e tij, si: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Karta Evropiane e të Drejtave të Njeriut; Konventa për të Drejtat e Fëmijës; Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, etj..

Dokumente specifike arsimore, që janë të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor sipas standardeve profesionale, si: Ligji për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë; Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar; si dhe Udhëzime dhe rregullore të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, që lidhen drejtpërdrejt me procesin e mësimdhënie-nxënies.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

1.1 Mësuesit demonstrojnë njohuri të qëndrueshme mbi dokumente të ndryshme.

Mësuesi:

1.1.1. Ka njohuri:

- a) për legjislacionin shqiptar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me veprimtarinë e tij;
- b) mbi strategjitë kombëtare dhe institucionale për arsimin;
- c) për aktet nënligjore, urdhrat dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit që rregullojnë veprimtarinë e tij mësimore dhe pedagogjike;

1.1.2. Njeh procedurat për organizimin dhe funksionimin e institucionit arsimor.

1.1.3. Ka një kuptueshmëri të plotë mbi funksionimin e strukturave mbështetëse dhe drejtuese brenda shkollës.

1.1.4. Njih standardet profesionale të përgjithshme dhe ato të veçanta për mësuesit lëndor.

Standardi 2. Përgatitja shkencore: Dega Art Figurativ

Përshkrimi i standardit

Ky standard i kushtohet zotërimit të përgatitjes shkencore dhe artistike nga ana e mësuesit, si një parakusht thelbësor për mësimdhënie cilësore në Degën e Artit Figurativ. Ai kërkon që mësuesi të demonstrojë njohuri të thelluara, si në aspektin pedagogjik, ashtu edhe në atë artistik, për lëndët teorike dhe praktike, si dhe për specialitetet përkatëse të kësaj dege. Mësuesi duhet të zotërojë njohuri të avancuara teorike dhe praktike në fushën e tij, përfshirë: Histori e Artit Shqiptar dhe Botëror, Pikturë, Vizatim, Perspektivë, Qeramikë, Gdhendje në gur dhe dru, Grafikë, Skenografi-Kostumografi, Tekstil-Mode, Fotografi, etj., Ai duhet të demonstrojë nivel të lartë interpretimi dhe krijimtari në disiplinën përkatëse, duke qenë në gjendje të lidhë konceptet artistike me praktikën. Gjithashtu, mësuesi njih vepra artistike dhe autorë përfaqësues nga lëvizje të ndryshme kulturore, epoka dhe kontekste historike. Ai përditëson vazhdimisht njohuritë në fushën e specialitetit përmes pjesëmarrjes në veprimtari artistike profesionale. Këto përvoja përkthehen më pas në aftësim të nxënësve në vëzhgim, krijim, realizim teknik, analizë dhe vlerësim kritik të veprave artistike të tyre, apo të të tjerëve.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

2.1. Mësuesit demonstrojnë njohuri të qëndrueshme të anës shkencore të kurrikulës artistike.

Mësuesi:

2.1.1. Zotëron njohuri të thelluara teorike dhe praktike në fushën e tij artistike, që përfshijnë të gjitha komponentët e kurrikulës: lëndët teorike artistike, praktike artistike dhe specialitetet e ndryshme;

2.1.2. Demonstron nivel të lartë krijimtari dhe qasje të avancuar artistike në disiplinën përkatëse;

2.1.3. Zotëron njohuri të thella mbi lëvizjet artistike, epokat historike dhe kulturat e ndryshme që kanë ndikuar në zhvillimin e arteve pamore;

2.1.4. Përditëson në mënyrë të vazhdueshme njohuritë mbi specialitetin/lëndën përmes pjesëmarrjes në veprimtari artistike, ekspozita, konkurse dhe kërkime shkencore e artistike.

Standardi 3. Kurrikula artistike dhe mësimdhënia

Përshkrimi i standardit

Mësuesit përdorin njohuritë e tyre pedagogjike në fushën e Artit Figurativ për të aftësuar nxënësit në zotërimin e njohurive mbi veprat artistike shqiptare dhe botërore, të realizuara nga vetë ata ose nga artistë të tjerë. Ky standard kërkon që mësuesit të zbatojnë metoda bashkëkohore të mësimdhënies së Arteve Figurative, të përshtatura sipas nivelit dhe moshës së nxënësve; të hartojnë plane mësimore individuale në përputhje me programin mësimor dhe nevojat konkrete të nxënësve; të inkurajojnë mendimin kritik dhe kreativitetin përmes interpretimit dhe krijimtarisë në lëndën apo në specialitetin përkatës; si dhe të integrojnë mjete digjitale, medime dhe teknologji të ndryshme në procesin mësimor. Mësuesit gjithashtu demonstrojnë aftësi ndërkurrikulare, si: menaxhimi i informacionit artistik, puna e pavarur, bashkëpunimi në grup, si edhe mbajtja e një qëndrimi etik ndaj fenomeneve dhe ngjarjeve artistike. Zhvillimi i këtyre aftësive tek nxënësit është i mundur vetëm nëse mësuesi i ka përvetësuar dhe i demonstroi vetë ato në praktikë.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

3.1. Mësuesit demonstrojnë njohuri të qëndrueshme mbi kurrikulën artistike, Dega Art Figurativ.

Mësuesi:

- 3.1.1. Përshtat qëllimet e kurrikulës artistike me metodologjinë e Artit Figurativ, në përputhje me profilin e tij të punës;
- 3.1.2. Harton rezultate të matshme të procesit të nxënies, që pasqyrojnë zhvillimin e aftësive artistike të nxënësve;
- 3.1.3. Nxiti kreativitetin si një element thelbësor për zhvillimin dhe përsosjen e aftësive artistike dhe të mendimit kritik;
- 3.1.4. Zotëron aftësi teknike dhe artistike që e bëjnë orën e mësimit tërheqëse dhe motivuese për nxënësit;




- 3.1.5. Zhvillon mësim të diferencuar, duke marrë parasysh mundësitë fizike, intelektuale dhe stilin e të nxënësve të çdo nxënësi;
- 3.1.6. Harton objektiva dhe kërkesa të qarta mësimore në përputhje me programin e lëndëve të kurrikulës artistike (teorike, praktike dhe të specialiteteve të ndryshme si: Histori Arti, Pikturë, Vizatim, Perspektivë, Qeramikë, Gdhendje në gur dhe dru, Grafikë, Skenografi–Kostumografi, Tekstil–Mode, Fotografi, etj.), duke përshtatur planifikimin me ritmin e përvetësimit të nxënësve;
- 3.1.7. Inkurajon nxënësit të shprehin qëndrime estetike dhe të zhvillojnë mendim kritik për veprat e Artit Figurativ të artistëve shqiptarë dhe ndërkombëtarë nga periudha të ndryshme kohore;
- 3.1.8. Ndërton, përmes përmbajtjes së kurrikulës artistike, aftësi vlerësuese për Artin Figurativ në kontekste të ndryshme kulturore, stilistike dhe historike.

3.2. Mësuesit mbështesin procesin e të nxënësve në çdo nivel aftësish.

Mësuesi:

- 3.2.1. Zbaton teknika të përshtatshme të mësimdhënies artistike për disiplinën dhe specialitetin që zotëron, si dhe zhvillon metoda pedagogjike për të maksimizuar procesin e të nxënësve;
- 3.2.2. Shfrytëzon njohuritë e mëparshme artistike të nxënësve dhe i pasuron ato përmes praktikës dhe përvojave të reja mësimore;
- 3.2.3. Integron metoda të larmishme mësimore për trajtimin e teknikave artistike, në përputhje me lëndën që zhvillon;
- 3.2.4. Krijon mundësi që nxënësit të reflektojnë mbi punën e tyre përmes procesit të vetëvlerësimit, duke i inkurajuar të marrin përgjegjësi për të nxënësve të tyre;
- 3.2.5. Analizon në mënyrë kritike arritjet e nxënësve gjatë procesit mësimor për të orientuar zhvillimin e tyre të mëtejshëm artistik;
- 3.2.6. Përdor një gamë të gjerë burimesh mësimore dhe strategji të ndryshme të të nxënësve, të përshtatura për nevojat dhe aftësitë individuale të nxënësve.



Standardi 4. Vlerësimi

Përshkrimi i standardit

Ky standard, përmes treguesve të tij, kërkon që mësuesit të hartojnë dhe zbatojnë me saktësi nivelet e arritjeve të nxënësve, duke u bazuar në kritere të matshme dhe të qarta artistike. Çdo mësues, pavarësisht nga lënda apo specialiteti që zhvillon, duhet të vlerësojë nxënësit për njohuritë e tyre artistike, aftësitë e demonstruara dhe për interpretimin ose realizimin e veprave të artit figurativ. Treguesit kërkojnë zbatimin e kritereve objektive, të ndershme dhe transparente në vlerësimin e punës artistike; dokumentimin e progresit individual të nxënësve përmes portofolëve artistikë dhe regjistrimeve të detyrave të përfunduara; si dhe kryerjen e vlerësimeve të vazhdueshme që i ndihmojnë nxënësit të identifikojnë fushat për përmirësim dhe të përgatiten në mënyrë të suksesshme për konkurse, ekspozita apo provime pranimit në institucionet e arsimit të lartë artistik.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

4.1. Mësuesit zhvillojnë vlerësimin në procesin arsimor, duke u bazuar në udhëzimet përkatëse.

Mësuesi:

- 4.1.1. Siguron që kurrikula artistike, programi mësimor, procesi i mësimdhënies dhe ai i vlerësimit të jenë në harmoni, duke ndërtuar pritshmëri e standarde të qarta për nxënësit, mësuesit dhe drejtuesit e shkollës;
- 4.1.2. Ndërton kritere vlerësimi që marrin parasysh njohuritë dhe performancën e nxënësit, si në aspektin praktik, ashtu edhe në atë verbal dhe të shkruar;
- 4.1.3. Përgatit kritere vlerësimi që reflektojnë specifikën e lëndëve të kurrikulës artistike, duke i ndihmuar nxënësit të lidhin njohuritë me fushat e tjera dhe me jetën e përditshme;
- 4.1.4. Harton kritere që evidentojnë përmbajtjen specifike të çdo lënde artistike;
- 4.1.5. Zbaton forma të ndryshme testimi, si teorik ashtu edhe praktik, në përputhje me programin mësimor të lëndëve artistike;
- 4.1.6. Harton kritere që vlerësojnë jo vetëm aftësitë artistike, por edhe mendimin kritik të nxënësve;
- 4.1.7. Përcakton nivele të ndryshme arritjeje të nxënësve, bazuar në përmbajtjen e kurrikulës artistike;



4.1.9 Ndërtton kritere gjithëpërfshirëse, të ndërtuara mbi realitetin bashkëkohor, duke marrë parasysh mjetet mësimore dhe burimet njerëzore në dispozicion.

4.2. Mësuesit hartojnë kritere të drejta, të paanshme, të barabarta.

Mësuesi:

4.2.1. Harton kritere vlerësimi të matshme dhe të vlefshme për të gjithë nxënësit;

4.2.2. Siguron që kriteret e vlerësimit të jenë të drejta dhe të paanshme, pa paragjykime ndaj etnisë, gjinisë, moshës, aftësive të kufizuara, besimit, dallimeve kulturore apo gjuhësore;

4.2.3. Harton kritere për mbledhjen e informacionit mbi arritjet e nxënësit në përmbushjen e objektivave të të nxënës, vlerëson përparimin dhe ndihmon nxënësit në vetëvlerësim, vendosjen e synimeve dhe përmirësimin e punës së tyre;

4.2.4. Harton kritere që janë të drejta, të qarta dhe lehtësisht të komunikueshme e të verifikueshme, në përputhje me procesin e mësimdhënies.

Standardi 5. Zhvillimi profesional dhe personal

Përshkrimi i standardit

Ky standard thekson rëndësinë e rolit të mësuesit cilësor, i cili angazhohet në një proces të vazhdueshëm përmirësimi përmes reflektimit të vetëdijshëm, përvojës së përditshme, shkëmbimit profesional me kolegët dhe kërkimeve në literaturën artistike, kombëtare dhe ndërkombëtare. Zhvillimi profesional dhe personal kërkon përfshirje aktive në veprimtari zhvillimore si: trajnime, seminare brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunim me kolegë dhe drejtues të shkollës, partneritete me institucione kulturore, si dhe reflektim të vazhdueshëm mbi përmirësimin e praktikës mësimore dhe rritjen profesionale të mësuesit si udhëheqës artistik dhe pedagogjik.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

5.1. Mësuesit planifikojnë vetë zhvillimin profesional dhe personal.

Mësuesi:

5.1.1. Merr pjesë aktivisht në planifikimin dhe zbatimin e politikave për artet, si në nivelin shkollor, ashtu edhe në bashkëpunim me institucione të tjera artistike dhe arsimore;

5.1.2. Identifikon në mënyrë të vazhdueshme nevojat individuale për zhvillim profesional;



- 5.1.3. Harton dhe zbaton planin e zhvillimit profesional me qëllim përmirësimin e arritjeve të nxënësve;
- 5.1.4. Merr pjesë rregullisht dhe në mënyrë aktive në takimet profesionale (këshilli i mësuesve, ekipet lëndore, rrjetet profesionale sipas profilit), duke u përgatitur seriozisht, duke ndarë përvoja, duke trajtuar çështje dhe duke sugjeruar ide të reja;
- 5.1.5. Studion në mënyrë të vazhdueshme literaturë profesionale nga burime të ndryshme, përfshirë ato elektronike në gjuhën shqipe dhe të huaj;
- 5.1.6. Kupton ndikimin që zhvillimi profesional ka mbi cilësinë e mësimdhënies;
- 5.1.7. Përdor teknologjinë dhe pajisjet digjitale për të rritur efektivitetin e procesit të mësimdhënies dhe të të nxënit;
- 5.1.8. Vlerëson rregullisht vetveten në përputhje me standardet profesionale të mësuesit dhe standardet e kurrikulës artistike;
- 5.1.9. Menaxhon në mënyrë efektive kohën e punës për të maksimizuar ndikimin e saj në arritjet e nxënësve;
- 5.1.10. Angazhohet në kërkime për të thelluar njohuritë mbi vlerat e arteve figurative;
- 5.1.11. Merr pjesë në aktivitete të ndryshme profesionale që lidhen me mësimdhënien dhe specialitetin që përfaqëson.

Standardi 6. Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët


Përshkrimi i standardit

Ky standard kërkon që mësuesit të zotërojnë aftësi të zhvilluara në komunikim dhe bashkëpunim profesional me kolegët. Mësuesi i lëndëve të kurrikulës artistike nuk është thjesht një transmetues njohurish, por një anëtar aktiv i një komuniteti profesionistësh, që punojnë së bashku për përmirësimin e institucionit në tërësi. Standardi përfshin tregues që lidhen me etikën profesionale, parimet e komunikimit efektiv dhe sjelljen në punë, elementë thelbësorë për ndërtimin e të gjitha cilësive të tjera profesionale dhe për ruajtjen e një kulture bashkëpunimi të shëndetshme në institucion.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit


6.1. Mësuesit bashkëpunojnë dhe krijojnë frymë pozitive me kolegët brenda dhe jashtë institucionit shkollor.

Mësuesi:





- 6.1.1. Bashkëpunon me kolegët për përmirësimin e funksionimit dhe cilësisë së procesit mësimor në shkollën artistike me status të veçantë;
- 6.1.2. Mirëpret dhe nxit risitë, propozimet dhe nismat e kolegëve për përmirësimin e kushteve të nxënësve;
- 6.1.3. Propozon ose ndërmerr nisma për përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe të nxënësve në institucion;
- 6.1.4. Mbështet dhe udhëzon mësuesit e rinj në zhvillimin e tyre profesional;
- 6.1.5. Punon në grupe pune, komisione lëndore dhe në ekipet funksionale të shkollës;
- 6.1.6. Angazhohet për arritjen e objektivave të përbashkëta në nivel institucional;
- 6.1.7. Respekton të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të fëmijëve, duke kontribuar në krijimin e një atmosfere të sigurt dhe mbështetëse në mjediset e nxënësve;
- 6.1.8. Krijon një mjedis të ngrohtë dhe miqësor për nxënësit;
- 6.1.9. Nuk ushtron asnjë formë diskriminimi, dhune, keqtrajtimi apo dëmtimi moral ndaj nxënësve dhe stafit;
- 6.1.10. Kultivon tek nxënësit respektin për dallimet individuale dhe për kulturat e ndryshme, duke:
 - a) përdorur stile dhe praktika të ndryshme komunikimi me nxënësit, kolegët dhe prindërit;
 - b) komunikuar në mënyrë të hapur, të qartë, bindëse dhe frymëzuese me nxënësit;
 - c) krijuar një frymë komunikimi të lirë dhe të hapur mes nxënësve dhe mësuesit, si dhe ndërmjet vetë nxënësve;
- 6.1.11. Krijon një atmosferë ku nxënësit ndihen të lirë të bëjnë pyetje, të mos kenë frikë nga gabimet dhe të shprehin mendimet e tyre;
- 6.1.12. Është transparent në veprimtarinë e tij dhe promovon kulturën e transparencës në mjedisin shkollor;
- 6.1.13. Është i hapur ndaj kritikës dhe gabimeve të tij, duke nxitur një klimë reflektimi dhe zhvillimi personal;
- 6.1.14. Përdor metoda të ndryshme të negocimit, zgjidhjes së konflikteve dhe arritjes të së konsensusit në marrëdhëniet me kolegët dhe nxënësit;
- 6.1.15. Shmang çdo konflikt interesi dhe njofton menjëherë drejtuesit e institucionit në raste të tilla.



Standardi 7. Bashkëpunimi me komunitetin

Përshkrimi i standardit

Ky standard nënvizon rëndësinë e ndërtimit të marrëdhënieve të qëndrueshme dhe të frytshme me komunitetin, në veçanti me prindërit e nxënësve. Prindërit janë mësuesit e parë të fëmijës, të cilët njohin dhe ndihmojnë në zhvillimin e talentit dhe aftësive të tij artistike, ndaj konsiderohen bashkëpunëtorët më të afërt dhe më të natyrshëm të mësuesit. Komunikimi i vazhdueshëm, i hapur dhe efektiv ndërmjet mësuesit dhe prindërve është thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe për ndërtimin e një partneriteti të qëndrueshëm edukues midis shkollës dhe familjes.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

7.1. Mësuesit bashkëpunojnë me artistë, prindër, kolegë të shkollës dhe komunitetin.

Mësuesi:

7.1.1. Krijon një rrjet bashkëpunimi për edukimin në Artin figurativ, duke përfshirë të gjitha palët e interesuara të komunitetit të shkollës: nxënës, prindër, kolegë mësues, anëtarë të bordit të shkollës dhe përfaqësues të institucioneve arsimore lokale;

7.1.2. Bashkëpunon me artistë dhe profesionistë të fushës së Artit Figurativ, përfshirë organizata, institucione arsimore të larta (IAL), qendra kulturore, shkolla dhe shoqata, për të pasuruar përvojën artistike të nxënësve dhe mësuesve;

7.1.3. Fton përfaqësues të komunitetit të vizitojnë klasat e arteve pamore (pikturë, skulpturë, qeramikë, grafikë, fotografi etj.) për të dëshmuar ndikimin pozitiv të këtyre disiplinave në zhvillimin e nxënësve dhe në jetën shkollore;

7.1.4. Krijon hapësira për iniciativa të zhvillimit profesional në bashkëpunim me universitete e institucione të tjera, duke ftuar studiues e artistë të diplomuar në fusha si pikturë, skulpturë, grafikë, tekstil, multimedia, brenda dhe jashtë vendit, për të trajtuar tema me interes të përbashkët në fushën e Artit Figurativ dhe arsimit;

7.1.5. Bashkëpunon rregullisht me të gjithë aktorët e edukimit artistik si: mësues, drejtues, prindër e artistë, për të zhvilluar dhe përmirësuar kurrikulën dhe programet shkollore;

7.1.6. Organizon performanca dhe prezantime nga nxënësit për komunitetin (shtëpi të moshuarve, spitale, qendra komunitare) me qëllim promovimin e kurrikulës së Arteve Figurative dhe ndërgjegjësimin publik për vlerat e artit.

Standardi 8. Mjedisi mësimor

Përshkrimi i standardit

Ky standard kërkon nga mësuesit dhe drejtuesit e shkollës krijimin e mjediseve mësimore të përshtatshme me natyrën dhe kërkesat e arteve pamore, ku nxënësit të mësojnë në mënyrë aktive dhe të zhvillojnë individualitetin e tyre artistik. Mjedisi mësimor duhet të nxisë vlerësimin dhe ekspozimin e veprave të realizuara nga nxënësit, të frymëzojë krijimtari inovative dhe të mbështesë ndërtimin e një identiteti artistik personal. Ai duhet të jetë funksional, i sigurt, estetikisht i stimuluar dhe i përfshirë në dinamikën e procesit edukativ-artistik.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

8.1. Mësuesit njohin dhe zbatojnë standardet dhe udhëzimet për mësimdhënien në Degën e Artit Figurativ.

8.1.1. Mjediset/klasat/sallat:

Ofrojnë hapësira të mjaftueshme, të ngrohta dhe të pajisura me mjetet e nevojshme për mësim dhe studim, individualisht ose në grup.

8.1.2. Pajisjet:

Përgatiten gjithmonë pajisje bazë dhe funksionale për mësimdhënie, përfshirë: kompjuter/laptop, monitor, projektor, sistem audio, materiale mësimore nga biblioteka dhe media (CD, DVD, libra, revista, artikuj shkencorë, etj.).

8.1.3. Orari i mësimi:

Organizohet në përputhje me kurrikulën e miratuar nga MAS, me planin mësimor të kurrikulës artistike të shkollës me status të veçantë, si dhe orarin e hartuar nga vetë institucioni/shkolla në përputhje me këtë kurrikulë.

8.2. Mjedise që nxisin përgjegjësinë sociale, disiplinën personale dhe barazinë.

Mësuesi:

8.2.1. Krijon një mjedis ku respektohet individi, vlerat e Artit Figurativ dhe procesi i të nxënit;



- 8.2.2. Inkurajon dhe mbështet zhvillimin e aftësive artistike, intelektuale e kritike të nxënësve, përmes mendimit të pavarur dhe shprehjes krijuese;
- 8.2.3. Përfshin nxënësit në një atmosferë që nxit arritje të larta në Artin Figurativ;
- 8.2.4. Shpreh pritshmëri të barabarta për të gjithë nxënësit;
- 8.2.5. Respekton mendimet artistike të nxënësve dhe inkurajon shprehjen e pikëpamjeve të tyre;
- 8.2.6. Siguron qasje të drejtë e të barabartë për çdo nxënës gjatë procesit mësimor;
- 8.2.7. Nxit aftësitë komunikuese përmes të cilave nxënësit shprehin idetë dhe vlerat e tyre në krijimet e tyre artistike;
- 8.2.8. Menaxhon në mënyrë efektive situatat që mund të shkaktojnë pakënaqësi ose trazira në klasë;
- 8.2.9. Zbaton masa disiplinore me ndikim minimal në rrjedhën e orës mësimore.

8.3. Krijimi dhe mirëmbajtja e një mjedisi të sigurt dhe efektiv për procesin e të nxënit.

Mësuesi:

- 8.3.1. Krijon një ambient të sigurt që mbështet aktivitetet e planifikuara, spontane dhe të ndryshme;
- 8.3.2. Siguron që ambientet e të nxënit nuk e ekspozojnë nxënësin ndaj rreziqeve;
- 8.3.3. Udhëzon nxënësit drejt praktikave të sigurta në punën artistike, për të mbrojtur mirëqenien e tyre fizike, psikologjike dhe emocionale.


Të tjera:

Uji i pijshëm dhe tualetet:

Nxënësit dhe mësuesit duhet të kenë qasje të pandërprerë në ujë të pijshëm dhe në ambiente higjienike të ndara për djem dhe vajza, të vendosura pranë studios dhe hapësirave të performancës artistike.

Pajisjet:

Pajisjet standarde për mësimdhënie duhet të jenë të vendosura dhe funksionale, duke përfshirë: monitor televiziv(VHS/DVD), luajtës VHS/DVD, videokamera, trekëmbësh, kompjuter dhe/ose tabelë inteligjente me lidhje interneti, projektor LCD, sistem stereo me CD player dhe pajisje për regjistrim në kasetë.





Gjithashtu, duhet të jetë e garantuar mundësia e aksesit në një gamë të gjerë burimesh nga biblioteka ose qendra e medias: CD, DVD, libra, revista dhe publikime kërkimore.

III. PJESA E TRETË: STANDARDET PROFESIONALE TË VETËVLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË MËSUESIT

Vlerësimi dhe vetëvlerësimi i mësuesit janë procese të mbledhjes së të dhënave dhe të gjykitimit mbi arritjet e tij, në bazë të kriterëve të përcaktuar. Arritja e një konkluzioni të besueshëm kërkon grumbullimin e informacionit në mënyrë të vazhdueshme, për të matur dhe vlerësuar të gjitha aspektet e zhvillimit profesional. Për të garantuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e vlerësimit, përdoren kriterë të unifikuar, të shpallura më parë, të shprehur përmes katër niveleve arritjeje të kompetencave profesionale. Këto nivele përcaktojnë qartë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që lidhen me standardet profesionale. Përdorimi i një sistemi të strukturuar vlerësimi lejon që si vlerësuesit, ashtu edhe mësuesit, të gjykojnë në mënyrë të saktë performancën në përputhje me pritshmëritë institucionale, duke krijuar besim, siguri dhe transparencë në komunitetin arsimor.

3.1 Përshkrimi i përgjithshëm i niveleve

Niveli 4: Arritje shumë të mira

Mësuesi planifikon të gjithë procesin mësimor mbi dokumentet themelore që garantojnë zhvillimin e qëndrueshëm të nxënësve, duke zbatuar me përpikëri dhe kreativitet bazën ligjore përkatëse. Ai zotëron në thellësi aspektet shkencore dhe artistike të lëndës, duke kuptuar rëndësinë themelore të zhvillimit të aftësive artistike, dhe ndërton mësimin mbi këtë themel, duke integruar kompetencat e përgjithshme dhe ato specifike në një proces gjithëpërfshirës të të nxënësve, që reflekton zotërimin e plotë të këtyre aftësive. Përmes një game të pasur teknikash artistike, mësuesi nxit zhvillimin e aftësive ndërkurrikulare, si: mendimin kritik dhe krijues, menaxhimin e informacionit, punën e pavarur dhe atë në grup. Gjithashtu, ai përdor metoda e burime të ndryshme mësimore, të përshtatura me nevojat individuale të çdo nxënësi, duke e vendosur suksesin e tyre në qendër të vëmendjes. Në vlerësim, mësuesi fokusohet tek progresi dhe procesi i të nxënësve, jo vetëm tek produkti përfundimtar: ai aplikon një gamë të gjerë teknikash vlerësimi dhe e shndërron vetëvlerësimin në një mjet mësimor. Duke u mbështetur në standardet profesionale, ai identifikon vazhdimisht nevojat e veta për zhvillim dhe merr pjesë




rregullisht në trajnime dhe aktivitete profesionale, me synim përmirësimin e pandërprerë të praktikave të tij. Gjithashtu, mësuesi demonstroi vlera të forta profesionale dhe etikë komunikimi, të cilat ndikojnë në formimin dhe sjelljen e nxënësve. Ai kultivon marrëdhënie të ngushta dhe të qëndrueshme me prindërit, bashkëpunon në mënyrë konstruktive me ta dhe respekton mendimet e tyre lidhur me procesin mësimor, zhvillimin e fëmijës dhe veprimtaritë shkollore.

Niveli 3: Arritje të mira që kanë nevojë për përmirësim

Mësuesi planifikon punën e tij mbi bazën e dokumenteve themelore, të miratuara dhe të shpallura. Ai zbaton ato me përpikëri, por duhet të jetë më kreativ në interpretimin e kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë shkollore. Mësuesi ka përgatitje të mirë shkencore, parakusht i domosdoshëm për çdo pretendim të mëtëjshëm. Ai përdor një numër të konsiderueshëm metodash dhe i përshtat ato me veçoritë individuale të nxënësve. Mësuesi zhvillon vlerësimin sipas legjislacionit, por has vështirësi në integrimin e tij në procesin e të nxënësve. Mësuesi njeh dhe kupton dobinë e zhvillimit të kompetencave artistike dhe shpesh ndërton punën e tij mbi këtë bazë. Ai lidh kompetencat artistike të përgjithshme me ato specifike, ndërsa herë pas here paraqet vështirësi në zhvillimin e tyre. Mësuesi zbaton disa teknika mësimore për të fuqizuar aftësitë ndërkurrikulare si: mendimin kritik, mendimin krijues, menaxhimin e informacionit, punën e pavarur dhe punën në grup. Ai merr pjesë në trajnime me synim zhvillimin e tij profesional, por nuk fokusohet mjaftueshëm në identifikimin e nevojave për trajnim. Mësuesi demonstroi vlera dhe qëndrime profesionale në aspektin etik dhe komunikues, por nuk kushton vëmendje të mjaftueshme zhvillimit të komunikimit me nxënësit dhe me aktorët e tjerë të komunitetit shkollos.

Niveli 2: Arritje të mjaftueshme që kanë nevojë të konsiderueshme për përmirësim

Mësuesi ka njohuri bazë mbi legjislacionin në fuqi që rregullon funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, por shfaq vështirësi në interpretimin, zbatimin dhe integrimin e tij në mënyrë efektive në procesin mësimor dhe veprimtarinë shkollore. Ai përdor një gamë të kufizuar metodash artistike dhe priret të mbështetet te metoda tradicionale, të cilat nuk stimulojnë bashkëpunimin, pjesëmarrjen aktive apo mendimin kritik të nxënësve. Procesi i vlerësimit zbatohet në përputhje me kërkesat ligjore, por mësuesi ka vështirësi në përdorimin e vlerësimit si mjet për nxitjen e të nxënësve dhe për






rritjen e motivimit të nxënësve. Ai është në dijeni të rëndësisë së zhvillimit të kompetencave artistike, por përballët me sfida në zbatimin praktik të tyre dhe në integrimin koherent të kompetencave të përgjithshme me ato specifike. Mësuesi merr pjesë herë pas here në trajnime profesionale, por nuk demonstroi përkushtim të qëndrueshëm ndaj zhvillimit të tij profesional. Ai nuk ka një plan të qartë dhe të strukturuar për përmirësimin e aftësive të tij dhe nuk identifikoi me vetëdije nevojat për zhvillim të mëtejshëm profesional. Në aspektin etik dhe komunikues, mësuesi njeh parimet bazë të etikës profesionale, por sjellja e tij është shpeshherë formale dhe e ngurtë. Ai nuk tregon përpjekje të mjaftueshme për të ndërtuar dhe zhvilluar marrëdhënie efektive komunikimi me nxënësit, prindërit dhe komunitetin, gjë që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përfshirjen dhe mbështetjen e nxënësve gjatë procesit mësimor.

Niveli 1: Arritje të dobëta që kanë nevojë të domosdoshme për përmirësim

Mësuesi ka njohuri të pakta dhe të kufizuara për legjislacionin mbi të cilin funksionojnë institucionet arsimore në arsimin parauniversitar. Ai ka përgatitje të kufizuar në drejtim të përmbajtjes shkencore të lëndës dhe trajtimit të saj gjatë veprimtarive mësimore në klasë. Mësuesi përdor një numër shumë të kufizuar teknikash dhe metodash, duke u përqendruar te ato që nuk sigurojnë ndërveprim dhe aktivizim të nxënësve gjatë orës së mësimi. Ai nuk bën përpjekje për të përshtatur metodat e mësimdhënies dhe të të nxënësit me nevojat specifike të nxënësve në klasën e tij. Procesin e vlerësimit e zhvillon në përputhje me legjislacionin në fuqi, por nuk ndërmerr asnjë hap për të motivuar nxënësit dhe nuk e konsideron vlerësimin si pjesë integrale të procesit të të nxënësit. Mësuesi merr pjesë rrallë në trajnime dhe vetëm në rastet kur kjo është e detyrueshme; nuk përqendrohet në identifikimin e nevojave personale për zhvillim profesional dhe i mungon aftësia për ta organizuar procesin e vetëzhvillimit. Edhe pse njeh parimet bazë etike, shpeshherë nuk i zbaton ato në praktikë. Gjithashtu, ai nuk i kushton vëmendje parimeve të komunikimit dhe nuk bën përpjekje të mjaftueshme për të përmirësuar ndërveprimin me nxënësit dhe partnerët e tjerë të shkollës.



3.2 Vetëvlerësimi për standardet e përgjithshme profesionale

Mësuesi mund të vetëvlerësojë secilin tregues individualisht, ose të kryejë një vetëvlerësim të plotë për të gjitha treguesit e një standardi. Vlerësimi i standardeve bazohet në fakte, prova, evidenca si dhe në veprimtari konkrete.

Shembull

Standardi 6: Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët

Treguesi 6.1: Mësuesi bashkëpunon dhe krijon frymë pozitive me kolegët brenda dhe jashtë institucionit shkollor.

Në këtë tregues, ashtu si edhe në disa tregues të tjerë, kërkohet që mësuesi të bashkëpunojë me kolegët për përmirësimin e punës në institucionin e shkollës artistike; të mirëpresë dhe nxisë risitë e kolegëve, propozimet dhe nismat e tyre për përmirësimin e kushteve të të nxënit; të ndihmojë mësuesit e rinj; të angazhohet për të arritur objektiva të përbashkëta në nivel shkolle, etj. Për këtë tregues, mësuesi gjykon se sa i njeh, i kupton dhe i përdor këto aftësi me kolegët, duke ndihmuar në forcimin e bashkëpunimit dhe komunikimit me ta.

Nëse mësuesi është i interesuar në mënyrë të veçantë të kuptojë sa e përmbush standardin, duhet të analizojë veçmas secilin tregues. Pasi të ketë vlerësuar të gjithë treguesit që përbëjnë një standard, ai bën shumën e pikëve dhe e pjesëton me numrin total të treguesve. Rezultati rrumbullakoset me një shifër pas presjes dhjetore.

P.sh.:

Standardi 6: Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët

<i>Përshkrimi i standardit</i>		
zotëron aftësi komunikative dhe profesionale në bashkëpunimin me kolegët e tij. Mësuesi që zhvillon lëndët e kurrikulës artistike nuk është vetëm dhe thjesht mësues që jep njohuritë artistike pavarësisht lëndës, por edhe pjesëtar i një komuniteti profesionistësh artistë që interesohet dhe punon për institucionin në të gjitha aspektet e tij. Ky standard përmban tregues mbi etikën, parimet e komunikimit dhe sjelljen e mësuesit, si themele mbi të cilat ndërtohen të gjitha meritat e tjera profesionale		
<i>Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit</i>		
6.1. Mësuesit bashkëpunon dhe krijon frymë pozitive me kolegët brenda dhe jashtë institucionit shkollor.		
<i>Mësuesi:</i>		
<i>Nr.</i>	<i>Treguesi</i>	<i>Niveli</i>



6.1.1	Bashkëpunon me kolegët për përmirësimin e punës në institucion e shkollës artistike.	2
6.1.2	Mirëpret dhe nxit risitë, propozimet dhe nismat e kolegëve për përmirësimin e kushteve të të nxënës.	2
6.1.3	Propozon ose ndërmerr nisma për përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe të nxënies në institucion.	4
6.1.4	Ndihmon mësuesit e rinj	2
6.1.5	Punon në grupe pune, në komisione lëndore dhe në përbërje të ekipeve funksionale të shkollës.	2
6.1.6	Angazhohet për të arritur objektiva të përbashkëta në nivel shkolle.	3
6.1.7	Respekton të drejtat e liritë e njeriut dhe të fëmijëve, duke krijuar atmosferë ku këto të drejta respektohen.	3
6.1.8	Krijon një mjedis miqësor dhe mbështetës për nxënësit.	2
6.1.9	Nuk ushtron diskriminim, dhunë, keqtrajtim apo dëm moral ndaj nxënësve dhe personelit.	2
6.1.10	Kultivon tek nxënësit respektin për dallimet individuale, për kulturat e ndryshme dhe për etnitë e tjera.	2
<i>Vlerësimi i standardit</i>		$24 : 10 = 2.4$

Mesatarja = $24 \div 10 = 2,4$

Përfundimi: Ky rezultat korrespondon me Nivelin 2 ("Arritje të mjaftueshme që kanë nevojë të konsiderueshme për përmirësim").

Vlerësimi i standardit "Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët" është në Nivelin 2.

Kur mesatarja e pikëve varion nga 1 deri në 1,8, standardi vetëvlerësohet në Nivelin 1.

Mesatarja nga 1,9 deri në 2,5 përkon me Nivelin 2.

Standardi vlerësohet në Nivelin 3 kur mesatarja është nga 2,6 deri në 3,3.

Kur mesatarja e pikëve luhet nga 3,4 deri në 4, standardi vetëvlerësohet në Nivelin 4.

Në shembullin e mësipërm, mësuesi vetëvlerësohet në Nivelin 2 për standardin "Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët."



IV.PJESA E KATËRT: STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT SIPAS TRE GRUPE LËNDËSH: TEORIKE - ARTISTIKE, PRAKTIKE- ARTISTIKE, SPECIALITETET.


A. LËNDËT TEORIKE TË DEGES ART FIGURATIV

1.1. Historia e artit

Në përmbushje të qëllimit për të siguruar arsim cilësor, dokumenti prezanton një qasje të re ndaj standardeve profesionale për mësuesit e lëndës “Histori arti”. Këto standarde përcaktojnë pritshmëritë në njohuri dhe aftësi që mësuesit duhet të zotërojnë, duke përmirësuar mësimdhënien dhe zhvillimin profesional.

Mësuesi:


- 1.1.1. Zotëron dhe përdor terminologjinë artistike për të përshkruar, analizuar dhe interpretuar vepra arti nga periudha të ndryshme historike;
- 1.1.2. Nxit tek nxënësit aftësinë për të analizuar dhe interpretuar një vepër arti në mënyrë kritike dhe të argumentuar;
- 1.1.3. Përdor mjete vizuale dhe teknologji digjitale për të ndihmuar nxënësit në përvetësimin e gjuhës artistike dhe analizën e veprave të artit;
- 1.1.4. Transmeton njohuri të thella kritike dhe estetike ndaj veprave të ndryshme artistike, duke i analizuar dhe i vlerësuar për karakteristikat dhe veçoritë e tyre;
- 1.1.5. Shpjegon marrëdhëniet mes historisë së artit pamor dhe disiplinave të tjera artistike, si muzika, teatri, arkitektura, kinematografia, dizajni apo letërsia;
- 1.1.6. Inkurajon nxënësit të bëjnë krahasime ndërmjet veprave të artit pamor dhe atyre të fushave të tjera, për të zhvilluar një kuptim më të gjerë të shprehjes artistike;
- 1.1.7. Përdor projekte ndërdisiplinore që lidhin përmbajtjen e historisë së artit me fusha të tjera të artit apo me lëndë të tjera si historia, filozofia, gjuha shqipe, etj.;
- 1.1.8. Promovon vlerësimin e trashëgimisë kulturore në tërësinë e saj, si një kombinim i shumë formave të artit që pasqyrojnë zhvillimet e kohës;
- 1.1.9. Analizon ndikimin e zhvillimeve teknologjike dhe materiale mbi artin (p.sh. shpikja e bojës së vajit, zhvillimi i printimit, fotografia, teknologjia digjitale);




- 1.1.10. Ndërlidh teknikat me kontekstin historik, ekonomik, dhe social në të cilin janë zhvilluar;
- 1.1.11. Zhvillon tek nxënësit aftësinë për të analizuar një vepër arti jo vetëm në aspektin teknik dhe stilistik, por edhe në mënyrën se si pasqyron procesin krijues të autorit;
- 1.1.12. Inkurajon nxënësit të ndërmarrin aktivitete reflektuese ose kreative që lidhen me përmbajtjen historike dhe që nxisin shprehjen individuale (ese, analiza krahasuese, interpretime vizuale, etj.;
- 1.1.13. Aplikon metoda mësimore të larmishme: analizë vizuale, diskutim i udhëhequr, mësim përmes projekteve, punë në grup, etj.;
- 1.1.14. Përdor materiale dhe mjete të ndryshme didaktike (prezantime multimediale, video dokumentare, riprodhime artistike, vizita virtuale ose fizike në muze dhe galeri);
- 1.1.15. Nxit përfshirjen aktive të nxënësve përmes pyetjeve të hapura, debateve dhe ushtrimeve që stimulojnë mendimin analitik dhe krijues;
- 1.1.16. Zbaton qasje ndërdisiplinore duke lidhur përmbajtjen e historisë së artit me histori, letërsi, filozofi, teknologji dhe forma të tjera arti;
- 1.1.17. Përshtat strategjitë mësimore sipas nevojave individuale të nxënësve, prejardhjes së tyre kulturore dhe kërkesave të veçanta;
- 1.1.18. Zotëron aftësi për të zhvilluar në mënyrë efektive: *teknologjinë, materialet dhe mjedisin fizik*,
- 1.1.19. Zhvillon më tej njohuritë artistike, duke u bërë pjesë e veprimtarive të zhvillimit profesional (ekspozita vetjake, në grup dhe workshop-e);
- 1.1.20. Reflekton mbi efektivitetin e metodave të përdorura dhe përshtat praktikat e mësimdhënies në përputhje me nevojat e klasës dhe kontekstit kulturor.

4.2. ANATOMI

Lënda e Anatomisë Artistike synon të pajisë nxënësit me njohuri të thelluara mbi strukturën e trupit të njeriut si bazë për përfaqësimin realist dhe të saktë në vizatim e pikturë. Standardet përmbajnë njohjen e skeletit, muskujve kryesorë dhe lidhjeve të tyre, si dhe aftësinë për të analizuar përmasat, qëndrimet dhe lëvizjet e trupit me vlera artistike. Nxënësit pritet të zotërojnë kompetenca në vëzhgimin dhe përshkrimin vizual të formës njerëzore dhe të aplikojnë këtë njohuri në punime të sakta dhe estetikisht të





shprehura. Qëllimi është të zhvillohen ndjeshmëria vizuale, precizoni teknik dhe vetëdija për strukturën si themel i krijimit figurativ.

Mësuesi:

4.2.1. Zotëron aftësi për të shpjeguar elementet e gjuhës pamore në kontekstin e trupit të njeriut: linjën, formën, vëllimin, teksturën, vlerat tonale, hapësirën dhe proporcionet e figurës së njeriut;

4.2.2. Zotëron aftësi për të shpjeguar parimet e kompozimit të trupit në hapësirë: balancën trupore, kontrastin mes formave anatomike, harmoninë e pjesëve trupore, ritmin e formës në lëvizje dhe unitetin vizual të figurës;

4.2.3. Interpreton shprehësinë e figurës njerëzore në art, duke analizuar rolin e anatomisë në komunikimin e emocioneve, dinamizmit dhe karakterit;

4.2.4. Analizon trajtimin estetik dhe teknik të trupit njerëzor në art, në funksion të elementeve formale dhe ideve shprehëse;

4.2.5. Klasifikon trajtimet e figurës njerëzore në periudha dhe kultura të ndryshme artistike (prej antikitetit idealizues deri te qasjet ekspresive bashkëkohore);

4.2.6. Shpjegon përdorimin e anatomisë në disiplina të ndryshme: vizatim, skulpturë, ilustrim, fotografi etj., duke analizuar mjetet dhe qasjet vizuale;

4.2.7. Ndjek konceptet anatomike (formë, qëndrim, lëvizje) në vepra arti të ndryshme, duke identifikuar tematika dhe ide të përbashkëta në kontekste historike, shoqërore dhe stilistike;

4.2.8. Analizon ndërthurjen e anatomisë në forma të tjera arti ku figura njerëzore luan rol qendror;


4.2.9. Njihet me sistemin skeletik dhe muskulator të trupit, strukturën dhe funksionin e tyre;

4.2.10. Përdor teknika artistike (laps, karbon, modelim me baltë/plastelinë) në mënyrë të sigurt për studimin e trupit;

4.2.11. Përdor procese artistike për përfaqësim anatomik: vizatim nga modeli i gjallë, skicim i muskujve/skeletit, modelim plastik etj.;

4.2.12. Analizon ndikimin e materialeve dhe teknikave në kuptimin e formës trupore dhe mënyrën vizuale të transmetimit;

4.2.13 Zhvillon metoda mësimore të përshtatura sipas moshës dhe nevojave psikologjike të nxënësve për perceptimin e formës;





- 4.2.14 Zbaton strategji të ndryshme mësimore si vizatim nga modeli, punë praktike, demonstrime dhe analiza vizuale;
- 4.2.15 Organizon mjedisin mësimor për të forcuar përqendrimin dhe interesin e nxënësve për figurën njerëzore;
- 4.2.16 Zhvillon metoda vlerësimi për përparimin në përmasat trupore, strukturën skeletike dhe muskulore;
- 4.2.17 Përshtat metodat dhe ritmet e mëimit sipas nevojave individuale, duke përfshirë vështirësitë me formën, lëvizjen dhe raportet trupore;
- 4.2.18 Përdor efektivisht teknologji vizuale (projektor, kompjuter), materiale ndihmëse (modele 3D, skanime digjitale), si dhe ambientin fizik për të përmirësuar procesin e nxënies në studimin e trupit.

4.3.LËNDA: PERSPEKTIVË


Lënda e Perspektivës synon zhvillimin e të kuptuarit vizual dhe teknik të nxënësve për përfaqësimin tredimensional të objekteve mbi një sipërfaqe dydimensionale.

Standardet e kësaj lënde përfshijnë zotërimin e njohurive bazë teorike mbi lëndën e perspektivës, aftësinë për të zbatuar këto njohuri në vizatime të sakta dhe krijuese, si dhe zhvillimin e shkathtësive për të analizuar dhe interpretuar hapësirën vizuale.

Nxënësit pritet të arrijnë kompetenca të tilla që të jenë në gjendje të krijojnë punime që respektojnë rregullat e perspektivës, duke integruar saktësinë teknike me shprehjen artistike për të transmetuar thellësi, volum e organizim hapësinor në kompozime.

Mësuesi:

- 4.3.1. Zotëron gjuhën vizuale në funksion të ndërtimit të perspektivës, përmes përdorimit të vijës, formës, hapësirës, dritës e hijes;
- 4.3.2. Shpjegon konceptet bazë: vija e horizontit, fusha e shikimit, pika e pamjes dhe thellësia;
- 4.3.3. Udhëzon nxënësit në ndërtimin e perspektivës lineare me një, dy dhe tri pika ikjeje, si dhe në përfaqësimin e thellësisë në një sipërfaqe të sheshtë;
- 4.3.4. Demonstron ndërtimin e një eksterieri duke përdorur forma gjeometrike(ndërtesa apo peizazh) nga pika të ndryshme shikimi;





4.3.5. Shpjegon mënyrën e vëzhgimit të natyrës e të realitetit përreth dhe transformimin e tij në një imazh të saktë e vizualisht të balancuar;

4.3.6. Demonstron përdorimin e perspektivës në lëndë të tjera artistike, si piktura, vizatimi, skenografia e fotografia;

4.3.7. Inkurajon punën praktike, eksperimentimin dhe zgjidhjen kreative të problemeve përmes projekteve të integruara dhe metodave të ndryshme mësimore;

4.3.8. Siguron mbështetje individuale, nxit përfshirjen dhe zbaton forma të ndryshme vlerësimi, duke u fokusuar te procesi krijues vizual;

4.3.9 Integron burime të ndryshme vizuale e tekstuale në procesin mësimor dhe krijues.

B. LËNDËT PRAKTIKE – ARTISTIKE

5.1. PIKTURË DHE VIZATIM

Në lëndët e Pikturës dhe Vizatimit, qëllimi është zhvillimi i aftësive vizuale, teknike dhe krijuese të nxënësve përmes një qasjeje të integruar ndërmjet teorisë dhe praktikës. Mësuesi zotëron njohuri të thella mbi historinë, zhvillimin dhe teknikat klasike e bashkëkohore të artit pamor, duke shpjeguar qartë gjuhën vizuale, raportet, kompozimin, si dhe vëzhgimin e përfaqësimit realist të figurës dhe natyrës përreth. Duke përdorur materiale e mjete të ndryshme, mësuesi nxit eksperimentimin, zgjidhjet origjinale dhe shprehjen personale; po ashtu, integron procesin e vëzhgimit si mjet për thellimin e kuptimit estetik. Procesin mësimor strukturohet në mënyrë të qartë, duke u mbështetur në planifikime të mirëorganizuara, referenca artistike dhe demonstrime vizuale, ku nxënësit udhëhiqen për të ndërtuar portofol krijues që reflektojnë progresin, stilin individual dhe përgatitjen për vazhdimin e studimeve të larta artistike.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit:

Mësuesi:

5.1.1. Zotëron njohuri dhe aftësi të thelluara në lëndën e pikturës dhe vizatimit;


5.1.2 Kombinon njohuritë e historisë së zhvillimit të lëndëve të pikturës dhe vizatimit;


5.1.3 Zotëron teknikat tradicionale dhe moderne të përdorura në pikturë dhe vizatim;

5.1.4 Shpjegon konceptet artistike të gjuhës së artit pamor për pikturën dhe vizatimin;


5.1.5 Shpjegon lëvizjet artistike që kanë ndikuar në këto disiplina;


5.1.6 Demonstron aftësi për të shpjeguar procesin krijues në secilën lëndë;





- 5.1.7 Zotëron aftësi në përdorimin e mjeteve dhe materialeve të ndryshme sipas lëndës që zhvillon;
- 5.1.8 Shfaq interes në përditësimin me teknologjitë e reja dhe i zbaton ato në krijimtarinë artistike;
- 5.1.9 Demonstron njohjen shumë të mirë të dokumentacionit: kurrikula artistike, programi mësimor, planifikimi sipas periudhave etj.;
- 5.1.10 Zhvillon planifikime mësimore të qarta e të strukturuar për secilën lëndë artistike për të cilën është përgjegjës;
- 5.1.11 Zotëron aftësi për t'i ndihmuar nxënësit në zhvillimin e shprehjes vizuale dhe të mendimit kritik;
- 5.1.12 Përshtat metodat artistike dhe pedagogjike me nevojat individuale të nxënësve në klasë;
- 5.1.13 Nxist mësimin bashkëpunues, punën në grup, eksplorimin artistik dhe eksperimente vizuale;
- 5.1.14 Zotëron aftësi për të strukturuar orën mësimore me hapa të qartë dhe objektiva specifike;
- 5.1.15 Përdor demonstrime vizuale, shembuj praktikë dhe referenca artistike;
- 5.1.16 Zhvillon projekte artistike që nxisin kreativitetin dhe zbatimin e njohurive e aftësive artistike;
- 5.1.17 Udhëzon nxënësit për krijimin e portofolëve personalë me punimet e tyre që reflektojnë progresin dhe stilin e tyre;
- 5.1.18 Integron teorinë me praktikën në mënyrë të kuptueshme dhe tërheqëse;
- 5.1.19 Demonstron aftësi inkurajuese dhe të paanshme gjatë procesit të vlerësimit të punimeve artistike të nxënësve;
- 5.1.20 Zotëron aftësi për të zhvilluar një sërë strategjish të mësimdhënies së artit pamor dhe zbatimin e tyre në përshtatje me lëndën që zhvillon;
- 5.1.21 Tregon aftësi në zhvillimin e ndjeshmërisë estetike dhe shprehjes personale përmes ngjyrës, formës dhe kompozimit;
- 5.1.22 Shpjegon, hap pas hapi, teknikat klasike e moderne të pikturës: akrilik, vaj, akuarel, tempera etj.;
- 5.1.23 Shpjegon modelet natyrore dhe figurative, përfshirë punën nga modeli i gjallë;
- 5.1.24 Zotëron aftësi për të shpjeguar teknikat bazë dhe të avancuara të ndërtimit në perspektivë: perspektiva me një, dy dhe tre pika ikjeje.






- 5.1.25 Forcon aftësinë e nxënësve për të realizuar kompozime realiste dhe arkitektonike;
- 5.1.26 Ndhmon ndërtimin e aftësive të menduarit logjik, konstruktiv dhe të vëzhgimit të detajuar;
- 5.1.27 Shpjegon mënyrën e vëzhgimit të natyrës e realitetit dhe transformimin e tij në imazh të saktë e vizualisht të balancuar;
- 5.1.28 Shpjegon rrugën e zhvillimit të dorës së sigurt dhe kontrollit të vijës përmes ushtrimeve të ndryshme (vijë konturi, vijë ndërtimi, vijë ekspresive);
- 5.1.29 Shpjegon trajtimin e raporteve, përmasave, proporcionit dhe kompozimit në hapësirë dy- e tredimensionale;
- 5.1.30 Shpjegon analizën e natyrës së qetë, objektit, figurës njerëzore dhe modelit të gjallë, e cila është thelbësore për zhvillimin e syrit artistik dhe ndjeshmërisë formale;
- 5.1.31 Shpjegon analizën strukturore të formës, dritës dhe hijes për të krijuar volum dhe iluzion hapësinor;
- 5.1.32 Zotëron përdorimin e materialeve të ndryshme: laps, qymyr, tus, sangjinë, pastel e të tjera, sipas qëllimit të ushtrimit apo projektit artistik;
- 5.1.33 Eksperimenton me tekstura, kontraste dhe dinamizëm kompozicional;
- 5.1.34 Ndërthurur vizatimin realist me shprehjen personale të nxënësit;
- 5.1.35 Nxit në zgjidhje origjinale dhe stil individual përmes projekteve të lira krijuese;
- 5.1.36 Inkurajon procesin e eksplorimit dhe vëzhgimit si mjet për të thelluar të kuptuarin artistik.

5.2. SKULPTURË

Lënda e Skulpturës në Liceun Artistik synon formimin e mendimit krijues tridimensional dhe të aftësive praktike në modelim, ndërtim dhe përpunim të formës skulpturore. Mësuesi zotëron njohuri të thelluara mbi elementët themelorë të formës si: masa, volumi, tekstura, si dhe mbi parimet kompozicionale që ndërtojnë harmoninë hapësinore. Ai udhëzon nxënësit në përdorimin e materialeve dhe teknikave të ndryshme: modelim, gdhendje, montim apo derdhje, duke theksuar lidhjen mes përzgjedhjes së teknikës dhe shprehjes artistike. Nëpërmjet analizës stilistike e estetike të veprave skulpturore nga epoka të ndryshme, nxënësit zhvillojnë ndjeshmëri vizuale, kuptim konceptual dhe shprehje personale. Mësimi integrohet me disiplina të tjera, si instalacion, dizajn e





performancë, duke nxitur bashkëpunim ndërdisiplinor dhe krijimin e veprave që reflektojnë mendim kritik dhe identitet artistik.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit:

Mësuesi:

5.2.1 Zotëron aftësi për të shpjeguar elementët themelorë të formës skulpturore: volumin, masën, hapësirën, vijën, teksturën dhe marrëdhënien me dritën e hijen;

5.2.2 Zotëron aftësi për të shpjeguar parimet kompozicionale në skulpturë: balanca, ritmi, simetria/asimetria, proporcioni dhe uniteti në formën tredimensionale;

5.2.3 Shpjegon mënyrën sesi cilësitë shprehëse të formës dhe materialit në skulpturë përdoren për të komunikuar ide, ndjesi apo përmbajtje simbolike;

5.2.4 Analizon elementët estetikë të një skulpture, duke vlerësuar raportin midis formës, teknikës dhe mesazhit artistik;

5.2.5 Klasifikon dhe interpreton karakteristikat stilistike të veprave skulpturore nga periudha e kultura të ndryshme historike e bashkëkohore;

5.2.6 Krahason elementët dhe parimet e përdorura në vepra skulpturore me ato të disiplinave të tjera të artit pamor;

5.2.7 Shpjegon marrëdhënien e skulpturës me arkitekturën, dizajnin, pikturën apo median digjitale në kontekste të ndryshme artistike;

5.2.8 Prezanton mënyrat sesi skulptura ndërthuret me zhanre të tjera, si instalacioni, arti konceptual apo performanca;

5.2.9 Bashkëpunon me mësues të tjerë artistikë për të krijuar projekte ndërdisiplinore që përfshijnë elementë skulpturore;

5.2.10 Zotëron aftësi për të përdorur në mënyrë të sigurt mjete e materiale të skulpturës si balta, gipsi, druri, metali etj.;

Shpjegon teknikat e modelimit, gdhendjes, derdhjes apo montimit në skulpturë;

5.2.11 Analizon sesi përzgjedhja e teknikës dhe materialit ndikon në përmbajtjen dhe ndikimin vizual të veprës skulpturore;

5.2.12 Orienton nxënësit në zhvillimin e proceseve skulpturore në përputhje me idenë artistike;

5.2.13 Udhëzon nxënësit në përdorimin e proceseve krijuese për të transformuar një ide në formë skulpturore;



5.2.14 Thekson rëndësinë e planifikimit dhe zgjedhjes së teknikës së përshtatshme për realizimin e një veprë skulpturore;

5.2.15 Mbështet krijimin e veprave në formate realiste, abstrakte apo konceptuale, duke respektuar parimet e artit tredimensional;

5.2.16 Zhvillon aftësitë manipuluese përmes eksperimenteve me forma, materiale dhe tekstura skulpturore.

C. LËNDËT E SPECIALITETEVE:


Lëndët e specialiteteve praktike, si Grafikë, Tekstil-modë, Skenografi-kostumografi, Fotografi, Qeramikë dhe Gdhendje në gur apo dru, synojnë zhvillimin e aftësive teknike dhe shprehëse të nxënësve në funksion të identitetit artistik, personal dhe profesional. Mësuesi udhëheq procesin krijues, duke integruar njohuritë teknologjike, materiale dhe vizuale në çdo disiplinë, dhe përshtat metodologjinë me karakterin e secilës fushë. Ai demonstroi teknikat specifike të përpunimit tradicional dhe bashkëkohor, si dhe aftësinë për të lidhur konceptin me zbatimin praktik, duke nxitur ndërthurjen ndërdisiplinore dhe realizimin e projekteve funksionale dhe artistike. Përmes analizës së stileve, historisë së artit dhe eksplorimit vizual, nxënësit aftësohen të krijojnë vepra autentike që reflektojnë zgjidhje origjinale dhe kuptim të thelluar të formës, funksionit e kontekstit kulturor.


C.6.1. SPECIALITETI: TEKSTIL- MODË

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit:


Mësuesi:


- 6.1.1. Zotëron informacion të saktë për të shpjeguar qartë elementët vizualë si vijën, formën, ngjyrën, strukturën dhe teksturën në funksion të dizajnit të veshjes;
- 6.1.2. Përdor ilustrimin e modës si mjet për të zhvilluar të menduarin vizual dhe për të komunikuar idetë e dizajnit, duke udhëhequr nxënësit në ndërtimin e një “moodboard” që përfshin elementë artistikë dhe ndjesorë;
- 6.1.3. Zotëron aftësinë që nxënësit të kuptojnë se si një vepër arti mund të kthehet në frymëzim për një koleksion veshjesh, duke përdorur teknika të ndryshme për të analizuar veprat e artit në lidhje me tekstin dhe veshjen;
- 6.1.4. Zotëron aftësinë që nxënësit të kuptojnë ndikimin e artit në modë në periudha të ndryshme historike, duke zhvilluar aktivitete që nxisin eksperimentimin me ngjyrë e formë përtej estetikës konvencionale;
- 6.1.5. Promovon përdorimin e artit pamor për të përçuar mesazhe të forta sociale dhe





- personale përmes veshjes, duke aftësuar nxënësit të analizojnë veshjen si vepër arti e jo vetëm si objekt funksional;
- 6.1.6. Shpjegon në mënyrë të qartë teknikat bazë të prerjes, qepjes e përfundimit të një veshjeje dhe udhëzon nxënësit të përdorin saktë veglat e prerjes e qepjes, duke ruajtur simetrinë e përmasat;
 - 6.1.7. Përdor demonstrime vizuale e projekte konkrete për të forcuar njohuritë teknike;
 - 6.1.8. Udhëzon nxënësit në përdorimin korrekt e të sigurt të makinave qepëse e veglave ndihmëse, dhe prezanton pjesët e makinës qepëse, mënyrën e mirëmbajtjes e rregullat për përdorim të sigurt;
 - 6.1.9. Krijon kushte që nxënësit të mësojnë të qepin në mënyrë të pavarur, por gjithmonë nën mbikëqyrje, dhe i mëson të përdorin hekurin, thurëset, metrat matës e veglat prerëse me kujdes e respekt për materialin;
 - 6.1.10. Zotëron aftësinë për të prezantuar nxënësve qëndisjen me dorë, thurjen, aplikimin dhe ngjyrosjen natyrale, duke i vendosur këto në kontekst kulturor dhe historik;
 - 6.1.11. Aplikon një gamë të gjerë metodash mësimore të përshtatura për fushën e tekstitit e modës;
 - 6.1.12. Siguron që çdo koncept teorik të mbështetet me një aplikim konkret përmes punës krijuese me tekstile dhe dizajn;
 - 6.1.13. Inkurajon eksplorimin e ideve origjinale dhe përdor mjete vizuale, digjitale dhe materiale për të nxitur mendimin dizajnues, duke i udhëzuar në hapat nga ideja deri te produkti final;
 - 6.1.14. Krijon ambiente mësimore të sigurta e frymëzuese për punë krijuese, duke siguruar një hapësirë ku nxënësit ndihen të lirë të shprehin veten përmes eksperimentimit e punës bashkëpunuese;
 - 6.1.15. Analizon suksesin e qasjeve të përdorura në klasë, duke marrë parasysh reagimet dhe nevojat e nxënësve;
 - 6.1.16. Zotëron aftësinë të shpjegojë karakteristikat teknike të materialeve: elasticitetin, qëndrueshmërinë, rrjedhshmërinë e aftësinë për të marrë formë;
 - 6.1.17. Inkurajon eksplorimin e materialeve të ricikluara dhe alternative, si tekstilet vegane, biodegraduese apo eksperimentale;
 - 6.1.18. Demonstron njohuri të thella për procesin krijues në tekstil e modë duke përfshirë fazat themelore e të avancuara, nga gjenerimi i ideve, zhvillimi konceptual, eksperimentimi e realizimi përfundimtar;






- 6.1.19. Ka njohuri të gjera mbi mënyrat se si kultura, historia dhe trendet bashkëkohore ndikojnë në procesin krijues;
- 6.1.20. Nxit eksperimentimin me materiale e teknika të ndryshme të tekstilit dhe modës;
- 6.1.21. Demonstron teknika të ndryshme (qepje, printim, ngjyrosje, punim dore, dekonstruktion etj.);
- 6.1.22. Krijon një ambient mësimor që nxit krijimtarinë dhe eksperimentimin;
- 6.1.23. Ndhmon nxënësit të kuptojnë se si teknologjia mund të lehtësojë procesin nga ideja deri tek prototipi përfundimtar;
- 6.1.24. Krijon mundësi për eksperimentim me dizajn digjital dhe ndërthurjen e teknologjisë me krijimtarinë artizanale, duke ndërtuar një urë mes traditës e inovacionit.


6.2.SPECIALITETI: GRAFIKË

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit:


Mësuesi:

- 6.2.1 Zotëron aftësi për të shpjeguar elementët bazë të grafikes: vijën, siluetën, ngjyrën, teksturën, kontrastin dhe hapësirën;
- 6.2.2 Zotëron aftësi për të shpjeguar parimet e kompozimit në grafikë: ekuilibrin, unitetin dhe marrëdhënien figurë–sfond;
- 6.2.3 Demonstron teknika të ndryshme të grafikës, si linogravurë, ksilografi, gjilpërë e thate, ofort, monotyp dhe teknikë digjitale;
- 6.2.4 Siguron që nxënësit të kuptojnë përdorimin e mjeteve e materialeve grafike në mënyrë të sigurt e krijuese;
- 6.2.5 Integron teknologjinë në procesin mësimor përmes softuerëve grafikë si Adobe Illustrator, Photoshop, etj.;
- 6.2.6 Demonstron njohuri të thelluara mbi teknikat klasike (linogravurë, ksilografi, ofort, gjilpërë e thatë, monotyp) dhe grafikën në kompjuter;
- 6.2.7 Udhëzon nxënësit në përdorimin e duhur të mjeteve e pajisjeve për secilën teknikë;
- 6.2.8 Promovon eksplorimin e teknikave të reja e të kombinuara, përfshirë grafikën digjitale dhe teknikat e përziera;
- 6.2.9 Udhëzon nxënësit në ndjekjen e një procesi të plotë krijues: nga ideja, te skica, boceti, përgatitja e pllakës, shtypja dhe prezantimi i veprës;





- 6.2.10 Edukon nxënësit në menaxhimin e kohës, organizimin e hapësirës së punës dhe ruajtjen e materialeve;
- 6.2.11 Edukon nxënësit për përdorimin e sigurt të materialeve dhe mjeteve (bojërat, solucionet, prerëset, presat etj.);
- 6.2.12 Promovon ndërgjegjësimin për mjedisin përmes përdorimit të materialeve të qëndrueshme në proceset grafike;
- 6.2.13 Inkurajon nxënësit të mbajnë bllok skicash dhe portofol të zhvillimit të tyre teknik;
- 6.2.14 Ndhmon nxënësit të gjenerojnë ide përmes kërkimit vizual, diskutimeve, temave të caktuara apo eksperiencave personale;
- 6.2.15 Promovon kërkimin për artistë, stile, periudha historike dhe teknika që lidhen me temën apo projektin;
- 6.2.16 Integron burime të ndryshme vizuale e tekstuale në procesin krijues;
- 6.2.17 Nxit eksperimentimin e teknikave të ndryshme për të gjetur zgjidhjen më të përshtatshme për idenë artistike;
- 6.2.18 Inkurajon marrjen e vendimeve krijuese dhe reflektimin mbi to;
- 6.2.19 Fton nxënësit të analizojnë punën e tyre dhe të tjerëve në mënyrë konstruktive;
- 6.2.20 Përdor metoda vizuale, praktike, analitike dhe reflektive për të përcjellë njohuritë mbi grafikën;
- 6.2.21 Kombinon ligjërimin, demonstrimin, punën individuale dhe atë në grup në mënyrë të balancuar;
- 6.2.22 Inkurajon të mësuarit përmes zbulimit, eksperimentimit dhe zgjidhjes së problemeve artistike;
- 6.2.23 Zbaton mësim të diferencuar sipas niveleve të përgatitjes, interesave e aftësive të nxënësve;
- 6.2.24 Ofron udhëzime të personalizuara dhe mbështetje për të nxitur përfshirjen;
- 6.2.25 Zbaton metoda vlerësimi që përfshijnë vetëvlerësimin, vlerësimin nga bashkëmoshatarët dhe vlerësim nga mësuesi;
- 6.2.26 Bazohet jo vetëm në produktin përfundimtar, por edhe në procesin, përpjekjen dhe përparimin individual të nxënësve;
- 6.2.27 Analizon së bashku me nxënësit punë grafike që pasqyrojnë identitete, tradita dhe ndryshime kulturore;
- 6.2.28 Promovon respektin për larminë kulturore nëpërmjet eksplorimit të stileve apo teknikave grafike nga kultura të ndryshme botërore;





- 6.2.29 Inkurajon nxënësit të eksplorojnë historinë e grafikës në Shqipëri.
- 6.2.30 Udhëzon nxënësit të përdorin grafikën për të shprehur mendime mbi çështje sociale, si barazia, mjedisi, drejtësia e të drejtat e njeriut;
- 6.2.31 Nxit zhvillimin e projekteve që pasqyrojnë angazhimin qytetar përmes artit;
- 6.2.32 Ndhmon nxënësit të analizojnë grafikën në funksion të kohës dhe vendit ku është krijuar.


6.2. SPECIALITETI: FOTOGRAFI

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit:

Mësuesi:

- 6.2.1 Njeh elementët bazë të gjuhës vizuale (drita, kompozimi, ngjyrat, linjat, teksturat, forma, ritmi etj.) dhe i përdor për të analizuar e krijuar fotografi kuptimplota;
- 6.2.2 Zotëron aftësi për të shpjeguar parimet e kompozimit: *ekuilibrin, kontrastin, harmoninë, lëvizjen dhe unitetin*;
- 6.2.3 Njeh e përdor në mënyrë efektive pajisjet fotografike (kamera, lente, ndriçim, etj.), duke i njohur nxënësit për funksionet teknike dhe përdorimin praktik të tyre;
- 6.2.4 Ndhmon nxënësit të kuptojnë e të përdorin fotografinë si një formë komunikimi artistik e shoqëror, duke lidhur përmbajtjen me kontekstin;
- 6.2.5 Nxit tek nxënësit ndjeshmëri ndaj bukurisë, emocioneve dhe mesazhit të një fotografie, duke i inkurajuar të analizojnë me sy kritik krijimet e tyre e të tjerëve;
- 6.2.6 Prezanton fotografi nga periudha, stile dhe autorë të ndryshëm, duke ndihmuar nxënësit t'i vendosin veprat në një kontekst më të gjerë historik, kulturor e teknologjik;
- 6.2.7 Zbaton dhe demonstroi përdorimin krijues të teknologjive të fotografisë (analoge e digjitale), duke lidhur gjuhën artistike me aftësitë teknike;
- 6.2.8 Demonstroi teknika si kompozimi, ekspozimi, fokusi, perspektiva, balancimi i ngjyrave, etj., duke ndihmuar nxënësit të kuptojnë ndikimin e secilës në rezultati vizual;
- 6.2.9 Aftëson nxënësit në përdorimin e mjeteve përpunuese (Photoshop, Lightroom e aplikacione të tjera), si dhe proceseve tradicionale të dhomës së errët (kur janë të aplikuara);
- 6.2.10 Prezanton dhe eksperimenton me teknika moderne e eksperimentale (si ekspozimi i gjatë, dyfishimi i imazhi, montazhi, përdorimi kreativ i dritës, etj.);






- 6.2.11 Inkurajon nxënësit të dokumentojnë, hulumtojnë dhe reflektojnë mbi procesin krijues: nga konceptimi e planifikimi, te realizimi teknik e përfundimi estetik;
- 6.2.12 Ndhmon nxënësit të gjenerojnë ide, të formulojnë koncepte e të vendosin synime përmes metodave si brainstorming, hulumtim vizual, analizë tematike dhe reflektim personal;
- 6.2.13 Udhëzon nxënësit në ndërtimin e një plani krijues: përzgjedhjen e vendndodhjes, subjekteve, ndriçimit, pajisjeve dhe teknologjisë që do të përdoren;
- 6.2.14 Nxiti lirinë krijuese dhe gatishmërinë për të eksperimentuar me gjini të ndryshme (portret, peizazh, natyrë e qetë, video art, etj.);
- 6.2.15 Inkurajon analizën e vazhdueshme të punës gjatë fazave të ndryshme të krijimit: çfarë funksionon, çfarë jo, çfarë mund të përmirësohet;
- 6.2.16 Ndhmon nxënësit në përzgjedhjen, redaktimin dhe prezantimin e punës përfundimtare (ekspozita, portofol digjitalë/fizikë), duke promovuar përgjegjësinë artistike dhe aftësinë për të komunikuar mesazhin vizual;
- 6.2.17 Përdor strategji pedagogjike si mësimi përmes projektit, mësimi bazuar në probleme, puna në grup, eksperimentimi e reflektimi për të nxitur përfshirjen e nxënësve;
- 6.2.18 Vlerëson mënyrat e të nxënit të nxënësve dhe i përshtat aktivitetet mësimore për t'i përfshirë të gjithë;
- 6.2.19 Zhvillon mësim të integruar me teknologji digjitale (prezantime multimediale, redaktim imazhesh, platforma online, galeri virtuale, etj.) si pjesë aktive e mësimdhënies bashkëkohore;
- 6.2.20 Përdor teknika vlerësimi të shumëllojshme: vlerësim nga bashkëmoshatarët, vetë-vlerësim dhe analiza e portofolit;
- 6.2.21 Ndhmon nxënësit të eksplorojnë vetë, të bëjnë kërkime mbi artistë, stile e teknika, dhe të zhvillojnë studime përtej mësimi në klasë.

6.3. SPECIALITETI: SKENOGRAFI- KOSTUMOGRAFI

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit:

Mësuesi:

- 6.3.1. Zhvillon njohuritë mbi elementet bazë të gjuhës vizuale (vija, ngjyra, forma, tekstura, hapësira);






- 6.3.2. Analizon me nxënësit përdorimin e këtyre elementeve në vepra skenografike dhe kostumografike;
- 6.3.3. Ushtron krijimin e skicave dhe kompozimeve bazuar në gjuhën vizuale;
- 6.3.4. Nxit interpretimin personal të gjuhës artistike në zgjidhje skenike dhe kostumografike;
- 6.3.5. Prezanton referenca vizuale nga fusha të ndryshme të artit për të ilustruar ndikimin e tyre mbi skenën dhe kostumin;
- 6.3.6. Ushtron projekte që ndërthurin elementë nga më shumë se një disiplinë artistike;
- 6.3.7. Analizon me nxënësit mënyrën sesi një vepër tjetër arti ndikon në ndërtimin e një hapësire skenike apo karakteri;
- 6.3.8. Ndhmon nxënësit të krijojnë lidhje konceptuale mes skenës, zërit, lëvizjes dhe elementeve pamore;
- 6.3.9. Demonstron përdorimin korrekt të teknikave vizatimore dhe të projektimit;
- 6.3.10. Zbaton teknika për realizimin e maketeve fizike dhe përzgjedhjen e materialeve të përshtatshme;
- 6.3.11. Zhvillon projekte kostumografike me qasje funksionale dhe estetike;
- 6.3.12. Përdor teknologji moderne për modelim dhe dizajn skenik ose kostumografik;
- 6.3.13. Udhëzon nxënësit në hapat e procesit krijues, nga kërkimi deri te produkti final;
- 6.3.14. Inkurajon zhvillimin e stilit personal dhe të rrëfimit vizual;
- 6.3.15. Mundëson dokumentimin e procesit me skica, fotografi dhe reflektime;
- 6.3.16. Zhvillon vetëvlerësimin dhe mendimin kritik në çdo fazë të punës;
- 6.3.17. Zbaton metoda mësimore aktive, si puna me projekte, analiza vizuale dhe puna në grup;
- 6.3.18. Përshtat teknikat sipas niveleve të nxënësve dhe stileve të të nxënit;
- 6.3.19. Ndërthur teorinë me praktikën artistike në mënyrë funksionale;
- 6.3.20. Përdor mjete digjitale dhe burime ndërdisiplinore për të pasuruar procesin mësimor.

6.5. SPECIALITETI: QERAMIKË, GDHENDJE GUR DHE DRU

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit:

Mësuesi:

- 6.5.1 Zotëron aftësi për të shpjeguar elementët themelore të formës qeramike: volumin, siluetën, vijën, teksturën, ngjyrën dhe marrëdhënien me sipërfaqen;





- 6.5.2 Zotëron aftësi për të shpjeguar parimet kompozicionale në objektet qeramike: balancën, ritmin, simetrinë, unitetin dhe dekorimin sipërfaqësor;
- 6.5.3 Shpjegon mënyrën sesi cilësitë shprehëse të formës, materialit dhe glazurës përdoren për të komunikuar ide dhe funksion;
- 6.5.4 Analizon elementet estetike dhe funksionale të veprave qeramike, duke vlerësuar marrëdhënien midis formës, funksionit dhe dekorit;
- 6.5.5 Klasifikon dhe interpreton stilet dhe teknikat e ndryshme të qeramikës historike e bashkëkohore nga kultura të ndryshme;
- 6.5.6 Krahason elementët dhe parimet e përdorura në objektet qeramike me ato të arteve pamore dhe zbatuese;
- 6.5.7 Shpjegon ndërthurjen e qeramikës me dizajnin industrial, artin popullor dhe artin bashkëkohor;
- 6.5.8 Ilustron mënyrat sesi objektet qeramike ndërthuren me funksione praktike dhe estetike në kontekste të ndryshme;
- 6.5.9 Promovon bashkëpunimin me lëndë të tjera për të krijuar projekte që përfshijnë qeramikën si medium krijues;
- 6.5.10 Zotëron aftësi për të përdorur teknikat bazë të ndërtimit të formave qeramike: modelim me dorë, pllaka dhe qendërzim me çark;
- 6.5.11 Shpjegon procesin e tharjes, pjekjes dhe glazurimit të objekteve qeramike;
- 6.5.12 Analizon sesi zgjedhja e teknikës dhe materialit ndikon në përmbajtjen, funksionin dhe pamjen estetike të punimit qeramikë;
- 6.5.13 Respekton rregullat e sigurisë në përdorimin e pajisjeve dhe lëndëve kimike gjatë punës me qeramikën;
- 6.5.14 Orienton nxënësit në zhvillimin e ideve që shndërrohen në objekte funksionale apo dekorative përmes teknikave qeramike;
- 6.5.15 Planifikon procesin krijues, duke vlerësuar formën, funksionin dhe dekorin sipas synimit artistik;
- 6.5.16 Mbështet eksperimentimin me forma, sipërfaqe dhe ngjyrosje në realizimin e punimeve qeramike;
- 6.5.17 Mbështet zhvillimin e krijimeve qeramike në stil realist, abstrakt apo konceptual, duke theksuar aspektet teknike dhe shprehëse.

6.6. SPECIALITETI: GDHENDJE GUR DHE DRU

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit:



Mësuesi:

- 6.6.1 Shpjegon elementët e formës në gdhendje: relievin, thellësinë, konturin, vijën, teksturën dhe marrëdhënien me dritën dhe materialin;
- 6.6.2 Zotëron njohuri mbi strukturën kompozicionale të objekteve të gdhendura: simetrinë/asimetrinë, balancën dhe harmoninë vizuale;
- 6.6.3 Shpjegon ndikimin e përzgjedhjes së drurit apo gurit në shprehjen formale dhe estetike të veprës së gdhendur;
- 6.6.4 Analizon elementët shprehëse të gdhendjes përmes ndërveprimit të formës me sipërfaqen dhe volumin;
- 6.6.5 Klasifikon stilet dhe motivet tradicionale dhe bashkëkohore në gdhendje nga kultura dhe periudha të ndryshme historike;
- 6.6.6 Krahason teknikat dhe shprehjet në gdhendje me ato në pikturë, dizajn, skulpturë apo arkitekturë dekorative;
- 6.6.7 Shpjegon ndërveprimin e gdhendjes me artin tradicional dhe artizanatin funksional (mobiliери, ikonografia, orenditë fetare);
- 6.6.8 Ilustron sesi elementët e gdhendur përfshihen në objekte dhe ambiente interieri dhe eksterieri;
- 6.6.9 Bashkëpunon me disiplina të tjera për të krijuar projekte të ndërthurura që përfshijnë gdhendjen si komponent funksional dhe estetik;
- 6.6.10 Zotëron aftësi për të përdorur mjete të ndryshme për gdhendje: daltë, çekiq, rrotë elektrike dhe mjete precize për detaje;
- 6.6.11 Shpjegon teknikat bazë dhe të avancuara të gdhendjes në reliev të ulët, të lartë dhe në thellësi;
- 6.6.12 Analizon lidhjen mes teknikës së përdorur dhe efektit vizual dhe shprehës të gdhendjes;
- 6.6.13 Zbaton rregullat e sigurisë gjatë përpunimit të gurit dhe drurit në ambientet praktike;
- 6.6.14 Përdor metoda të bazuara në praktikë për të nxitur të menduarit kreativ dhe aftësitë manuale në gdhendje;
- 6.6.15 Organizon vendin e punës në mënyrë të sigurt dhe funksionale për përpunimin e drurit dhe gurit;
- 6.6.16 Zbaton forma vlerësimi që marrin parasysh procesin krijues dhe cilësinë përfundimtare të gdhendjes;



6.6.17 Ndërthur temat e gdhendjes me mësimet për trashëgiminë kulturore, dizajnin funksional dhe artin publik.



STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT

Për shkollat artistike me status të veçantë

Dega: Balet

Tiranë, 2025



TABELA E PËRMBAJTJES

I. PJESA E PARË: TË PËRGJITHSHME	3
1.1 Hyrje	3
1.2 Përse kanë rëndësi këto standarde?.....	3
1.3 Struktura e standardit.....	6
 II. PJESA E DYTË: STANDARDET PROFESIONALE TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM ARTISTIK TË MËSUESIT	 6
Standardi 1. Njohja dhe zbatimi i dokumenteve arsimore	10
Standardi 2. Përgatitja shkencore	11
Standardi 3. Kurrikula artistike dhe mësimdhënia.....	12
Standardi 4. Vlerësimi.....	13
Standardi 5. Zhvillimi profesional dhe personal.....	15
Standardi 6. Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët	16
Standardi 7. Bashkëpunimi me komunitetin.....	18
Standardi 8. Mjedisi mësimor	19
 III. PJESA E TRETË: STANDARDET PROFESIONALE TË VETËVLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË MËSUESIT	 22
3.1 Përshkrimi i përgjithshëm i niveleve	22
3.2 Vetëvlerësimi për standardet e përgjithshme profesionale	25
 IV. PJESA E KATËRT: STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT SIPAS TRE GRUPEVE TË LËNDËVE: TEORIKE ARTISTIKE, LËNDËT E TJERA TË KËRCIMIT, MJESHTËRISË SË KËRCIMIT.....	 27





I. PJESA E PARË: TË PËRGJITHSHME

1.1 Hyrje

Standardet profesionale të mësuesit së shkollës me status të veçantë, dega Balet, përshkruajnë kriteret që priten nga mësime dhe artit të kërcimit (baletit). Kjo shkollë krijon kushte dhe ofron mundësi që nxënësi të:

- ndërtojë dhe zhvillojë kompetencat artistike të nevojshme për artin e kërcimit (baletit), në përputhje me nevojat dhe interesat e shoqërisë;
- zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe të gjithanshme;
- kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien personale dhe të shoqërisë shqiptare;
- përballet në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Standardet profesionale të mësuesit në këtë shkollë kërkojnë që zhvillimi i tyre të fokusohet fuqishëm në rezultatet e nxënësve dhe të gjithë trupës mësimore. Mësuesve u duhet t'u ofrohet mundësia për të marrë pjesë në trajnime dhe seminare profesionale, çka i ndihmon ata të përmirësohen dhe të angazhohen në progresin dhe suksesin artistik të nxënësve. Zhvillimi intensiv dhe i vazhdueshëm profesional, i orientuar nga standardet dhe treguesit e matshëm, ndihmon mësuesit të avancojnë dhe të vlerësojnë ecurinë e performancës së tyre artistike dhe profesionale si mësime dhe.

Dokumenti i standardeve profesionale të mësuesit të shkollës koreografike me status të veçantë, dega Balet, i hartuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), përmban:

1. Standardet profesionale dhe kriteret e **formimit të përgjithshëm** të mësuesit të shkollës koreografike me status të veçantë, dega Balet.
2. Standardet profesionale dhe kriteret sipas **specifikave të kurrikulës artistike**, për mësuesit sipas lëndëve.
3. Standardet profesionale dhe kriteret e **vetëvlerësimit të performancës** së mësuesit, bazuar në këto standarde.

1.2 Përse kanë rëndësi këto standarde?

Standardet profesionale të mësuesit të shkollës koreografike me status të veçantë, dega Balet, përcaktojnë njohuritë, aftësitë dhe sjelljet që çdo mësues i artit të kërcimit duhet të zotërojë, të kuptojë dhe të demonstrojë, bazuar në kurrikulën artistike. Këto standarde



janë të domosdoshme për vetë mësuesit e baletit në institucionet me status të veçantë, sepse dokumenti i standardeve: i mbështet ata në vlerësimin e performancës në mësimdhënie, i ndihmon të identifikojnë pikat e forta dhe nevojat për përmirësim, i orienton drejt vetëvlerësimit të përparimit profesional, pedagogjik dhe artistik. Përmes këtyre standardeve përcaktohet qartë **vizioni për mësimdhënien artistike** dhe ofrohet një panoramë e qartë e objektivave të synuara. Ato përfshijnë tregues të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve (si pedagogjike, ashtu edhe artistike), për të cilat mësuesi angazhohet t'i realizojë për të përmbushur me sukses rolin e tij. Standardet funksionojnë si udhërrëfyes për kompetencën dhe nivelin profesional të çdo mësuesi. **Nivelet e performancës pedagogjike dhe artistike** pasqyrojnë **se si** mësuesi i baletit përmbush kërkesat e standardeve. Duke ditur objektivat profesionale, mësuesi punon në mënyrë të vazhdueshme për zhvillimin e vet personal dhe profesional, duke rritur kualitetin e mësimdhënies dhe ndikimin artistik. Edhe pse nevojat individuale të mësuesve mund të ndryshojnë, ekzistojnë fusha të përbashkëta që kërkojnë trajnim specifik. Përmbushja e standardeve mbështet avancimin në karrierë dhe procesin e kualifikimit profesional. Një mësues me performancë të kënaqshme dhe rezultate të shkëlqyera kontribuon drejtpërdrejt në përparimin e nxënësve. Standardet profesionale për mësuesit e baletit janë një ndihmë e rëndësishme edhe për drejtuesit e shkollës, veçanërisht kur: duhet të identifikojnë nevojat profesionale të stafit, planifikojnë dhe menaxhojnë së bashku me mësuesit planet e zhvillimit profesional, organizojnë vlerësimin periodik të performancës.

Gjithashtu, standardet **pedagogjike dhe artistike** i shërbejnë drejtuesit të shkollës për:

- vlerësimin periodik të performancës së mësuesve;
- kuptimin dhe monitorimin e zhvillimit profesional të tyre;
- identifikimin dhe porositjen, së bashku me mësuesit, të formave më të përshtatshme të zhvillimit profesional dhe të literaturës përkatëse për këtë qëllim.

Përzgjedhja e një mësuesi për të punuar në një institucion arsimor artistik duhet të bazohet në përgjigjen e pyetjes: **"Në çfarë mase kandidati përmbush të dyja llojet e standardeve të mësuesit, ato pedagogjike dhe ato artistike?"**

Këshilli i mësuesve, ekipet lëndore dhe komisioni psikosocial mund ti përdorin këto standarde për të përmirësuar klimën në shkollë dhe cilësinë e procesit të mësimor. Ato shërbejnë gjithashtu për të përcaktuar temat e diskutimeve profesionale dhe për të





analizuar arritjet e nxënësve. Përfaqësuesit e komunitetit të shkollës, si bordi dhe këshilli i prindërve, mund t'i shqyrtojnë këto standarde për të kuptuar më mirë cilësinë e shërbimit arsimor që ofron institucioni. Përfaqësuesit e komunitetit, si bordi i shkollës dhe këshilli i prindërve, mund të shqyrtojnë standardet për të kuptuar më mirë cilësinë e shërbimit arsimor që ofron shkolla.

Ministria e Arsimit mbështetet në këto standarde për të hartuar politikat mbarëkombëtare të zhvillimit profesional të mësuesve që zbatojnë kurrikulën artistike. Ajo i përdor standardet gjithashtu për të përgatitur udhëzime, urdhra dhe rregullore që lidhen me mësuesit. Kualifikimi dhe trajnimi i tyre bazohet pikërisht mbi këto standarde. **Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)** identifikon nevojat për zhvillim profesional të mësuesve të artit të kërcimit, baletit në shkollat artistike me status të veçantë, harton programe dhe module trajnimi në nivel kombëtar, si dhe përgatit modele për vlerësimin e performancës së mësuesit.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) i mbështet mësuesit në përmbushjen e këtyre standardeve përmes procesit të vlerësimit të jashtëm të performancës.

Njësitë arsimore vendore (DRAP/ZVA), të mbështetura në standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe ato sipas profileve artistike, hartojnë planet e zhvillimit profesional të mësuesve dhe planifikojnë veprimtaritë e rrjeteve profesionale.

Fakulteti i Artit Skenik, dega Koreografi mbështetet në këto standarde për të hartuar standardet e formimit fillestar të mësuesve, në përputhje me kurrikulën shkencore dhe artistike, si dhe për formimin e përgjithshëm të studentëve, duke i përgatitur ata për procesin e licencimit dhe më gjerë.

Këshillat dhe shoqatat e mësuesve mbajnë parasysh të dyja llojet e standardeve, për të identifikuar nevojat më të rëndësishme profesionale dhe artistike në nivel shkolle, si dhe për të planifikuar veprimtaritë e zhvillimit dhe këshillimit profesional të mësuesve.

OJF-të, donatorët dhe shoqatat e interesuara për zhvillimin profesional të mësuesve të arteve, kanë nevojë për një dokument të plotë mbi standardeve profesionale të mësuesit të shkollave artistike. Ky dokument u mundëson të ndërtojnë bashkëpunime të suksesshme me institucionet arsimore dhe të përcaktojnë më saktë kontributet e tyre në fushën e arsimit.





1.3 Struktura e standardit

Struktura e standardit pedagogjiko - artistik përfshin titullin dhe përshkrimin përmbledhës të tij. Çdo standard shoqërohet me një grup treguesish të detajuar dhe të matshëm, të cilët i referohen në mënyrë të harmonizuar njohurive që duhet të zotërojë mësuesi i kërcimit/baletit. Këta tregues klasifikojnë aftësitë që mësuesi duhet të demonstrojë dhe pasqyrojnë qëndrimet dhe vlerat që e karakterizojnë atë gjatë procesit të mësimdhënie-nxënies në lëndët e ndryshme të kurrikulës artistike. Treguesit vlerësohen sipas niveleve përkatëse, të përshkruara në këtë dokument.

II.PJESA E DYTË: STANDARDET PROFESIONALE TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM ARTISTIK TË MËSUESIT

Standardet profesionale të formimit artistik të mësuesit për shkollën koreografike me status të veçantë, dega Balet

Standardet profesionale për artin e kërcimit në arsimin e orientuar artistik, dega Balet, përshkruajnë kriteret që priten të përmbushen nga mësuesit e kërcimit/baletit. Këto standarde trajtojnë aspekte të ndryshme të mësimdhënies dhe përfshijnë:

- a) Aspekte që lidhen me zbatimin e dokumenteve arsimore;
- b) Aspekte që lidhen me përmbajtjen e kurrikulës së kërcimit/baletit, përmes demonstrimit të njohurive dhe aftësive artistike;
- c) Aspekte që lidhen me zbatimin e metodologjisë artistike të kërcimit/baletit dhe krijimin e një mjedisi pozitiv të të nxënit;
- d) Aspekte që lidhen me përdorimin e njohurive për një vlerësim të drejtë, të saktë dhe të paanshëm;
- e) Aftësitë për të ndërtuar një mjedis pozitiv, miqësor dhe bashkëpunues, brenda edhe jashtë shkollës, me kolegët, drejtuesit dhe komunitetin.

Standardet profesionale të mësimdhënies janë gjithsej tetë (8) dhe ofrojnë kritere specifike që ndihmojnë në përcaktimin e nivelit profesional të mësuesit të kërcimit/baletit. Ato përcaktojnë nivelin e kërkuar të kompetencës profesionale në këtë fushë dhe përbëjnë bazën për vlerësimin dhe zhvillimin profesional të mësuesit, në përputhje me kërkesat e shkollave artistike me status të veçantë. Më poshtë paraqiten përshkrimet e detajuara për secilin prej këtyre standardeve:





Standardi 1. Njohja dhe zbatimi i dokumenteve arsimore

Mësuesi zotëron njohuritë e nevojshme mbi dokumentacionin që i duhet çdo mësuesi për zhvillimin e procesit mësimor në përputhje me standardet profesionale. Ky standard lidhet me njohjen dhe përdorimin e dokumenteve bazë, të domosdoshme për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies. Mësuesi e planifikon punën e tij mbi bazën e disa dokumenteve themelore, të cilat ndahen në dy kategori: dokumente të përgjithshme ligjore dhe normative, të cilat, ndonëse nuk lidhen drejtpërdrejt me mësimdhënien, përbëjnë themelet e saj dhe ndikojnë në formimin e qëndrimeve profesionale të mësuesit (p.sh. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Karta Evropiane e të Drejtave të Njeriut; Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës; Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës etj.).

Dokumente specifike arsimore, që janë të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor sipas standardeve profesionale, si: Ligji për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë; Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar; si dhe Udhëzime dhe rregullore të Ministrisë së Arsimit, që lidhen drejtpërdrejt me procesin e mësimdhënie-nxënies. Njohja dhe përdorimi i këtyre dokumenteve ndihmon mësuesin të veprojë në mënyrë të ligjshme, profesionale dhe me fokus në të drejtat e nevojat e nxënësit.

Standardi 2. Përgatitja shkencore

Ky standard i kushtohet zotërimit të anës shkencore dhe artistike nga mësuesi, si parakusht themelor për cilësi në mësimdhënie. Ai kërkon që mësuesi të demonstrojë njohuri të thelluara, si në aspektin pedagogjik, ashtu edhe në atë artistik, për lëndët teorike dhe praktike, si dhe për specialitetet përkatëse të kësaj dege në fushat e kërcimit, si baleti klasik, baleti modern, vallet popullore etj.. Ai duhet të demonstrojë nivel të lartë interpretimi dhe krijimtarië në disiplinën përkatëse, duke qenë në gjendje të lidhë konceptet artistike me praktikën. Këto njohuri i mundësojnë mësuesit të aftësojë nxënësit për: ekzekutimin e koreografive; krijimin dhe interpretimin e kërcimeve; analizën kritike të vetë kërcimeve dhe të të tjerëve; interpretimin dhe vlerësimin e veprave koreografike të ndryshme.





Standardi 3. Kurrikula artistike dhe mësimdhënia

Mësuesi aplikon njohuritë pedagogjike në fushën e kërcimit, duke aftësuar nxënësit që të krijojnë, interpretojnë dhe analizojnë në mënyrë kritike koreografitë e tyre dhe të tjerëve, si dhe të interpretojnë e vlerësojnë veprat koreografike. Ky standard kërkon gjithashtu që mësuesi të demonstrojë kompetenca ndërkurrikulare si: mendimi kritik; mendimi krijues; menaxhimi i informacionit; puna e pavarur; puna në grup; dhe qëndrimet etike ndaj ngjarjeve dhe dukurive. Mësuesit duhet të zbatojnë metoda bashkëkohore të mësimdhënies të përshtatura sipas nivelit dhe moshës së nxënësve; të hartojnë plane mësimore individuale në përputhje me programin mësimor dhe nevojat konkrete të nxënësve. Këto kompetenca mund t'u kultivohen nxënësve vetëm nëse mësuesi vetë i zotëron në mënyrë të qëndrueshme.

Standardi 4. Vlerësimi

Ky standard, përmes treguesve të tij, kërkon që mësuesi të përcaktojë me saktësi nivelet e arritjeve të nxënësve, duke u bazuar në kritere të matshme dhe të qarta artistike. Treguesit kërkojnë zbatimin e kritereve objektive, të ndershme dhe transparente në vlerësimin e punës artistike dhe dokumentimin e progresit individual të nxënësve. Mësuesi duhet: të vlerësojë njohuritë teorike dhe praktike në fushën e kërcimit/baletit; të vlerësojë aftësitë e demonstruara gjatë performancave koreografike; të analizojë dhe interpretojë me saktësi vepra të ndryshme koreografike; të ofrojë reagime (feedback) të detajuara dhe konstruktive për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të nxënësve. Përmes këtij procesi, mësuesi siguron një vlerësim të drejtë, të saktë dhe të paanshëm, i cili udhëheq zhvillimin artistik dhe pedagogjik të secilit nxënës.

Standardi 5. Zhvillimi profesional dhe personal

Ky standard, përmes treguesve të tij, evidenton figurën e mësuesit cilësor, i cili përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme falë reflektimit mbi përvojën e tij të përditshme, bashkëpunimit me kolegët dhe hulumtimeve në literaturën profesionale artistike, si kombëtare, ashtu edhe ndërkombëtare. Reflektimi i mësuesit bazohet në arritjet artistike të nxënësve, me synimin e përmirësimit të tyre të vazhdueshëm. Në formimin artistik të nxënësit kontribuojnë të gjithë mësuesit e shkollës artistike, duke e bërë zhvillimin profesional dhe bashkëpunimin mes tyre faktorë thelbësorë.





Standardi 6. Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët

Ky standard kërkon nga mësuesit të demonstrojnë aftësi të zhvilluara komunikimi dhe bashkëpunimi profesional me kolegët. Mësuesi që zhvillon lëndët e kurrikulës artistike nuk është thjesht një transmetues i njohurive artistike, por edhe një anëtar aktiv i komunitetit të profesionistëve të artit, i angazhuar në të gjitha aspektet e jetës institucionale. Ky standard përfshin tregues që lidhen me: etikën profesionale, parimet e komunikimit efektiv, sjelljen respektive dhe bashkëpunimin në ekip. Këto elementë themelorë mbështesin dhe forcojnë të gjitha meritat e tjera profesionale të mësuesit.

Standardi 7. Bashkëpunimi me komunitetin

Përmes këtij standardi, mësuesit i kërkohet të ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme e produktive me komunitetin, veçanërisht me prindërit e nxënësve. Prindërit, si mësuesit e parë të fëmijës, identifikojnë talentet dhe aftësitë artistike të tij dhe përfaqësojnë aspiratat kryesore për zhvillimin e tij artistik. Për këtë arsye, ata konsiderohen partnerë të natyrshëm dhe aktivë të mësuesit. Një komunikim efektiv midis prindërve dhe mësuesit përmirëson ndjeshëm mundësitë për avancimin dhe rezultatet e nxënësve.

Standardi 8. Mjedisi mësimor

Ky standard kërkon nga mësuesit dhe drejtuesit e shkollës krijimin e mjediseve mësimore të përshtatshme me natyrën dhe kërkesat e procesit të mësimdhënies në artin e kërcimit, ku nxënësit mund të mësojnë në mënyrë aktive dhe të zhvillojnë individualitetin e tyre artistik. Një mjedis i tillë mundëson nxënësve jo vetëm të përvetësojnë përmbajtjet koreografike, por edhe të shprehin krijimtarinë inovative dhe të ndërtojnë identitetin e tyre artistik. Ai duhet të jetë funksional, i sigurt, estetikisht i stimuluar dhe i përfshirë në dinamikën e procesit edukativ-artistik.





Standardi 1. Njohja dhe zbatimi i dokumenteve arsimore

Përshkrimi i standardit

Mësuesi zotëron njohuritë e nevojshme mbi dokumentacionin që i duhet çdo mësuesi për zhvillimin e procesit mësimor në përputhje me standardet profesionale. Ky standard lidhet me njohjen dhe përdorimin e dokumenteve bazë, të domosdoshme për planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies. Mësuesi e planifikon punën e tij mbi bazën e disa dokumenteve themelore, të cilat ndahen në dy kategori: dokumente të përgjithshme ligjore dhe normative, të cilat, ndonëse nuk lidhen drejtpërdrejt me mësimdhënien, përbëjnë themelet e saj dhe ndikojnë në formimin e qëndrimeve profesionale të mësuesit (p.sh. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Karta Evropiane e të Drejtave të Njeriut; Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës; Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës etj.).

Dokumente specifike arsimore, që janë të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor sipas standardeve profesionale, si: Ligji për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë; Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar; si dhe Udhëzime dhe rregullore të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, që lidhen drejtpërdrejt me procesin e mësimdhënie-nxënies. Njohja dhe përdorimi i këtyre dokumenteve ndihmon mësuesin të veprojë në mënyrë të ligjshme, profesionale dhe me fokus në të drejtat e nevojat e nxënësit.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

1.1. Mësuesi demonstroi njohuri të qëndrueshme mbi dokumente të ndryshme.

1.1.1. Ka njohuri:

- a) për legjislacionin shqiptar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me veprimtarinë e tij;
- b) për strategjitë arsimore;
- c) mbi aktet nënligjore, urdhrat dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit që rregullojnë veprimtarinë e tij mësimore dhe pedagogjike;

1.1.2. Njeh procedurat për organizimin dhe funksionimin e institucionit arsimor.

1.1.3. Ka një kuptueshmëri të plotë mbi funksionimin e strukturave mbështetëse dhe drejtuese brenda shkollës brenda shkollës;

1.1.4. Njeh standardet profesionale të përgjithshme dhe ato të veçanta për mësuesit lëndor.





Standardi 2. Përgatitja shkencore

Përshkrimi i standardit

Mësuesi zotëron njohuri të sakta dhe të thelluara shkencore e artistike për artin e kërcimit dhe për lëndën që zhvillon. Treguesit e këtij standardi kërkojnë që mësuesi të demonstrojë njohuri të thelluara, pedagogjike dhe artistike mbi lëndë si: baleti klasik, baleti modern, vallet popullore etj. . Ai duhet të demonstrojë nivel interpretimi dhe krijimtarie në disipinën përkatëse, duke qenë në gjendje të lidhë konceptet artistike me praktikën. Gjithashtu, mësuesi njih vepra artistike dhe autorë përfaqësues nga lëvizje të ndryshme kulturore, epoka dhe kontekste historike. Ai përditëson vazhdimisht njohuritë në fushën e specialitetit përmes pjesëmarrjes në veprimtari artistike profesionale. Këto njohuri i mundësojnë atij të aftësojë nxënësit për të ekzekutuar, krijuar, interpretuar dhe analizuar në mënyrë kritike kërcime të realizuara nga vetë ata ose nga të tjerët, si dhe për të interpretuar e vlerësuar vepra të ndryshme koreografike.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

2.1. Mësuesi zotëron njohuri të qëndrueshme shkencore mbi artin e kërcimit/baletit.

Mësuesi:

2.1.1. Zotëron aftësi për të zhvilluar njohuri të qëndrueshme mbi klasën e baletit dhe lëndë të tjera të kërcimit përmes praktikimit të ushtrimeve dhe teknikave përkatëse;

2.1.2. Zotëron njohuri dhe aftësi për interpretimin e teknikave dhe stileve të kërcimeve bashkëkohore;

2.1.3. Zotëron njohuri dhe aftësi në interpretimin e valleve popullore;

2.1.4. Zotëron aftësi për të analizuar lloje të ndryshme kërcimi në aspekte e lëvizjes, periudhës historike, përmbajtjes, tematikës, stileve, metodave dhe teknikave të përdorura;

2.1.5. Transmeton njohuri të thelluara kritike dhe estetike mbi vepra të ndryshme koreografike, duke i analizuar dhe vlerësuar për karakteristikat dhe veçoritë e tyre;

2.1.6. Zotëron njohuri mbi problematikat artistike që lidhen me artet në përgjithësi dhe me kërcimin në veçanti, duke mbajtur qëndrim profesional dhe artistik.





Standardi 3. Kurrikula artistike dhe mësimdhënia

Përshkrimi i standardit

Mësuesi zotëron kurrikulën artistike dhe siguron një mësimdhënie cilësore e gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit. Kriteret e këtij standardi kërkojnë që çdo mësues, përmes lëndës që zhvillon dhe në bazë të kurrikulës artistike, të nxisë ndërtimin e kompetencave profesionale dhe artistike në kërcim, duke ofruar mundësi për zhvillim individual dhe profesional në nivele gjithnjë e më të avancuara.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

3.1 .Mësuesi demonstroi njohuri të qëndrueshme mbi kurrikulën e kërcimit.

Mësuesi:

- 3.1.1 Përafron qëllimet e kurrikulës me metodologjinë e artit të kërcimit;
- 3.1.2 Harton rezultate të matshme të të nxënësve që pasqyrojnë aftësitë artistike të nxënësve;
- 3.1.3 Motivon kreativitetin si mjet parësor për zhvillimin dhe përsosjen e aftësive artistike dhe të menduarit kritik;
- 3.1.4 Zotëron aftësi teknike dhe artistike për ta bërë orën e mësimit tërheqëse për nxënësit;
- 3.1.5 Zhvillon mësim të diferencuar, mbi bazën e mundësive fizike e intelektuale të çdo nxënësi;
- 3.1.6 Harton kërkesa të veçanta për nxënësit që përvetësojnë më shpejt programin;
- 3.1.7 Inkurajon nxënësit të vlerësojnë dhe të shprehin ndaj veprave koreografike të krijuara nga artistë të periudhave të ndryshme, përfshirë artistët shqiptarë dhe bashkëmoshatarët e tyre;
- 3.1.8 Ndërton përmes kurrikulës aftësi për të vlerësuar artin e kërcimit nga kultura, stile dhe periudha të ndryshme.

3.2. Mësuesi mbështet procesin e të nxënësve në çdo nivel të aftësive.

Mësuesi:

- 3.2.1. Zbaton teknika të përshtatshme mësimdhënieje për moshën dhe zhvillon metoda pedagogjike artistike për të maksimizuar të nxënësit;
- 3.2.2. Shfrytëzon njohuritë artistike të mëparshme të nxënësve dhe i pasuron ato më tej;





- 3.2.3. Integron metoda të ndryshme të mësimdhënies artistike për të trajtuar stile të ndryshme artistike në klasën e kërcimit/baletit;
- 3.2.4. Krijon mundësi që nxënësit të reflektojnë mbi punën e tyre, duke nxitur vetëvlerësimin;
- 3.2.5. Analizon në mënyrë kritike arritjet e nxënësve gjatë procesit mësimor;
- 3.2.6. Përdor disa burime mësimore dhe strategji të ndryshme të të nxënit për të gjithë nxënësit.

3.3. Mësuesi udhëzon nxënësit për zbatimin e praktikave të shëndetshme në rutinën e tyre.

Mësuesi:

- 3.3.1. Udhëzon nxënësit për rëndësinë e të ushqyerit në mënyrë të shëndetshme;
- 3.3.2. Nxit praktika të sigurta të kërcimit brenda dhe jashtë klasës apo sallës së baletit;
- 3.3.3. Jep udhëzime për kujdesin dhe parandalimin e lëndimeve gjatë kërcimit apo ushtrimeve.

Standardi 4. Vlerësimi

Përshkrimi i standardit

Ky standard kërkon nga mësuesi të zotërojë aftësinë për të përcaktuar saktë nivelet e arritjeve të nxënësve, nëpërmjet përdorimit të kriterëve artistike. Mësuesi duhet të vlerësojë: njohuritë artistike mbi kërcimin/baletin; aftësitë e demonstruara në performancën artistike; analizimin e veprave artistike të kërcimit/baletit. Ai evidenton një informacion të plotë mbi arritjet artistike të nxënësit, duke përdorur forma të ndryshme dhe të përshtatshme të vlerësimit për të siguruar një panoramë sa më të plotë të zhvillimit të tij.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

4.1. Mësuesi zhvillon vlerësimin në përputhje me udhëzimet përkatëse.

Mësuesi:

- 4.1.1. Siguron që kurrikula, programi mësimor, mësimdhënia dhe vlerësimi të jenë në koherencë me njëri-tjetrin, për të krijuar pritshmëri dhe standarde të qarta për nxënësin, mësuesin dhe drejtuesit e shkollës;





- 4.1.2. Ndërton kritere vlerësimi që marrin parasysh njohuritë dhe performancën e nxënësit, si në ekzekutimin e elementëve të disiplinës, ashtu edhe në shprehjen verbale dhe të shkruar;
- 4.1.3. Përshtat kritere vlerësimi që respektojnë specifikën e lëndëve të kurrikulës artistike, por gjithashtu ndihmojnë nxënësin të lidhë njohuritë me lëndë të tjera dhe me jetën e përditshme;
- 4.1.4. Ndërton kritere që tregojnë qartë përmbajtjen e veçantë të çdo lënde artistike;
- 4.1.5. Përfshin në vlerësim forma të ndryshme testimi, teorike dhe praktike, në përputhje me programin mësimor të lëndëve artistike;
- 4.1.6. Harton kritere që vlerësojnë jo vetëm aftësitë artistike, por edhe ato të mendimit kritik;
- 4.1.7. Përcakton nivele të ndryshme arritjeje të nxënësve në përputhje me kurrikulën artistike;
- 4.1.9. Ndërton kritere të bazuara në një vizion gjithëpërfshirës, duke marrë parasysh realitetin e kohës, mjetet mësimore dhe burimet njerëzore në dispozicion.

4.2. Mësuesi harton kritere të drejta, të barabarta dhe të paanshme.

Mësuesi:

- 4.2.1. Harton kritere vlerësimi të matshme dhe të zbatueshme për të gjithë nxënësit;
- 4.2.2. Siguron që kriteret të jenë të drejta dhe pa paragjykime ndaj etnisë, gjinisë, moshës, aftësive të kufizuara, fesë, dallimeve kulturore, gjuhësore apo çfarëdo lloj tjetër dallimi;
- 4.2.3. Harton kritere për mbledhjen e informacionit mbi arritjet e nxënësit në përmbushjen e objektivave të mësimi, vlerësimin e përparimit në procesin e të nxënit dhe për nxitjen e vetëvlerësimi, vendosjen e synimeve dhe përmirësimin e mëtejshëm të punës së tyre;
- 4.2.4. Harton kritere të qarta, të komunikueshme dhe lehtësisht të verifikuar nga nxënësit, në përputhje me procesin e mësimdhënies.





Standardi 5. Zhvillimi profesional dhe personal

Përshkrimi i standardit

Ky standard paraqet figurën e mësuesit cilësor, i cili angazhohet në një proces të vazhdueshëm zhvillimi profesional dhe personal. Ky zhvillim ndodh nëpërmjet reflektimit mbi përvojën e tij të përditshme, shkëmbimit me kolegët, si dhe kërkimeve në literaturën profesionale artistike shqiptare dhe ndërkombëtare. Pikënisja e reflektimit të mësuesit janë arritjet artistike të nxënësve, ndërsa qëllimi përfundimtar është përmirësimi i vazhdueshëm i këtyre arritjeve. Në formimin artistik të një nxënësi ndikojnë të gjithë mësuesit e përfshirë në jetën mësimore të shkollës artistike, çka e bën bashkëpunimin dhe zhvillimin e përbashkët profesional një domosdoshmëri.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

5.1. Mësuesi planifikon dhe ndjek vetë zhvillimin profesional dhe personal.

Mësuesi:

5.2.1. Merr pjesë në planifikimin dhe zbatimin e politikave për artet në nivel shkolle dhe institucione të tjera artistike apo arsimore;

5.2.2. Identifikon në mënyrë të vazhdueshme nevojat e tij individuale për zhvillim profesional;

5.2.3. Harton dhe zbaton planin e vet të zhvillimit profesional me synim përmirësimin e arritjeve të nxënësve;

5.2.4. Merr pjesë rregullisht në takime profesionale si ato të këshillit të mësuesve, ekipeve lëndore dhe rrjeteve sipas profilit; përgatitet seriozisht për to, kontribuon në mënyrë aktive, ndan përvoja dhe shqetësime, si dhe propozon ide të reja;

5.2.5. Studion në mënyrë të vazhdueshme literaturë profesionale nga burime të ndryshme, përfshirë ato elektronike, në gjuhën shqipe dhe të huaj;

5.2.6. Kupton ndikimin që zhvillimi profesional ka në ofrimin e një mësimdhënieje cilësore;

5.2.7. Përdor teknologjinë dhe pajisjet digjitale në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies për të rritur efektivitetin e këtij procesi;

5.2.8. Vlerëson rregullisht veten në bazë të standardeve profesionale të mësuesit dhe standardeve të kurrikulës artistike;

5.2.9. Menaxhon në mënyrë efektive kohën e punës;





5.2.10. Angazhohet në kërkime për të thelluar njohuritë mbi rolin dhe vlerat e artit të kërcimit për zhvillimin e nxënësve;

5.2.11. Merr pjesë në masterclass-e apo aktivitete të tjera profesionale që lidhen me mësimdhënien e kërcimit/baletit.

Standardi 6. Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët

Përshkrimi i standardit

Mësuesi zotëron aftësi të zhvilluara komunikimi dhe bashkëpunimi profesional me kolegët. Ai nuk është thjesht një transmetues i njohurive artistike në lëndën që zhvillon, por një pjesëtar aktiv i një komuniteti profesionistësh të artit që kontribuon në të gjitha aspektet e funksionimit të institucionit arsimor. Ky standard përfshin tregues që lidhen me etikën profesionale, parimet e komunikimit dhe sjelljen e mësuesit, të cilat përbëjnë bazën mbi të cilën ndërtohen të gjitha meritat e tjera profesionale.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

6.1. Mësuesi bashkëpunon dhe krijon një frymë pozitive me kolegët brenda dhe jashtë institucionit shkollor.

Mësuesi:

6.1.1. Bashkëpunon me kolegët për përmirësimin e punës në institucionin e shkollës koreografike;

6.1.2. Mirëpret dhe nxit ide, propozime dhe nisma për përmirësimin e kushteve të të nxënësve;

6.1.3. Propozon ose ndërmerr nisma për përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe të mësimnxënies në institucion;

6.1.4. Ndihmon mësuesit e rinj në përshtatjen dhe zhvillimin e tyre profesional;

6.1.5. Angazhohet në grupe pune, komisione lëndore dhe në ekipin e shkollës;

6.1.6. Punon për arritjen e objektivave të përbashkëta në nivel shkolle;

6.1.7. Respekton të drejtat dhe liritë e njeriut, si dhe të drejtat e fëmijëve, dhe kontribuon në krijimin e një mjedisi arsimor ku këto të drejta respektohen;

6.1.8. Krijon mjedis miqësor dhe të sigurt për nxënësit;

6.1.9. Shmang çdo formë diskriminimi, dhune, keqtrajtimi apo dëmi moral ndaj nxënësve dhe personelit;





6.1.10. Kultivon te nxënësit respektin ndaj dallimeve individuale, kulturave të ndryshme, përmes:

A) përdorimit të stileve dhe praktikave të ndryshme komunikimi me nxënësit, kolegët, prindërit etj.;

B) komunikimit të hapur, korrekt, bindës dhe frymëzues me nxënësit;

C) krijimit të një fryme komunikimi të hapur dhe të lirshëm në mjediset e të nxënësit, si ndërmjet mësuesit dhe nxënësve, ashtu edhe mes vetë nxënësve;

6.1.11. Krijon një atmosferë ku nxënësit ndihen të lirë të bëjnë pyetje, pa frikën e gabimit, dhe i inkurajon të shprehin mendimin e tyre vetjak;

6.1.12. Vepron në mënyrë transparente dhe nxit kulturën e transparencës në mjedisin arsimor;

6.1.13. Është i hapur ndaj kritikës dhe gabimeve të veta, duke nxitur një klimë reflektimi dhe përmirësimi;

6.1.14. Përdor metoda të ndryshme për negocimin, zgjidhjen e konflikteve dhe arritjen e konsensusit në marrëdhëniet me kolegët dhe nxënësit;

6.1.15. Shmang çdo konflikt interesi dhe informon drejtuesin e institucionit për situata të tilla.





Standardi 7. Bashkëpunimi me komunitetin

Përshkrimi i standardit

Ky standard kërkon nga mësuesi ndërtimin dhe ruajtjen e një marrëdhënieje të qëndrueshme dhe të frytshme me komunitetin, veçanërisht me prindërit e nxënësve. Prindërit janë mësuesit e parë të fëmijës; ata janë ata që identifikojnë më shpejt talentin dhe aftësitë artistike të tij, e kuptojnë më mirë dhe kanë pritshmëritë më të larta për zhvillimin e tij. Për këtë arsye, prindërit përbëjnë bashkëpunëtorët më të natyrshëm dhe aktivë të mësuesit. Komunikimi i rregullt, i hapur dhe konstruktiv mes mësuesit dhe prindërve është thelbësor për të rritur mundësitë e përmirësimit të arritjeve të nxënësve.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

7.1. Mësuesi bashkëpunon me artistë, prindër, kolegë dhe komunitetin.

Mësuesi:

7.1.1. Krijon një rrjet bashkëpunimi në fushën e edukimit artistik përmes kërcimit, i cili përfshin të gjitha palët e interesuara të komunitetit shkollor: nxënësit, mësuesit, prindërit, anëtarët e bordit të shkollës dhe përfaqësuesit e agjencive arsimore lokale;

7.1.2. Bashkëpunon me artistë dhe profesionistë të tjerë të artit si: organizata të arteve performuese, institucione arsimore (IAL), qendra kulturore apo komunitare, shkolla dhe shoqata kërcimi, për të krijuar mundësi që pasurojnë përvojën artistike të nxënësve dhe mësuesve;

7.1.3. Fton palët e interesuara të vizitojnë klasat e kërcimit për të parë nga afër ndikimin pozitiv që kanë programet artistike në jetën e nxënësve dhe në mjedisin shkollor;

7.1.4. Nxiti iniciativë për zhvillim profesional në bashkëpunim me universitetet, duke ftuar studiues dhe studentë të diplomuar në fushën e kërcimit dhe koreografisë, nga vendi dhe jashtë tij, për të diskutuar çështje me interes të përbashkët për artin dhe arsimin;

7.1.5. Bashkëpunon në mënyrë të qëndrueshme me të gjithë pjesëtarët e përfshirë në edukimin përmes artit të kërcimit: mësues, drejtues, prindër, artistë, me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e programit të kërcimit në shkollë;

7.1.6. Organizon performanca me nxënësit për komunitetin, në ambiente si shtëpi të të moshuarve, spitale dhe qendra komunitare, për të argëtuar dhe informuar publikun mbi rolin e edukimit përmes artit të kërcimit në jetën komunitare.





Standardi 8. Mjedisi mësimor

Përshkrimi i standardit

Ky standard kërkon nga mësuesit të krijojnë mjedise mësimore të përputhshme me natyrën dhe kërkesat e lëndëve të kërcimit, si: valle popullore, balet klasik, balet modern apo stile të tjera, në të cilat nxënësit mësojnë në mënyrë aktive dhe zhvillojnë individualitetin e tyre artistik. Mjedisi mësimor duhet të mbështesë jo vetëm përvetësimin e përmbajtjeve koreografike, por edhe krijimtarinë inovative dhe formësimin e identitetit artistik të nxënësve. Mësuesit janë përgjegjës për ndërtimin e një mjedisi të organizuar dhe të strukturuar mirë, duke e përdorur hapësirën në mënyrë funksionale dhe krijuese për të arritur objektivat mësimore. Ata duhet të përshtatin ose të modifikojnë hapësirat mësimore për të nxitur pjesëmarrjen aktive të nxënësve, duke siguruar një ambient të sigurt, të rehatshëm dhe të përshtatshëm për të mësuar. Gjithashtu, mësuesit duhet të menaxhojnë në mënyrë efikase aktivitetet në klasë dhe të përdorin mjete ndihmëse, si: rekuizita, muzikë apo materiale të tjera edukative, që e mbështesin dhe pasurojnë procesin mësimor.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

8.1 Mësuesi njih dhe zbaton standardet dhe udhëzimet për mësimdhënien në artin e kërcimit/baletit.

8.1.1. Mjediset

Dyshemeja: Është thelbësore që orët e kërcimit/baletit të zhvillohen në një ambient me dysheme të përshtatshme, me nivel të duhur fërkimi për të garantuar siguri dhe funksionalitet gjatë praktikës. Kërcimi nuk duhet të ushtrohet në sipërfaqe të papërshtatshme, pasi krijon rrezik për dëmtime fizike.

Hapësira: Sallat e baletit duhet të ofrojnë hapësirë të mjaftueshme që çdo nxënës të mund të lëvizë lirshëm dhe të ketë zonën e tij personale për ushtrime.

Dhomat e zhveshjes dhe tualetet: Duhet të jenë të ndara për djem dhe vajza dhe të vendosura pranë sallës së kërcimit, për të siguruar komoditet dhe funksionalitet për nxënësit.





8.1.2. Pajisjet

Mësuesi siguron që të jenë të përgatitura pajisjet bazë për mësimdhënie, duke përfshirë:

- *instrumente muzikore (si piano);*
- *pajisje elektronike (magnetofon, monitor, kompjuter/laptop, projektor, sistem audio);*
- *materiale ndihmëse nga biblioteka apo media (CD, DVD, libra, revista, artikuj shkencorë etj.).*

8.1.3. Orari i mësimi

Organizimi dhe shpërndarja e orëve të kurrikulës artistike bëhet në përputhje me:

- *kurrikulën e miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve;*
- *Planin Mësimor të përcaktuar për Kurrikulën Artistike të shkollës koreografike, dega Balet;*
- *orarin e hartuar nga vetë institucioni arsimor, në përputhje me kërkesat e programit mësimor.*

Shpërndarja dhe organizimi i orëve mësimore të kurrikulës artistike përcaktohet në bazë të kurrikulës së miratuar nga MAS dhe Planin Mësimor i përcaktuar për Kurrikulën Artistike të shkollës Koreografike, dega Balet, si dhe nga orari që harton vetë shkolla.

8.2. Mjedise që nxisin përgjegjësinë sociale, disiplinën personale dhe barazinë

Mësuesi:

8.2.1. Krijon një mjedis ku respektohet individi, vlerat e kërcimit dhe procesi i të nxënit;

8.2.2. Ndërtton një ambient mësimor ku inkurajohen dhe mbështeten aftësitë dhe vlerat artistike e intelektuale, si mendimi dhe shprehja krijuese, analiza dhe diskutimi kritik, vendimmarrja, pyetjet dhe demonstrimi;

8.2.3. Përfshin nxënësit në një mjedis që nxit arritje të kënaqshme në fushën e kërcimit;

8.2.4. Shpreh pritshmëri të larta për të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë;

8.2.5. Respekton mendimet dhe gjykimet artistike të nxënësve, duke inkurajuar shprehjen e pikëpamjeve të tyre individuale;

8.2.6. Garanton një qasje të drejtë dhe të barabartë për çdo nxënës gjatë procesit mësimor artistik;

8.2.7. Nxit aftësitë komunikuese përmes të cilave nxënësit shprehin idetë dhe vlerat e tyre artistike;

8.2.8. Menaxhon me zgjuarsitë situatat që mund të krijojnë pakënaqësi ose trazira në klasë;



8.2.9. Zbaton masa disiplinore me ndikim minimal në ndërprerjen e orës së mësimi.

8.3. Krijimi dhe mirëmbajtja e një mjedisi të sigurt dhe efektiv për të nxënësit

Mësuesi:

8.3.1. Krijon një mjedis të sigurt ku mund të zhvillojnë aktivitete të planifikuara, spontane dhe të ndryshme;

8.3.2. Siguron që mjedisi mësimor nuk përbën rrezik për nxënësit në asnjë rrethanë;

8.3.3. Udhëzon nxënësit për përdorimin e teknikave të sakta anatomike gjatë kërcimit, me qëllim shmangien e dëmtimeve dhe ruajtjen e shëndetit fizik, psikologjik dhe emocional.

Të tjera

Kati

Është thelbësore që klasat e kërcimit të zhvillohen mbi një dysheme të projektuar posaçërisht për këtë qëllim, me cilësi elastike dhe nivel të përshtatshëm fërkimi për të siguruar një kërcim të sigurt. Kjo nënkupton ndërtimin e një nën-dyshemeje prej druri ose strukture të ngritur druri, e cila duhet të mbulohet me një shtresë të përshtatshme sipërfaqësore. Në asnjë rrethanë nuk lejohet që nxënësit apo mësuesit të kërcenin mbi beton apo linoleum të vendosur mbi beton, pasi kjo rrit rrezikun për dëmtime fizike.

Hapësira

Nxënësve dhe mësuesve duhet t'u sigurohet një hapësirë e papenguar që lejon lëvizje të sigurt dhe të lirë nga një zonë e klasës në tjetrën. Çdo individ duhet të jetë në gjendje të lëvizë brenda hapësirës së vet personale (kinesfera), si dhe të udhëtojë lirshëm nëpër ambient. Rekomandohet një minimum prej 50 metrash katrorë për çdo nxënësit dhe mësues, për të garantuar zhvillimin e aktiviteteve pa pengesa.

Uji i pijshëm dhe tualetet

Nxënësit dhe mësuesit duhet të kenë akses të drejtpërdrejtë në ujë të pijshëm dhe në tualete të ndara për djem dhe vajza, të cilat duhet të jenë të vendosura pranë ambienteve të studios dhe sallave të performancës.

Pajisjet

Për zhvillimin efektiv të orëve mësimore, klasa duhet të jetë e pajisur me mjete ndihmëse standarde, duke përfshirë: monitor televiziv me lidhje VHS/DVD, pajisje për luajtjen e VHS/DVD, video kamera me trekëmbësh, kompjuter dhe/ose ekran inteligjent me akses



në internet, projektor LCD, sistem stereo me CD player dhe regjistruar audio me kasetë. Duhet të jetë e mundur gjithashtu përdorimi i një game të gjerë burimesh nga biblioteka ose media (si CD, DVD, kaseta VHS, libra, revista, artikuj kërkimorë etj.).

III. PJESA E TRETË: STANDARDET PROFESIONALE TË VETËVLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË MËSUESIT

Mësuesi mbart përgjegjësinë kryesore për arritjet e nxënësve të tij. Prandaj, është thelbësore që herë pas here të reflektojë mbi këtë përgjegjësi dhe të analizojë në mënyrë serioze, të detajuar dhe të përsëritur performancën personale bazuar në këto standarde. Ky proces vetëvlerësimi i ofron mësuesit një mundësi të çmuar për të identifikuar në kohë pikat e forta dhe ato që kërkojnë përmirësim. Përshkrimet më poshtë janë ndihmëse për mësuesin në këtë proces vetëvlerësimi dhe mund të orientojnë drejtuesin e institucionit në vlerësimin e performancës. Vetëvlerësimi realizohet në katër nivele, ku secilit nivel i përket një numër i caktuar pikësh. Këto nivele dhe pikët përkatëse janë:

Përshkrimi i nivelit	Niveli
Arritje shumë të mira	4
Arritje të mira që kanë nevojë për përmirësim	3
Arritje të mjaftueshme që kanë nevojë të konsiderueshme për përmirësim	2
Arritje të dobëta që kanë nevojë të domosdoshme për përmirësim	1

3.1 Përshkrimi i përgjithshëm i niveleve

Vlerësimi apo vetëvlerësimi i mësuesit është procesi gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së rezultateve nga ana e mësuesit, mbi bazën e një kriteri të caktuar. Arritja në një përfundim të saktë për nivelin e arritjes kërkon grumbullimin e vazhdueshëm të informacionit për të matur dhe për të vlerësuar të gjitha aspektet e zhvillimit profesional të mësuesit. Për të siguruar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e vlerësimit, duhet të përdoren kritere të paracaktuara dhe të qarta, gjë që realizohet përmes përdorimit të niveleve të arritjes së kompetencave profesionale. Këto nivele përfaqësojnë kritere të standardizuara për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të mësuesit në përmbushjen e standardeve profesionale.





Nivelet e hartuar ndihmojnë si vlerësuesit, ashtu edhe vetë mësuesit, për të përcaktuar me saktësi nivelin e arritjes së kompetencave profesionale. Një vlerësim rigoroz, i mbështetur në nivele të përcaktuara qartë, krijon besim në gjykimet e vlerësuesve, si dhe siguri për mësuesit dhe aktorët e tjerë se këto arritje janë në përputhje me pritshmëritë.

Niveli 4: Arritje shumë të mira

Mësuesi e planifikon të gjithë punën e tij mbi bazën e dokumenteve themelore, pa të cilat nuk do të mund të zhvillonte procesin mësimor. Ai zbaton në mënyrë të përpiktë, por edhe kreative, bazën ligjore që lidhet me punën në shkollë. Mësuesi i kushtohet zotërimit të thelluar të anës shkencore të lëndës, një parakusht pa të cilin nuk mund të pretendosh më tej. Ai njeh dhe kupton shumë mirë rëndësinë e zhvillimit të aftësive artistike dhe ndërton gjithë punën e tij mbi bazën e tyre. Mësuesi lidh kompetencat e përgjithshme artistike me ato specifike për të zhvilluar një proces aktiv të të nxënit, duke treguar se i zotëron ato.

Ai zbaton teknika artistike të larmishme dhe zhvillon aftësi ndërkurrikulare si: mendim kritik, mendim krijues, menaxhim informacioni, punë individuale e të pavarur dhe punë në grup.

Gjatë zhvillimit të mësimin, mësuesi përdor metoda dhe burime dhe të ndryshme, duke i përshtatur me veçoritë e nxënësve dhe duke nxjerrë në pah rëndësinë e sukseseve të tyre. Ai fokusohet më shumë në procesin e të nxënit sesa në produktin final, duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi. Vlerësimi është pjesë përbërëse e procesit të të nxënit. Mësuesi përdor standardet profesionale për të identifikuar nevojat e tij dhe merr pjesë në zhvillim profesional sipas nevojave për trajnim, duke qenë në një përmirësim të vazhdueshëm. Ai tregon dhe demonstroi vlerat dhe qëndrimet që lidhen me etikën dhe komunikimin, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt te formimi dhe sjellja e nxënësit. Mësuesi ka lidhje të ngushta me prindërit, bashkëpunon me ta dhe demonstroi se vlerëson mendimin e tyre për procesin e të nxënit, ecurinë e fëmijës dhe veprimtari të tjera në shkollë.

Niveli 3: Arritje të mira që kanë nevojë për përmirësim

Mësuesi e planifikon punën e tij mbi bazën e dokumenteve themelore të miratuara dhe të shpallura. Ai e zbaton këtë bazë në mënyrë të përpiktë, por ka nevojë të jetë më kreativ në interpretimin dhe përdorimin e saj në praktikën shkollë. Mësuesi ka përgatitje të mirë shkencore, një parakusht i domosdoshëm për të ecur përpara profesionalisht. Ai





përdor një numër të konsiderueshëm metodash dhe i përshtat ato me veçoritë e nxënësve. Vlerësimi zhvillohet në përputhje me legjislacionin, por mësuesi has vështirësi në përdorimin e tij si pjesë përbërëse e procesit të të nxënës. Ai njeh dhe kupton rëndësinë e zhvillimit të kompetencave kyçe dhe shpesh e ndërton punën mbi bazën e tyre. Gjithashtu, ai përpiqet të lidhë kompetencat artistike të përgjithshme me ato specifike, por ndonjëherë përballet me vështirësi në zhvillimin efektiv të tyre. Mësuesi zbaton disa teknika të nxënës për të zhvilluar aftësi ndërkurrikulare si: të menduarit kritik, të menduarit krijues, punën e pavarur dhe punën në grup. Ai përpiqet dhe merr pjesë në trajnime për të zhvilluar profesionalisht veten, por nuk fokusohet sa duhet në identifikimin e nevojave të tij për trajnim. Mësuesi demonstroi vlera dhe qëndrime që lidhen me etikën dhe komunikimin, por nuk i kushton vëmendjen e duhur ndërtimit dhe forcimit të komunikimit me nxënësit dhe aktorët e tjerë në shkollë.

Niveli 2: Arritje të mjaftueshme që kanë nevojë të konsiderueshme për përmirësim

Mësuesi njeh legjislacionin në fuqi mbi të cilin funksionojnë institucionet arsimore parauniversitare, por paraqet vështirësi në kuptimin, zbatimin dhe zhvillimin e tij në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarive në klasë dhe në shkollë.

Ai njeh një numër relativisht të kufizuar metodash artistike dhe në veprimtarinë e tij mbizotërojnë metoda që nuk nxisin mjaftueshëm bashkëpunimin dhe aktivizimin e nxënësve.

Mësuesi zhvillon procesin e vlerësimit duke respektuar legjislacionin në fuqi, por has vështirësi në përdorimin e tij si mjet motivues për nxënësit dhe si pjesë integrale e procesit të të nxënës.

Ai njeh konceptin e zhvillimit të kompetencave artistike, por përballet me vështirësi në realizimin praktik të tyre dhe në lidhjen e kompetencave artistike ndërmjet tyre. Mësuesi përpiqet dhe merr pjesë në trajnime me synim zhvillimin profesional, por nuk i kushton vëmendjen e duhur identifikimit të nevojave të tij për trajnim. Ai nuk zotëron një plan të strukturuar të zhvillimit profesional. Mësuesi njeh dhe zbaton parimet etike, por paraqet ngurtësi dhe nuk tregon përpjekje të mjaftueshme për të zhvilluar më tej komunikimin me nxënësit dhe me partnerë të tjerë të shkollës, si prindërit apo përfaqësuesit e komunitetit.

Niveli 1: Arrije të dobëta që kanë nevojë të domosdoshme për përmirësim





Mësuesi ka njohuri të pakta dhe të kufizuara mbi legjislacionin, në bazë të të cilit funksionojnë institucionet arsimore në arsimin parauniversitar. Ai paraqet përgatitje të kufizuar në drejtim të përmbajtjes shkencore të lëndës dhe trajtimit të saj gjatë veprimtarive mësimore në klasë. Mësuesi përdor një numër shumë të kufizuar teknikash dhe metodash, duke u përqendruar te ato që nuk sigurojnë ndërveprimin dhe aktivizimin e nxënësve gjatë procesit mësimor. Ai nuk bën përpjekje për të përshtatur metodat e mësimdhënies dhe të të nxënësve me nevojat specifike të nxënësve në klasën e tij. Mësuesi zhvillon procesin e vlerësimit duke respektuar legjislacionin në fuqi, por nuk bën përpjekje për motivimin e nxënësve dhe nuk e konsideron vlerësimin si pjesë të procesit të të nxënësve. Ai ka njohuri sipërfaqësore mbi zhvillimin e kompetencave kyçe dhe nuk ndërmerr hapa për zhvillimin e tyre. Mësuesi paraqet mangësi në lidhjen ndërmjet kompetencave kyçe dhe atyre lëndore. Ai merr pjesë rrallë në trajnime, vetëm në rastet kur i kërkohet me detyrim, nuk fokusohet aspak në identifikimin e nevojave të tij për trajnim dhe i mungojnë aftësitë për ta realizuar këtë proces. Mësuesi njeh parimet etike, por ka raste kur nuk i zbaton ato. Ai shpesh nuk merr parasysh parimet e komunikimit dhe nuk përpiqet të zhvillojë ose përmirësojë komunikimin me nxënësit dhe partnerët e tjerë të shkollës.

3.2 Vetëvlerësimi për standardet e përgjithshme profesionale

Mësuesi mund të vlerësojë veten për një bllok treguesish, si p.sh., për aftësitë e tij të komunikimit, ose vetëm për një standard të vetëm, ose mund të zgjedhë që të bëjë një vetëvlerësim të plotë, d.m.th. për të gjitha standardet një nga një. Vlerësimi i çdo standardi bazohet në fakte, prova dhe evidenca konkrete , si dhe në veprimtari të zhvilluara gjatë procesit mësimor.

Shembull

Standardi 6: Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët

Treguesi 6.1.: Mësuesi bashkëpunon dhe krijon një frymë pozitive me kolegët brenda dhe jashtë institucionit shkollor.

Në këtë tregues, ashtu si edhe në disa tregues të tjerë, kërkohet që mësuesi të bashkëpunojë me kolegët për përmirësimin e punës në institucionin e shkollës koreografike; të mirëpresë dhe nxisë rritjen e kolegëve, propozimet e nismat e tyre për përmirësimin e kushteve të të nxënësve; të ndihmojë mësuesit e rinj; të angazhohet për të





arritur objektiva të përbashkëta në nivel shkolle etj. Për këtë tregues, mësuesi gjykon se sa i njeh, i kupton dhe i përdor këto aftësi me kolegët, duke ndihmuar në forcimin e bashkëpunimit dhe komunikimit me ta. Nëse mësuesi është i interesuar në mënyrë të veçantë të kuptojë sa e përmbush standardin, duhet të analizojë veç e veç secilin tregues. Pastaj gjen shumën e pikëve. Këtë shumë e pjesëton me numrin e treguesve dhe rezultatin e rrumbullakos me një shifër pas presjes.

P.sh.:

Standardi 6: Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët

<i>Përshkrimi i standardit</i>		
zotëron aftësi komunikative dhe profesionale në bashkëpunimin me kolegët e tij. Mësuesi që zhvillon lëndët e kurrikulës artistike nuk është vetëm dhe thjesht mësues që jep njohuritë artistike pavarësisht lëndës, por edhe pjesëtar i një komuniteti profesionistësh artistë që interesohet dhe punon për institucionin në të gjitha aspektet e tij. Ky standard përmban tregues mbi etikën, parimet e komunikimit dhe sjelljen e mësuesit, si themele mbi të cilat ndërtohen të gjitha meritat e tjera profesionale		
<i>Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit</i>		
6.1. Mësuesit bashkëpunon dhe krijon frymë pozitive me kolegët brenda dhe jashtë institucionit shkollor.		
<i>Mësuesi:</i>		
<i>Nr.</i>	<i>Treguesi</i>	<i>Niveli</i>
6.1.1	Bashkëpunon me kolegët për përmirësimin e punës në institucionin e shkollës koreografike.	2
6.1.2	Mirëpret dhe nxit risitë e kolegëve, propozimet dhe nismat e tyre për përmirësimin e kushteve të të nxënit.	2
6.1.3	Propozon ose ndërmerr nisma për përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe të të nxënit të nxënësve në institucion.	4
6.1.4	Ndihmon mësuesit e rinj.	2
6.1.5	Punon në grupe pune, në komisione lëndore dhe në përbërje të ekipit të shkollës.	2
6.1.6	Angazhohet për të arritur objektiva të përbashkëta në nivel shkolle.	3
6.1.7	Respekton të drejtat e liritë e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve dhe është i aftë të krijojë në mjediset e të nxënit atmosferën ku respektohen këto të drejta.	3
6.1.8	Krijon një mjedis miqësor për nxënësit.	2





6.1.9	Shmang çdo formë diskriminimi, dhune, keqtrajtimi e dëm moral ndaj nxënësve dhe personelit.	2
6.1.10	Kultivon te nxënësit respektin ndaj dallimeve individuale, kulturave të etnive dhe të popujve të tjerë.	2
Vlerësimi i standardit		$24 : 10 = 2.4$

Vlerësimi i standardit “Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët” është Niveli 2.

Kur mesatarja e pikëve është nga 1 deri në 1.8, standardi vetëvlerësohet si “**Niveli 1**”. Mesatarja nga 1.9 deri në 2.5 tregon që standardi është “**Niveli 2**”. Standardi vlerësohet si “**Niveli 3**”, kur mesatarja e pikëve është nga 2.6 deri në 3.3. Ndërsa kur mesatarja e pikëve është nga 3.4 deri në 4, standardi vetëvlerësohet si “**Niveli 4**”.

Përlllogaritja e pikëve:

Shuma e pikëve: 24

Numri i treguesve: 10

Rezultati mesatar: 2.4 (rrumbullakohet në një shifër pas presjes)

Niveli i vetëvlerësimit për treguesin 6.1: 2.4

Në shembullin e mësipërm, mësuesi vlerësohet “**Niveli 2**” për standardin “**Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët**”.

IV.PJESA E KATËRT: STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT SIPAS TRE GRUPEVE TË LËNDËVE: TEORIKE ARTISTIKE, LËNDËT E TJERA TË KËRCIMIT DHE MJESHTËRISË SË KËRCIMIT

4.1. LËNDËT TEORIKE MUZIKORE

4.1.1. Historia e Baletit

Mësuesi:

- Zotëron njohuri për zhvillimin kronologjik të baletit botëror, nga periudha barok deri në baletin modern dhe kontemporan;
- Identifikon vlerat dhe veprat kryesore të baletit shqiptar dhe kontributin e artistëve shqiptarë (p.sh; Panajot Kanaçi, Agron Aliaj, Xhemil Simoni etj.);
- Bën krahasime mes shkollave të ndryshme të baletit në nivel ndërkombëtar;



- Lidh zhvillimet në artin e baletit me kontekstet historike, politike dhe kulturore;
- Përdor video, dokumentarë, intervista dhe materiale arkivore për të ilustruar mësimin;
- Inkurajon projektet kërkimore dhe punën në grupe për analiza të baleteve të njohura;
- Ndhmon nxënësit të zhvillojnë gjuhën artistike për të analizuar dhe vlerësuar një vepër baleti;
- Inkurajon mendimin kritik dhe shprehjen personale rreth zhvillimeve në artin e vallëzimit.

4.1.2. Folklori shqiptar

Mësuesi:

- Zotëron njohuri të strukturuar mbi gjinitë e folklorit shqiptar: kënga, vallja, rrëfenjat, proverbat, përrallat, mitet, besimet, ritualet, etj.;
- Ka formim të thelluar në strukturën poetike, gjuhësore dhe muzikore të folklorit;
- Analizon format dhe funksionet e folklorit sipas krahinave, dialekteve dhe grupeve etnike shqiptare (Toskë, Gegë, Arbëreshë, Çamë etj.);
- Evidenton rolin e folklorit si bartës i trashëgimisë dhe identitetit kombëtar;
- Kupton lidhjet mes folklorit dhe historisë, etnografisë, muzikologjisë, gjuhësisë dhe antropologjisë;
- Analizon ndikimin e kontekstit historik, social dhe gjeografik në krijimin dhe ruajtjen e folklorit;
- Ndërton një kurrikul të balancuar ndërmjet përmbajtjes teorike dhe aktiviteteve praktike (këndim, rrëfim, vallëzim popullor);
- Përdor metoda interaktive si: analiza tekstuale, performanca e drejtpërdrejtë, regjistrimet audio-vizive dhe krahasime meskulturore;
- Inkurajon kërkimin e nxënësve në terren (intervistim të të moshuarve, grupeve folklorike, etj.);
- Përdor arkiva digjitale, regjistrime të QKF-së, librari dhe video-dokumentarë;
- Aftëson nxënësit për të punuar me fonograme, transkriptime muzikore, ose për të ndërtuar prezantime mbi elemente të veçanta folklorike;
- Promovon vlerësimin e trashëgimisë popullore si pjesë e identitetit kombëtar dhe mjet për dialog ndërkulturor;
- Edukon nxënësin për respektin ndaj diversitetit kulturor brenda trevave shqiptare;





- Zhvillon ndjeshmëri estetike dhe kritike për vlerat artistike të folklorit;
- Frymëzon nxënësit që të marrin pjesë në festivale, ansamble folklorike apo projekte kërkimore kulturore;
- Aftëson nxënësit për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e materialeve folklorike;
- Ndhmon në hartimin e projekteve me bazë kërkimore (fusha e etnografisë, fonetikës, strukturës poetike etj.);
- Bashkëpunon me QKF, Institutin e Kulturës Popullore, shkolla artistike dhe komunitetet vendore;
- Organizon vizita studimore, punëtori kulturore dhe pjesëmarrje në ngjarje folklorike;
- Respekton burimet popullore si pasuri jo vetëm artistike, por edhe shpirtërore dhe morale e komunitetit;
- Kultivon krenari kulturore dhe ndjeshmëri sociale te brezat e rinj;
- Reflekton vazhdimisht mbi ndikimin e tij si ndërmjetësues i traditës dhe modernitetit.

4.1.3. Anatomi kërcimi

Mësuesi:

- Zotëron njohuri të detajuara për strukturën dhe funksionimin e sistemit muskulator, skeletor, artikulacioneve, ligamenteve dhe sistemit nervor në raport me lëvizjen njerëzore;
- Kupton biomekanikën e trupit gjatë ushtrimeve specifike të baletit dhe kërcimit bashkëkohor;
- Analizon lidhjen midis frymëmarrjes, qarkullimit të gjakut dhe performancës trupore në kërcim;
- Identifikon dhe shpjegon pozicionet korrekte të trupit për të maksimizuar efikasitetin e lëvizjes dhe për të parandaluar dëmtimet;
- Lidh në mënyrë direkte konceptet anatomike me teknika kërcimi si: port de bras, plié, arabesque, pirouette etj.;
- Njeh procesin e zhvillimit fizik të valltarit sipas moshës dhe përshtat ushtrimet në përputhje me fazat e rritjes;
- Përdor metoda të mësimdhënies aktive: demonstrime të drejtpërdrejta, vizualizime 3d të trupit, ushtrime ndërgjegjësimi trupor;
- Inkurajon të menduarit kritik dhe vetëreflektimin mbi mënyrën si trupi reagon ndaj ushtrimeve;





- Vlerëson fleksibilitetin, balancën, forcat muskulore dhe qëndrueshmërinë e trupit me metoda të strukturuar dhe të personalizuara;
- Mbështet zhvillimin e vetëdijes trupore të nxënësi dhe ndërgjegjësimin për mënyrën si ndikon teknika në strukturën trupore;
- Edukon nxënësin për pozicione dhe ngarkesa të sigurta në të gjitha nivelet e ushtrimeve;
- Identifikon shenjat e para të lodhjes, stresit fizik dhe traumës muskulore;
- Zbaton protokolle bazë për kujdesin emergjent, stërvitjen me kujdes dhe rehabilitimin;
- Nxit praktika të shëndetshme në ushqyerje, pushim dhe kontroll të stresit në përgatitjen fizike dhe performancë;
- Edukon për teknika ndihmëse si stretching, masazh, ushtrime të frymëmarrjes dhe mindfulness për artistët e kërcimit;
- Integron lëndë si balet klasike, balet moderne, fiziologji e trupit, psikologji e performancës;
- Bashkëpunon me specialistë të fizioterapisë, ortopedisë dhe pedagogët e lëvizjes për të siguruar një përvojë gjithëpërfshirëse mësimore;
- Përdor modele 3d të trupit të njeriut, animacione, video-analiza të lëvizjes për ta bërë të qartë dhe të kuptueshme funksionimin trupor;
- Ndiemon nxënësit të dokumentojnë përparimin e tyre fizik me mjete digjitale dhe ditar të zhvillimit personal;
- Promovon një marrëdhënie të shëndetshme dhe pozitive me trupin, duke mbështetur vetëvlerësimin dhe respektin trupor;
- Respekton kufijtë fizikë dhe emocionalë të nxënësit në çdo fazë të zhvillimit të tij;
- Angazhohet në zhvillim profesional të vazhdueshëm për të qëndruar i përditësuar mbi kërkimet më të fundit në fushën e anatomisë së vallëzimit.

4.1.4. Historia e Muzikës

Mësuesi:

- Zotëron njohuri të thelluara mbi zhvillimin kronologjik të historisë së muzikës, nga antikiteti deri në shekullin XXI;





- Identifikon karakteristikat estetike, teknike dhe shprehëse të epokave muzikore: Mesjetë, Rilindje, Barok, Klasicizëm, Romantikë, Modernizëm dhe periodha bashkëkohore;
- Ka njohuri për biografitë, veprat përfaqësuese dhe kontributet kryesore të kompozitorëve të famshëm, botërorë dhe shqiptarë;
- Kupton lidhjen ndërdisiplinore midis muzikës dhe kontekstit historik, politik, filozofik, artistik dhe teknologjik;
- Planifikon rrjedhën mësimore duke ndjekur progresionin kronologjik dhe duke i përshtatur interesave të nxënësve;
- Zbaton metoda aktive: analiza e veprës muzikore, dëgjimi i dirigjuar, krahasimi stilistik, debat dhe prezantim i projekteve individuale ose në grup;
- Përdor materiale ilustrative (audio, video, partitura, dokumente historike, burime digjitale) për të pasuruar mësimin;
- Vlerëson nxënësit përmes kombinimit të analizës estetike, dijeve faktike dhe aftësisë për të lidhur muzikën me kulturën e përgjithshme;
- Nxiti njohjen e historisë së muzikës shqiptare: forma tradicionale vokale e instrumentale, muzika kishtare dhe bektashiane, krijimtaria kombëtare e shek. XX dhe XI;
- Prezanton figurat kryesore të kompozitorëve shqiptarë, si Çesk Zadeja, Pjetër Gaci, Simon Gjoni, Feim Ibrahimi, Tonin Harapi etj.;
- Thekson lidhjet ndërkulturore të muzikës shqiptare me traditat evropiane e ballkanike;
- Nxiti analizën kritike të institucioneve muzikore shqiptare (konservatorë, opera, ansamble, RTVSH, konkurse etj.);
- Ndhmon nxënësit të zhvillojnë mendim kritik dhe estetik për të kuptuar zhvillimin e ideve muzikore në rrjedhën historike;
- Inkurajon diskutime mbi ndikimin e muzikës në shoqëri, politikë, religjion dhe formimin identitar kombëtar dhe evropian;
- Edukon shijet muzikore përmes krahasimeve stilistike dhe dëgjimit të interpretimeve historikisht të informuara.

4.1.5. Solfezh





Mësuesi:

- Zotëron shkëlqyeshëm notacionin muzikor, si dhe sistemet e ndërlikuara metroritmike;
- Interpretë me saktësi pjesë solfezhike në çelësa të ndryshëm dhe tonalitete të shumta (dur, moll, modalitete);
- Dëgjon, analizon dhe transkripton me saktësi fragmente melodike, ritmike dhe polifonike (diktim muzikor);
- Zhvillon ndjeshmërinë harmonike përmes identifikimit të intervaleve, akordeve dhe lidhjeve harmonike;
- Aftëson nxënësit për të lexuar muzikën në shikim të parë me intonacion të pastër dhe qëndrueshmëri ritmike;
- Zbaton metoda progresive të mësimdhënies që ndërtojnë nga njohuritë bazë drejt leximit të avancuar muzikor;
- Përdor mjete bashkëkohore didaktike: aplikacione digjitale, metoda interaktive, programet e trajnimit të veshit;
- Ndiemon në zhvillimin e një dëgjimi analitik dhe funksional të muzikës;
- Lidh solfezhin me praktikën muzikore të nxënësve në instrument apo këndim;
- Inkurajon analizën teorike të veprave të repertorit gjatë zbatimit të solfezhit funksional;
- Ndiemon nxënësit të përgatisin baza të forta për zhvillimin e intonacionit, frazimit dhe analizës muzikore.

4.2 LËNDËT PËR LËNDËT E TJERA ARTISTIKE

4.2.1 . Mjeshtëri e kërcimit klasik

Mësuesi:

- Zotëron njohuri të thelluara për teknikat klasike të baletit dhe variacionet stilistike (rus, italian, francez);
- Di të analizojë dhe të demonstrojë lëvizjet sipas metodikës së mësimdhënies për çdo moshë;





- Ka njohuri mbi anatomisë funksionale për baletin dhe e përdor në funksion të trajnimit të trupit në mënyrë të sigurt;
- Planifikon mësimet të strukturuar sipas niveleve të zhvillimit motor dhe artistik të nxënësve;
- Përdor metoda të ndryshme mësimore (demonstrim, analiza verbale, korrigjim individual);
- Inkurajon zhvillimin e shprehjes artistike, interpretimit dhe vetëbesimit në skenë;
- Mban marrëdhënie respektuese me nxënësit dhe mbështet zhvillimin emocional dhe fizik të tyre;
- Reflekton mbi praktikën e veta dhe është i/e gatshëm të përmirësojë aftësitë përmes trajnimeve të vazhdueshme;
- Merr pjesë në seminare, masterklasa, dhe festivale kombëtare e ndërkombëtare;
- Bashkëpunon me koreografë, muzikantë dhe mësues të tjerë për projekte ndërdisiplinore artistike.

4.2.2 Repertor skenik

Mësuesi:

- Zotëron një repertor të gjerë klasik dhe bashkëkohor nga koreografë ndërkombëtarë dhe shqiptarë;
- Ndhmon nxënësit të kuptojnë strukturën dramatike, stilistiken dhe historinë e pjesës koreografike;
- Analizon kontekstin muzikor dhe shprehës të çdo vepre për zhvillimin e interpretimit;
- Ndërton punë në grup për koordinimin skenik, shprehjen trupore dhe pasjen e një prezence profesionale;
- Edukon mbi disiplinën e punës në prova, përgatitjen emocionale dhe përballimin e skenës;
- Inkurajon nxënësit të krijojnë lidhje emocionale me personazhet dhe të transmetojnë mesazhe artistike.

4.2.3 Ushtrime të karakterit botëror

Mësuesi:

- Ka njohuri për format tradicionale të vallëzimit të karakterit: rus, hungarez, spanjoll, italian, polak etj.;





- Di të aplikojë teknikën e kërcimit karakter në stilizim baletik duke ruajtur originalitetin kulturor;
- Kupton strukturën ritmike, muzikore dhe kostumografike të çdo karakteri popullor;
- Ndhmon nxënësit të përvetësojnë stilin, qëndrimin dhe shprehjen e secilës traditë kulturore;
- Zbaton metoda ndërkulturore dhe ndihmon në krahasimin mes teknikës klasike dhe asaj të karakterit;
- Edukon për etiken e përfaqësimit të kulturave të tjera me respekt dhe saktësi.

4.2.4 Balet Modern

Mësuesi:

- Zotëron teknikat kryesore të kërcimit modern (Graham, Limon, Cunningham, Release, Contact Improvisation);
- Kupton ndërlidhjen midis forcës, gravitacionit dhe frymëmarrjes në lëvizjet moderne;
- Përdor trupin si mjet për eksplorim, improvizim dhe shprehje individuale;
- Ndhmon nxënësit të zhvillojnë fleksibilitetin, vetëdijen trupore dhe lirinë lëvizëse;
- Inkurajon kreativitetin përmes detyrave koreografike dhe eksplorimit të hapësirës;
- Edukon në shprehjen e emocioneve, ideve dhe temave bashkëkohore përmes gjuhës trupore.

4.2.5 Valle popullore

Mësuesi:

- Zotëron teknikat bazë dhe të avancuara të valleve shqiptare sipas krahinave (Tropojë, Labëri, Devoll, Myzeqe, Kosovë, Çamëri etj.);
- Kupton karakterin krahinor, ritmin, veshjen tradicionale dhe simbolikën e lëvizjeve;
- Njeh format kolektive dhe solistike të valleve, si dhe rolin e tyre në ceremonitë shqiptare;
- Edukon nxënësit për vlerësimin e trashëgimisë popullore dhe përfshirjen e saj në skenë;
- Aftëson për koreografi të valleve tradicionale dhe të stilizuara për performancë;
- Ndërthur elementë autentikë me kërkesat moderne të interpretimit artistik.





4.2.6 Duet klasik

Mësuesi:

- Zotëron teknikën klasike të kërcimit në çift (partnering), përfshirë ngritjet, rotacionet, mbështetjet dhe bashkërendimin hapësinor;
- Aftëson nxënësit për të zhvilluar ndjeshmëri ndaj partnerit, koordinim dhe siguri trupore gjatë lëvizjeve komplekse;
- Udhëzon mbi balancën, qendrën e gravitetit, teknikën e kapjes dhe komunikimin trupor në duet;
- Organizon ushtrime progresive që ndërtojnë forcën, teknikën dhe besimin ndërmjet partnerëve;
- Nxit respektin dhe etikën skenike në marrëdhënien trupore gjatë kërcimit në çift;
- Zhvillon sensibilitet artistik në interpretimin e rolit klasik përmes dueteve të repertorit.

4.2.7 Piano Sekondare

Mësuesi:

- Zotëron një nivel të mirë teknik të ekzekutimit në piano për të realizuar pjesë nga repertori pedagogjik klasik dhe bashkëkohor;
- Ekzekuton shoqërime të thjeshta për këngë ose linja melodike për instrumente të tjera;
- Ka njohuri në leximin e dy çelësave (fa dhe sol), interpretimin e akordeve, gamave dhe ushtrimeve për zhvillimin e koordinimit;
- Aftëson nxënësit për të ndjekur frazimin, dinamikën dhe shprehjen muzikore përmes piano-së;
- Përdor metoda individuale dhe kolektive për të përshtatur lëndën sipas nevojave dhe nivelit të nxënësit;
- Inkurajon përdorimin e pianos si mjet pedagogjik për të kuptuar strukturën harmonike dhe ndërtimin e formës muzikore;
- Zhvillon në mënyrë sistematike ndërtimin e teknikës themelore: pozicionimi i dorës, artikulimi, ndarja e zërit;





- Aplikon materiale ndihmëse (partitura pedagogjike, ushtrime funksionale për shoqërim);
- Ndhmon nxënësit instrumentalistë, këngëtarë apo teoricienë të përdorin pianon për analizë, shoqërim dhe harmoni praktike;
- Zhvillon autonominë në përdorimin e instrumentit si mjet ndihmës për studimin muzikor në tërësi;
- Nxit ndjeshmërinë muzikore, disiplina të studimit të rregullt dhe respekt për instrumentin.

4.2.8 Karakteristikat e mësuesit të lëndës “Puante(Vajza)”

- Zoteron njohuri të thelluara në teknikën e baletit klasik dhe në metodikën e punës me puante.
- Siguron zhvillim gradual dhe të sigurt të forcës, ekuilibrit dhe qëndrueshmërisë së këmbës dhe trupit të nxënëses.
- Zbaton metoda progresive e të individualizuara në bazë të moshës dhe nivelit të përgatitjes.
- Ka njohuri mbi anatominë e këmbës dhe parandalimin e dëmtimeve, duke garantuar siguri në orën mësimore.
- Zoteron njohuri në estetikën klasike, elegancën dhe pastërtinë teknike në çdo ushtrim dhe lëvizje.
- Jep udhëzime të qarta, korrigjon me vëmendje, durim dhe ndjeshmëri pedagogjike.
- Frymëzon nxënëset për disiplinë, këmbëngulje dhe përkushtim artistik.
- Punon në bashkëpunim me mësuesit e tjerë të baletit klasik dhe pianistët shoqërues.
- Ndjek dhe vlerëson përparimin teknik dhe artistik të nxënësve gjatë vitit shkollor.
- Është model profesional dhe etik, që transmeton dashuri, pasion dhe respekt për artin e baletit.





4.2.9 Karakteristikat e mësuesit të lëndës “Dance Historik”

- Zoteron njohuri të gjera mbi historinë e vallëzimit europian, si dhe mbi karakteristikat e stileve të ndryshme historike.
- Demonstron teknikë të saktë në lëvizjet, qëndrimet dhe qëndrueshmërinë e trupit sipas stilit të epokës përkatëse.
- Zbaton metodikë progresive në ndërtimin e bazës teknike dhe interpretative të valleve historike.
- Ndhmon nxënësit të kuptojnë lidhjen mes muzikës, kostumit, karakterit dhe stilit të vallëzimit.
- Nxit ndjeshmëri artistike, elegancë dhe qëndrueshmëri skenike në interpretim.
- Korrigjon me kujdes, qartësi dhe durim, duke respektuar ritmin individual të zhvillimit të nxënësve.
- Frymëzon nxënësit për disiplinë, bashkëpunim dhe respekt ndaj traditës kulturore.
- Punon në bashkëpunim me mësuesit e baletit klasik, modern dhe vallës popullore, për ndërtimin e formimit të plotë artistik.
- Vlerëson përparimin teknik dhe artistik të nxënësve dhe i përgatit për performanca historike e gala.
- Është model profesional, me kulturë të gjerë, pasion për historinë e artit dhe qëndrim etik në mësimdhënie.

4.2.10 Karakteristikat e mësuesit të lëndës “Teknik Djem ”

- Zotëron njohuri të thelluara në teknikën e baletit klasik për realizimin e përformancës duke përfshirë: pozicionet, kërcimet, tour-et, dhe kombinimet e forcës.
- Aplikon metodikë të strukturuar për zhvillimin gradual të forcës, ekuilibrit dhe teknikës së lartë mashkullore.
- Punon për të ndërtuar linjën, prezencën dhe qëndrimin skenik burrëror, duke ruajtur elegancën klasike.
- Nxit forcën, elasticitetin dhe qëndrueshmërinë, përmes ushtrimeve specifike të përshtatura për trupin mashkullor.
- Korrigjon me vëmendje, qartësi dhe disiplinë, duke ndihmuar çdo nxënës të arrijë nivelin teknik të kërkuar për rolet solistike dhe ansamblin.





- Edukon kontrollin e trupit, vetëbesimin dhe qëndrimin artistik, si cilësi të domosdoshme për performancën mashkullore.
- Punon në bashkëpunim me mësuesin e duetit klasik dhe të baletit klasik për të përgatitur nxënësit në role të plota skenike.
- Ndhmon në zgjerimin e repertorit teknik dhe artistik, duke i njohur nxënësit me stile të ndryshme dhe shkolla baleti.
- Motivon për disiplinë, përkushtim dhe respekt ndaj artit të baletit si profesion.
- Është model profesional dhe etik, që transmeton pasion, autoritet dhe integritet artistik në punën e përditshme.





STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT

Për shkollat artistike me status të veçantë

Dega: Muzikë

Tiranë, 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

I. PJESA E PARË: TË PËRGJITHSHME	3
1.1 Hyrje	3
1.2 Përse kanë rëndësi këto standarde?.....	3
1.3 Struktura e standardit.....	6
II. PJESA E DYTË: STANDARDET PROFESIONALE TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM ARTISTIK TË MËSUESIT	6
Standardi 1. Njohja dhe zbatimi i dokumenteve arsimore.....	7
Standardi 2. Përgatitja shkencore.....	7
Standardi 3. Kurrikula artistike dhe mësimdhënia	7
Standardi 4. Vlerësimi.....	8
Standardi 5. Zhvillimi profesional dhe personal	8
Standardi 6. Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët.....	9
Standardi 7. Bashkëpunimi me komunitetin.....	9
Standardi 8. Mjedisi mësimor	9
Standardi 5. Zhvillimi profesional dhe personal	15
Standardi 6. Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët.....	16
Standardi 7. Bashkëpunimi me komunitetin.....	17
Standardi 8. Mjedisi mësimor.....	19
III. PJESA E TRETË: STANDARDET PROFESIONALE TË VETËVLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË MËSUESIT.....	21
3.1 Përshkrimi i përgjithshëm i niveleve	21
3.2 Vetëvlerësimi për standardet e përgjithshme profesionale	24
IV. PJESA E KATËRT: : STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT SIPAS TRE GRUPE LËNDËSH: TEORIKE - ARTISTIKE, TEORIKE - PRAKTIKE, SPECIALITETET	27

I. PJESA E PARË: TË PËRGJITHSHME

1.1 Hyrje

Standardet profesionale të mësuesit të shkollës artistike me status të veçantë, dega Muzikë, përshkruajnë kriteret që priten nga mësuesi në këtë fushë. Përmes këtyre standardeve, shkolla synon të krijojë kushte dhe mundësi që nxënësi:

- të ndërtojë dhe të zhvillojë kompetencat artistike në degën Muzikë, nëpërmjet lëndëve të kurrikulës artistike: teorike artistike, praktike artistike dhe specialiteteve të ndryshme, në përputhje me nevojat dhe interesat e shoqërisë;
- të zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe të gjithanshme;
- të kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare;
- të përballë në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Standardet profesionale të mësuesit për shkollën artistike me status të veçantë kërkojnë që zhvillimi profesional i mësuesve të fokusohet fuqishëm në përmirësimin e rezultateve të nxënësve. Të gjithë mësuesve u ofrohen mundësi për të marrë pjesë aktive në zhvillimin profesional, duke u mundësuar rritje të vazhdueshme dhe përkushtim ndaj progresit dhe suksesit të nxënësve në fushën e artit muzikor. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional, i orientuar drejt standardeve dhe treguesve të matshëm, ndihmon mësuesit të përmirësohen në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të vlerësojnë ecurinë e realizimeve të tyre artistike dhe profesionale si mësues. Dokumenti i standardeve profesionale të mësuesit të shkollës artistike me status të veçantë, dega Muzikë, i hartuar nga grupi i punës dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), përmban:

1. Standardet profesionale dhe kriteret e **formimit të përgjithshëm** të mësuesit të shkollës artistike me status të veçantë, dega Muzikë;
2. Standardet profesionale dhe kriteret sipas **specifikave të kurrikulës artistike** për mësuesin, të ndara sipas lëndëve;
3. Standardet profesionale dhe kriteret për mësuesin, të ndara sipas lëndëve.

1.2 Përse kanë rëndësi këto standarde?

Rëndësia e standardeve profesionale të mësuesit për shkollën artistike me status të veçantë, dega Muzikë, qëndron në faktin se ato përshkruajnë çfarë pritët të dijë, të kuptojë, të zotërojë dhe të demonstrojë mësuesi si specialist në fushën dhe lëndën e tij,



bazuar në kurrikulën artistike. Standardet profesionale për mësuesit e shkollës artistike me status të veçantë vlejné, para së gjithash, për vetë mësuesin. Ky dokument e ndihmon atë të vlerësojë performancën e tij në mësimdhënien artistike, duke identifikuar anët e forta dhe nevojat për përmirësim, si dhe për të kuptuar më mirë progresin e tij profesional, pedagogjik dhe artistik pra, për t'u vetëvlerësuar. Përmes standardeve profesionale të mësuesit jepet një vizioni i qartë për mësimdhënien, një panoramë e objektivit ku duam të arrijmë. Ato përfshijnë një sërë treguesish të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve, si në aspektin pedagogjik ashtu edhe në atë artistik, përmes të cilave mësuesi angazhohet për të përmbushur me sukses rolin e tij. Çdo profesionist punon duke u mbështetur në këto standarde që tregojnë nivelin e kompetencës në punë. Nivelet e performancës pedagogjike dhe artistike pasqyrojnë mënyrën se si një mësues, në secilën lëndë apo specialitet të degës Muzikë, arrin të përmbushë këto standarde. Mësuesi që ka të qartë objektivin e punës, angazhohet në mënyrë të qëndrueshme për rritje dhe zhvillim profesional. Duke qenë se mësues të ndryshëm kanë nevoja dhe fusha të ndryshme trajnimi, përmbushja e standardeve i mbështet ata në progresin e tyre në karrierë dhe në procesin e kualifikimit. Mësuesi që arrin një performancë të kënaqshme dhe rezultate të larta në kualifikim ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Standardet profesionale të mësuesit në shkollat artistike me status të veçantë i vijnë në ndihmë edhe drejtuesit të institucionit arsimor për: përmbledhjen e nevojave profesionale të stafit; hartimin dhe zbatimin e planeve për zhvillim profesional. Gjithashtu, drejtuesit e shkollave i përdorin standardet për:

- vlerësimin periodik të performancës së mësuesve;
- monitorimin e përparimit të tyre profesional;
- identifikimin dhe porositjen, së bashku me mësuesit, të formave më të përshtatshme të zhvillimit profesional dhe të literaturës përkatëse për këtë qëllim.

Përzgjedhja e një mësuesi për të punuar në një institucion arsimor artistik duhet të bazohet në përgjigjen e pyetjes: **"Në çfarë mase kandidati përmbush të dyja llojet e standardeve të mësuesit, ato pedagogjike dhe ato artistike?"**

Këshilli i mësuesve, ekipet lëndore dhe komisioni psikosocial mund ti përdorin këto standarde për të përmirësuar klimën në shkollë dhe cilësinë e procesit të mësimor. Ato shërbejnë gjithashtu për të përcaktuar temat e diskutimeve profesionale dhe për të analizuar arritjet e nxënësve. Përfaqësuesit e komunitetit të shkollës, si bordi dhe këshilli i prindërve, mund t'i shqyrtojnë këto standarde për të kuptuar më mirë cilësinë e





shërbimit arsimor që ofron institucioni. Përfaqësuesit e komunitetit, si bordi i shkollës dhe këshilli i prindërve, mund të shqyrtojnë standardet për të kuptuar më mirë cilësinë e shërbimit arsimor që ofron shkolla.

Ministria e Arsimit mbështetet në këto standarde për të hartuar politikat mbarëkombëtare të zhvillimit profesional të mësuesve që zbatojnë kurrikulën artistike. Ajo i përdor standardet gjithashtu për të përgatitur udhëzime, urdhra dhe rregullore që lidhen me mësuesit. Kualifikimi dhe trajnimi i tyre bazohet pikërisht mbi këto standarde.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) identifikon nevojat për zhvillim profesional të mësuesve të artit dhe muzikës në shkollat artistike me status të veçantë, harton programe dhe module trajnimi në nivel kombëtar, si dhe përgatit modele për vlerësimin e performancës së mësuesit.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) mbështet mësuesit në përmbushjen e këtyre standardeve përmes procesit të vlerësimit të jashtëm të performancës.

Njësitë arsimore vendore (DRAP/ZVA), të mbështetura në standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe ato sipas profileve artistike, hartojnë planet e zhvillimit profesional të mësuesve dhe planifikojnë veprimtaritë e rrjeteve profesionale.

Fakulteti i Muzikës i referohet këtyre standardeve për të hartuar në mënyrë koherente standardet e formimit fillestar të mësuesve, përmes kurrikulës së formimit shkencor dhe artistik. Ky fakultet përgatit studentët jo vetëm për procesin e licencimit, por edhe për zhvillimin e tyre profesional afatgjatë.

Këshillat dhe shoqatat e mësuesve marrin parasysh të dy llojet e standardeve, për të identifikuar nevojat më të rëndësishme profesionale dhe artistike në nivel shkolle, si dhe për të planifikuar veprimtari të zhvillimit profesional dhe këshillimit për anëtarët e tyre.

OJF-të, donatorët dhe shoqatat e interesuara për zhvillimin profesional të mësuesve të arteve dhe të Muzikës, kanë nevojë për një dokument të plotë të standardeve profesionale të mësuesit të shkollave artistike. Ky dokument u mundëson të ndërtojnë bashkëpunime të suksesshme me institucionet arsimore dhe të përcaktojnë më saktë kontributet e tyre në fushën e arsimit.

1.3 Struktura e standardit

Struktura e standardit **pedagogjiko - artistik** përfshin titullin dhe përshkrimin përmbledhës të tij. Çdo standard shoqërohet me një grup treguesish të detajuar dhe të matshëm, të cilët i referohen në mënyrë të harmonizuar njohurive që duhet të zotërojë mësuesi i specialiteteve të ndryshme në artet muzikore. Këta tregues klasifikojnë aftësitë që mësuesi duhet të demonstrojë dhe pasqyrojnë qëndrimet dhe vlerat që e karakterizojnë atë gjatë procesit të mësimdhënie-nxënies në lëndët e ndryshme të kurrikulës artistike. Treguesit vlerësohen sipas niveleve përkatëse, të përshkruara në këtë dokument.

II.PJESA E DYTË: STANDARDET PROFESIONALE TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM ARTISTIK TË MËSUESIT

Standardet profesionale të formimit artistik për mësuesit e shkollave artistike me status të veçantë, dega Muzikë

Standardet profesionale për shkollat artistike, **dega Muzikë**, përshkruajnë kriteret që priten të përmbushen nga mësuesit. Këto standarde trajtojnë në mënyrë të detajuar aspektet e mësimdhënies artistike, të cilat përfshijnë:

- a) Aspektet e zbatimit të dokumenteve arsimore;
- b) Aspektet e përmbajtjes së kurrikulës artistike të degës Muzikë dhe specialiteteve përkatëse, përmes demonstrimit të njohurive dhe aftësive artistike;
- c) Zbatimin e metodologjive artistike bashkëkohore në procesin mësimor dhe krijimin e një mjedisi pozitiv që nxit kreativitetin dhe pjesëmarrjen aktive të nxënësve;
- d) Aftësinë për të aplikuar njohuritë në funksion të një vlerësimi të drejtë, objektiv dhe të paanshëm të nxënësve;
- e) Zhvillimin e aftësive për krijimin e një mjedisi të sigurt, miqësor dhe bashkëpunues, brenda dhe jashtë shkollës, në bashkëpunim me kolegët, drejtuesit dhe komunitetin.

Standardet profesionale të mësimdhënies janë gjithsej tetë (8) dhe ofrojnë kriteret specifike për mësuesit e degës Muzikë. Ato përcaktojnë nivelin e kërkuar të kompetencës profesionale në këtë fushë dhe përbëjnë bazën për vlerësimin dhe zhvillimin profesional të mësuesit, në përputhje me kërkesat e shkollave artistike me status të veçantë. Më poshtë paraqiten përshkrimet e detajuara për secilin prej këtyre standardeve:

Standardi 1. Njohja dhe zbatimi i dokumenteve arsimore

Mësuesi zotëron njohuritë e nevojshme për dokumentacionin që duhet të ketë çdo mësues i Degës Muzikë, pa të cilin zhvillimi i procesit mësimor, në përputhje me këto standarde, nuk do të ishte i mundur. Ky standard lidhet ngushtësisht me zotërimin dhe përdorimin e dokumentacionit bazë, që është i domosdoshëm për mësuesin në planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies. Mësuesi planifikon punën e tij mbi bazën e disa dokumenteve themelore, të cilat ndahen në dy kategori: ***Dokumente të përgjithshme ligjore dhe ndërkombëtare***, që ndonëse nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me procesin mësimor, përbëjnë themelet e tij, si: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Karta Evropiane e të Drejtave të Njeriut; Konventa për të Drejtat e Fëmijës; Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, etj. ***Dokumente specifike arsimore***, që janë të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor sipas standardeve profesionale, si: Ligji për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë; Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar; si dhe Udhëzime dhe rregullore të Ministrisë së Arsimit, që lidhen drejtpërdrejt me procesin e mësimdhënie-nxënies.

Standardi 2. Përgatitja shkencore

Ky standard fokusohet në zotërimin e thellë të njohurive shkencore dhe artistike nga mësuesi, një parakusht i domosdoshëm për cilësinë e mësimdhënies. Mësuesit duhet të demonstrojnë njohuri të avancuara pedagogjike dhe artistike për lëndët teorike dhe praktike artistike, si dhe për specialitetet e ndryshme të klasifikuara sipas dy degëve përkatëse. Ata zotërojnë njohuri të thelluara teorike dhe praktike në fushën e tyre (instrument, dirigjim, kompozim, teori muzikore, etj.), dhe demonstrojnë nivel të lartë interpretimi ose krijimtari në disiplinën përkatëse. Mësuesit janë të aftë të: analizojnë, interpretojnë dhe shpjegojnë vepra muzikore nga stile, epoka dhe kultura të ndryshme; përditësojnë njohuritë përmes pjesëmarrjes në veprimtari artistike dhe kërkimeve të vazhdueshme; dhe aftësojnë nxënësit për të ekzekutuar, krijuar, interpretuar dhe analizuar në mënyrë kritike vepra muzikore të realizuara vetë ose nga të tjerët.

Standardi 3. Kurrikula artistike dhe mësimdhënia

Mësuesit përdorin njohuritë pedagogjike në fushën e artit muzikor për t'i aftësuar nxënësit në: performancë, krijim, kompozim, interpretim dhe analizë kritike të veprave



artistike shqiptare dhe botërore; zbatimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies muzikore, të përshtatura sipas niveleve dhe moshës së nxënësve; zhvillimin e planeve mësimore individuale në përputhje me programin dhe nevojat e nxënësve; inkurajimin e të menduarit kritik dhe kreativitetit përmes interpretimit dhe krijimtarisë muzikore; si dhe përdorimin e mjeteve digjitale dhe teknologjisë muzikore në procesin mësimor. Mësuesit demonstrojnë gjithashtu aftësi ndërkurrikulare si: menaxhimi i informacionit artistik, puna e pavarur, puna në grup, dhe qëndrimi etik ndaj fenomeneve artistike dhe kulturore. Të gjitha këto aftësi kultivohen te nxënësit vetëm nëse mësuesi i zotëron dhe i modelon ato në praktikën e tij mësimore.

Standardi 4. Vlerësimi

Ky standard, përmes treguesve të tij, kërkon nga mësuesit hartimin e niveleve të arritjes së nxënësve në mënyrë të saktë dhe të matshme, duke përdorur kritere të qarta artistike. Çdo mësues, pavarësisht lëndës artistike që zhvillon, duhet të vlerësojë nxënësit për njohuritë e tyre artistike, për aftësitë e demonstruara dhe për interpretimin apo realizimin e veprave artistike, në përputhje me përmbajtjet e kurrikulës. Gjithashtu, treguesit e këtij standardi kërkojnë që mësuesit të: zbatojnë kritere objektive dhe të qarta për vlerësimin e performancës muzikore; të dokumentojnë progresin individual të nxënësve nëpërmjet portofolëve artistikë dhe regjistrimeve të performancave; të kryejnë vlerësime të vazhdueshme, të cilat ndihmojnë nxënësin të përmirësohet, si dhe të ndihmojnë në përgatitjen për konkurse, koncerte dhe provime për hyrje në institucionet më të larta artistike.

Standardi 5. Zhvillimi profesional dhe personal

Ky standard thekson rëndësinë e rolit të mësuesit cilësor, i cili angazhohet në një proces të vazhdueshëm përmirësimi përmes reflektimit të vetëdijshëm, përvojës së përditshme, shkëmbimit profesional me kolegët dhe kërkimeve në literaturën artistike, kombëtare dhe ndërkombëtare. Zhvillimi profesional dhe personal kërkon përfshirje aktive në veprimtari zhvillimore si: trajnime, seminare brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunim me kolegë dhe drejtues të shkollës, partneritete me institucione kulturore, si dhe reflektim të vazhdueshëm mbi përmirësimin e praktikës mësimore dhe rritjen profesionale të mësuesit si udhëheqës artistik dhe pedagogjik.

Standardi 6. Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët

Ky standard kërkon që mësuesit të zotërojnë aftësi të zhvilluara në komunikim dhe bashkëpunim profesional me kolegët. Mësuesi i lëndëve të kurrikulës artistike nuk është thjesht një transmetues njohurish, por një anëtar aktiv i një komuniteti profesionistësh, që punojnë së bashku për përmirësimin e institucionit në tërësi. Standardi përfshin tregues që lidhen me etikën profesionale, parimet e komunikimit efektiv dhe sjelljen në punë, elementë thelbësorë për ndërtimin e të gjitha cilësive të tjera profesionale dhe për ruajtjen e një kulture bashkëpunimi të shëndetshme në institucion.

Standardi 7. Bashkëpunimi me komunitetin

Ky standard nënvizon rëndësinë e ndërtimit të marrëdhënieve të qëndrueshme dhe të frytshme me komunitetin, në veçanti me prindërit e nxënësve. Prindërit janë mësuesit e parë të fëmijës, të cilët njohin dhe ndihmojnë në zhvillimin e talentit dhe aftësive të tij artistike, ndaj konsiderohen bashkëpunëtorët më të afërt dhe më të natyrshëm të mësuesit. Komunikimi i vazhdueshëm, i hapur dhe efektiv ndërmjet mësuesit dhe prindërve është thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe për ndërtimin e një partneriteti të qëndrueshëm edukues midis shkollës dhe familjes.

Standardi 8. Mjedisi mësimor

Ky standard kërkon nga mësuesit dhe drejtuesit e shkollës krijimin e mjediseve mësimore që janë në përputhje me kërkesat e mësimi dhe studimit të instrumenteve muzikore, ku nxënësit angazhohen në mënyrë aktive dhe zhvillojnë individualitetin e tyre artistik. Mjedisi mësimor duhet të mundësojë vlerësimin e llojeve të ndryshme të muzikës dhe të përkrahë formimin e një identiteti artistik personal. Mësuesit krijojnë mjedise të organizuara dhe të strukturuar mirë, duke përdorur hapësirën në mënyrë funksionale dhe krijuese. Ata përshtatin ose modifikojnë mjedisin për të nxitur pjesëmarrjen e nxënësve, duke siguruar një ambient të sigurt dhe të përshtatshëm për të mësuar. Gjithashtu, mësuesit menaxhojnë me efikasitet aktivitetet në klasë dhe përdorin mjete ndihmëse dhe materiale të ndryshme edukative që shërbejnë në funksion të mësimdhënies.

Standardi 1. Njohja dhe zbatimi i dokumenteve arsimore

Përshkrimi i standardit

Mësuesi zotëron njohuritë e nevojshme për dokumentacionin që duhet të ketë çdo mësues i Degës Muzikë, pa të cilin zhvillimi i procesit mësimor, në përputhje me këto standarde, nuk do të ishte i mundur. Ky standard lidhet ngushtësisht me zotërimin dhe përdorimin e dokumentacionit bazë, që është i domosdoshëm për mësuesin në planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies. Mësuesi planifikon punën e tij mbi bazën e disa dokumenteve themelore, të cilat ndahen në dy kategori: Dokumente të përgjithshme ligjore dhe ndërkombëtare, që ndonëse nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me procesin mësimor, përbëjnë themelet e tij, si: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Karta Evropiane e të Drejtave të Njeriut; Konventa për të Drejtat e Fëmijës; Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, etj. Dokumente specifike arsimore, që janë të domosdoshme për zhvillimin e procesit mësimor sipas standardeve profesionale, si: Ligji për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë; Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar; si dhe Udhëzime dhe rregullore të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, që lidhen drejtpërdrejt me procesin e mësimdhënie-nxënies.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

1.1. Mësuesit demonstrojnë njohuri të qëndrueshme mbi dokumente të ndryshme.

Mësuesi:

1.1.1. Ka njohuri:

- a) për legjislacionin shqiptar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me veprimtarinë e tij;
- b) mbi strategjitë kombëtare dhe institucionale për arsimin;
- c) për aktet nënligjore, urdhrat dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit që rregullojnë veprimtarinë e tij mësimore dhe pedagogjike;

1.1.2. Njeh procedurat e organizimit dhe funksionimit të institucionit arsimor.

1.1.3. Ka një kuptueshmëri të plotë të strukturave që funksionojnë në shkollë (këshilli i mësuesve, komisionet, ekipet lëndore etj.).

1.1.4. Njeh standardet profesionale të përgjithshme dhe të mësuesit lëndor.

Standardi 2. Përgatitja shkencore: Dega Muzikë

Përshkrimi i standardit

Ky standard fokusohet në zotërimin e thellë të njohurive shkencore dhe artistike nga mësuesi, një parakusht i domosdoshëm për cilësinë e mësimdhënies. Mësuesit duhet të demonstrojnë njohuri të avancuara pedagogjike dhe artistike për lëndët teorike dhe praktike artistike, si dhe për specialitetet e ndryshme të klasifikuara sipas dy degëve përkatëse. Ata zotërojnë njohuri të thelluara teorike dhe praktike në fushën e tyre (instrument, dirigjim, kompozim, teori muzikore, etj.), dhe demonstrojnë nivel të lartë interpretimi ose krijimtari në disipinën përkatëse. Mësuesit janë të aftë të: analizojnë, interpretojnë dhe shpjegojnë vepra muzikore nga stile, epoka dhe kultura të ndryshme; përditësojnë njohuritë përmes pjesëmarrjes në veprimtari artistike dhe kërkimeve të vazhdueshme; dhe aftësojnë nxënësit për të ekzekutuar, krijuar, interpretuar dhe analizuar në mënyrë kritike vepra muzikore të realizuara vetë ose nga të tjerët.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

2.1. Mësuesit demonstrojnë njohuri të qëndrueshme të anës shkencore të kurrikulës artistike.

Mësuesi:

2.1.1. Zotëron njohuri të thelluara teorike dhe praktike në fushën e tij artistike

(instrument, dirigjim, kompozim, teori muzikore, etj.);

2.1.2. Demonstron nivel të lartë interpretimi ose krijimtari në disipinën përkatëse;

2.1.3. Analizon, interpreton dhe shpjegon vepra muzikore nga stile, epoka dhe kultura të ndryshme;

2.1.4. Përditëson në mënyrë të vazhdueshme njohuritë mbi specialitetin/lëndën përmes pjesëmarrjes në veprimtari artistike, ekspozita, konkurse dhe kërkime shkencore e artistike.

Standardi 3. Kurrikula artistike dhe mësimdhënia

Përshkrimi i standardit

Mësuesit përdorin njohuritë pedagogjike në fushën e artit muzikor për t'i aftësuar nxënësit në: performancë, krijim, kompozim, interpretim dhe analizë kritike të veprave



artistike shqiptare dhe botërore; zbatimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies muzikore, të përshtatura sipas niveleve dhe moshës së nxënësve; zhvillimin e planeve mësimore individuale në përputhje me programin dhe nevojat e nxënësve; inkurajimin e të menduarit kritik dhe kreativitetit përmes interpretimit dhe krijimtarisë muzikore; si dhe përdorimin e mjeteve digjitale dhe teknologjisë muzikore në procesin mësimor. Mësuesit demonstrojnë gjithashtu aftësi ndërkurrikulare si: menaxhimi i informacionit artistik, puna e pavarur, puna në grup, dhe qëndrimi etik ndaj fenomeneve artistike dhe kulturore. Të gjitha këto aftësi kultivohen te nxënësit vetëm nëse mësuesi i zotëron dhe i modelon ato në praktikën e tij mësimore.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

3.1.Mësuesit demonstrojnë njohuri të qëndrueshme mbi kurrikulën artistike, Dega Muzikë.

Mësuesi:

- 3.1.1 Përafron qëllimet e kurrikulës artistike me metodologjinë e artit të muzikës;
- 3.1.2 Harton rezultate të matshme të procesit të nxënies, që pasqyrojnë zhvillimin e aftësive artistike të nxënësve;
- 3.1.3 Nxit kreativitetin si mjet parësor për zhvillimin dhe përsosjen e aftësive artistike dhe të mendimit kritik;
- 3.1.4 Zotëron aftësi teknike dhe artistike që e bëjnë orën e mësimi tërheqëse dhe motivuese për nxënësit;
- 3.1.5 Zhvillon mësim të diferencuar, duke marrë parasysh mundësitë fizike, intelektuale dhe stilin e të nxënësit të çdo nxënësi;
- 3.1.6 Harton kërkesa të posaçme në lidhje me programin e lëndës/specialitetit për nxënësit që e përvetësojnë atë më shpejt;
- 3.1.7 Inkurajon nxënësit të të vlerësojnë dhe të shprehin për veprat muzikore të krijuara nga artistë të periudhave të ndryshme, përfshirë artistët shqiptarë dhe bashkëmoshatarët e tyre;
- 3.1.8 Zhvillon, përmes përmbajtjes së kurrikulës artistike, aftësi për të vlerësuar muzikën në kontekste të ndryshme kulturore, stilistike dhe historike.

3.2. Mësuesit mbështesin procesin e të nxënit në çdo nivel të aftësive.

Mësuesi:

3.2.1 Zbaton teknika të përshtatshme të mësimdhënies artistike për disipinën dhe specialitetin që zotëron, si dhe zhvillon metoda pedagogjike për të maksimizuar procesin e të nxënit;

3.2.2 Shfrytëzon njohuritë e mëparshme artistike të nxënësve dhe i pasuron ato përmes praktikës dhe përvojave të reja mësimore;

3.2.3 Integron metoda të larmishme mësimore për trajtimin e teknikave artistike, në përputhje me lëndën që zhvillon;

3.2.4 Krijon mundësi që nxënësit të reflektojnë mbi punën e tyre përmes procesit të vetëvlerësimit, duke i inkurajuar të marrin përgjegjësi për të nxënit e tyre;

3.2.5 Analizon në mënyrë kritike arritjet e nxënësve gjatë procesit mësimor për të orientuar zhvillimin e tyre të mëtejshëm artistik;

3.2.6 Përdor një gamë të gjerë burimesh mësimore dhe strategji të ndryshme të të nxënit, të përshtatura për nevojat dhe aftësitë individuale të nxënësve.

3.3. Mësuesit udhëzojnë nxënësit për zbatimin e praktikave të shëndetshme në rutinën e tyre.

Mësuesi:

3.3.1. Udhëzon nxënësit për rëndësinë e ushqyerjes së shëndetshme, duke ofruar këshilla konkrete për vaktet para dhe pas ushtrimeve muzikore;

3.3.2. Nxit praktika të sigurt në të nxënit e specialiteteve muzikore, brenda dhe jashtë klasës;

3.3.3. Jep udhëzime për kujdesin ndaj vokalit (teknika të frymëmarrjes, zgjatjen e zërit) dhe parandalimin e lëndimeve në duar për instrumentistët (ushtrime çlodhëse, shtrirje, mirëmbajtje instrumenti).

Standardi 4. Vlerësimi

Përshkrimi i standardit

Ky standard, përmes treguesve të tij, kërkon nga mësuesit hartimin e niveleve të arritjes së nxënësve në mënyrë të saktë dhe të matshme, duke përdorur kritere të qarta artistike. Çdo mësues, pavarësisht lëndës artistike që zhvillon, duhet të vlerësojë nxënësit për



njohuritë e tyre artistike, për aftësitë e demonstruara dhe për interpretimin apo realizimin e veprave artistike, në përputhje me përmbajtjet e kurrikulës. Gjithashtu, treguesit e këtij standardi kërkojnë që mësuesit të: zbatojnë kritere objektive dhe të qarta për vlerësimin e performancës muzikore; të dokumentojnë progresin individual të nxënësve nëpërmjet portofolëve artistikë dhe regjistrimeve të performancave; të kryejnë vlerësime të vazhdueshme, të cilat ndihmojnë nxënësin të përmirësohet, si dhe të ndihmojnë në përgatitjen për konkurse, koncerte dhe provime për hyrje në institucionet më të larta artistike.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

4.1. Mësuesit zhvillojnë vlerësimin në procesin arsimor, duke u bazuar në udhëzimet përkatëse.

Mësuesi:

- 4.1.1. Siguron që kurrikula artistike, programi mësimor, procesi i mësimdhënies dhe ai i vlerësimit të jenë në harmoni, duke ndërtuar pritshmëri e standarde të qarta për nxënësit, mësuesit dhe drejtuesit e shkollës;
- 4.1.2. Ndërton kritere vlerësimi që marrin parasysh njohuritë dhe performancën e nxënësit, si në aspektin praktik, ashtu edhe në atë verbal dhe të shkruar;
- 4.1.3. Përgatit kritere vlerësimi që reflektojnë specifikën e lëndëve të kurrikulës artistike, duke i ndihmuar nxënësit të lidhin njohuritë me fushat e tjera dhe me jetën e përditshme;
- 4.1.4. Harton kritere që evidentojnë përmbajtjen specifike të çdo lënde artistike;
- 4.1.5. Zbaton forma të ndryshme testimi, si teorik ashtu edhe praktik, në përputhje me programin mësimor të lëndëve artistike;
- 4.1.6. Harton kritere që vlerësojnë jo vetëm aftësitë artistike, por edhe mendimin kritik të nxënësve;
- 4.1.7. Përcakton nivele të ndryshme arritjeje të nxënësve, bazuar në përmbajtjen e kurrikulës artistike;
- 4.1.8. Ndërton kritere gjithëpërfshirëse, të ndërtuara mbi realitetin bashkëkohor, duke marrë parasysh mjetet mësimore dhe burimet njerëzore në dispozicion.

4.2. Mësuesit hartojnë kritere të drejta, paanshme, të barabarta.

Mësuesi:

- 4.2.1. Harton kritere vlerësimi të matshme dhe të vlefshme për të gjithë nxënësit;

4.2.2. Siguron që kriteret e vlerësimit të jenë të drejta dhe të paanshme, pa paragjykime ndaj etnisë, gjinisë, moshës, aftësive të kufizuara, besimit, dallimeve kulturore apo gjuhësore;

4.2.3. Harton kritere për mbledhjen e informacionit mbi arritjet e nxënësit në përmbushjen e objektivave të të nxënësit, vlerëson përparimin dhe ndihmon nxënësit në vetëvlerësim, vendosjen e synimeve dhe përmirësimin e punës së tyre;

4.2.3. Harton kritere që janë të drejta, të qarta dhe lehtësisht të komunikueshme e të verifikueshme, në përputhje me procesin e mësimdhënies.

Standardi 5. Zhvillimi profesional dhe personal

Përshkrimi i standardit

Ky standard thekson rëndësinë e rolit të mësuesit cilësor, i cili angazhohet në një proces të vazhdueshëm përmirësimi përmes reflektimit të vetëdijshëm, përvojës së përditshme, shkëmbimit profesional me kolegët dhe kërkimeve në literaturën artistike, kombëtare dhe ndërkombëtare. Zhvillimi profesional dhe personal kërkon përfshirje aktive në veprimtari zhvillimore si: trajnime, seminare brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunim me kolegë dhe drejtues të shkollës, partneritete me institucione kulturore, si dhe reflektim të vazhdueshëm mbi përmirësimin e praktikës mësimore dhe rritjen profesionale të mësuesit si udhëheqës artistik dhe pedagogjik.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

5.1. Mësuesit planifikojnë vetë zhvillimin profesional dhe personal.

Mësuesi:

5.1.1. Merr pjesë aktivisht në planifikimin dhe zbatimin e politikave mbi artet, si në nivelin shkollor, ashtu edhe në institucionet e tjera kulturore dhe arsimore;

5.1.2. Identifikon në mënyrë të vazhdueshme nevojat individuale për zhvillim profesional;

5.1.3. Harton dhe zbaton planin e zhvillimit profesional me qëllim përmirësimin e arritjeve të nxënësve;

5.1.4. Merr pjesë rregullisht dhe në mënyrë aktive në takimet profesionale (këshilli i mësuesve, ekipet lëndore, rrjetet profesionale sipas profilit), duke u përgatitur seriozisht, duke ndarë përvoja, duke trajtuar çështje dhe duke sugjeruar ide të reja;

- 
- 5.1.5. Studion në mënyrë të vazhdueshme literaturë profesionale nga burime të ndryshme, përfshirë ato elektronike në gjuhën shqipe dhe të huaj;
 - 5.1.6. Kupton ndikimin që zhvillimi profesional ka mbi cilësinë e mësimdhënies;
 - 5.1.7. Përdor teknologjinë dhe pajisjet digjitale për të rritur efektivitetin e procesit të mësimdhënies dhe të të nxënit;
 - 5.1.8. Vlerëson rregullisht vetveten në përputhje me standardet profesionale të mësuesit dhe standardet e kurrikulës artistike;
 - 5.1.9. Menaxhon në mënyrë efektive kohën e punës për të maksimizuar ndikimin e saj në arritjet e nxënësve;
 - 5.1.10. Angazhohet në kërkime për të thelluar njohuritë mbi vlerat e artit muzikor;
 - 5.1.11. Merr pjesë në aktivitete të ndryshme profesionale që lidhen me mësimdhënien dhe specialitetin që përfaqëson.

Standardi 6. Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët

Përshkrimi i standardit

Ky standard kërkon që mësuesit të zotërojnë aftësi të zhvilluara në komunikim dhe bashkëpunim profesional me kolegët. Mësuesi i lëndëve të kurrikulës artistike nuk është thjesht një transmetues njohurish, por një anëtar aktiv i një komuniteti profesionistësh, që punojnë së bashku për përmirësimin e institucionit në tërësi. Standardi përfshin tregues që lidhen me etikën profesionale, parimet e komunikimit efektiv dhe sjelljen në punë, elementë thelbësorë për ndërtimin e të gjitha cilësive të tjera profesionale dhe për ruajtjen e një kulture bashkëpunimi të shëndetshme në institucion.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

6.1. Mësuesit bashkëpunojnë dhe krijojnë frymë pozitive me kolegët brenda dhe jashtë institucionit shkollor.

Mësuesi:

- 6.1.1. Bashkëpunon me kolegët për përmirësimin e funksionimit dhe cilësisë së procesit mësimor në shkollën artistike me status të veçantë;
- 6.1.2. Mirëpret dhe nxit risitë, propozimet dhe nismat e kolegëve për përmirësimin e kushteve të të nxënit;

- 
- 6.1.3. Propozon ose ndërmerr nisma për përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe të nxënit në institucion;
- 6.1.4. Mbështet dhe udhëzon mësuesit e rinj për zhvillimin e tyre profesional;
- 6.1.5. Punon në grupe pune, komisione lëndore dhe në ekipet e shkollës;
- 6.1.6. Angazhohet për arritjen e objektivave të përbashkëta në nivel institucional;
- 6.1.7. Respekton të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të fëmijëve, duke kontribuar në krijimin e një atmosfere të sigurt dhe mbështetëse në mjediset e të nxënit;
- 6.1.8. Krijon një mjedis të ngrohtë dhe miqësor për nxënësit;
- 6.1.9. Nuk ushtron asnjë formë diskriminimi, dhune, keqtrajtimi apo dëmtimi moral ndaj nxënësve dhe stafit;
- 6.1.10. Kultivon te nxënësit respektin për dallimet individuale dhe për kulturat e ndryshme, duke:
- a) përdorur stile dhe praktika të ndryshme komunikimi me nxënësit, kolegët dhe prindërit;
 - b) komunikuar në mënyrë të hapur, të qartë, bindëse dhe frymëzuese me nxënësit;
 - c) krijuar një frymë komunikimi të lirë dhe të hapur mes nxënësve dhe mësuesit, si dhe ndërmjet vetë nxënësve;
- 6.1.11. Krijon një atmosferë ku nxënësit ndihen të lirë të bëjnë pyetje, të mos kenë frikë nga gabimet, dhe të shprehin mendimet e tyre;
- 6.1.12. Është transparent në veprimtarinë e tij dhe promovon kulturën e transparencës në mjedisin shkollor;
- 6.1.13. Është i hapur ndaj kritikës dhe gabimeve të tij, duke nxitur një klimë reflektimi dhe zhvillimi personal;
- 6.1.14. Përdor metoda të ndryshme të negocimit, zgjidhjes së konflikteve dhe arritjes të së konsensusit në marrëdhëniet me kolegët dhe nxënësit;
- 6.1.15. Shmang çdo konflikt interesi dhe njofton menjëherë drejtuesit e institucionit në raste të tilla.

Standardi 7. Bashkëpunimi me komunitetin

Përshkrimi i standardit

Ky standard nënvizon rëndësinë e ndërtimit të marrëdhënieve të qëndrueshme dhe të frytshme me komunitetin, në veçanti me prindërit e nxënësve. Prindërit janë mësuesit e



parë të fëmijës, të cilët njohin dhe ndihmojnë në zhvillimin e talentit dhe aftësive të tij artistike, ndaj konsiderohen bashkëpunëtorët më të afërt dhe më të natyrshëm të mësuesit. Komunikimi i vazhdueshëm, i hapur dhe efektiv ndërmjet mësuesit dhe prindërve është thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe për ndërtimin e një partneriteti të qëndrueshëm edukues midis shkollës dhe familjes.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

7.1. Mësuesit bashkëpunojnë me artistë, prindër, kolegë të shkollës dhe komunitetin .

Mësuesi:

7.1.1. Krijon një rrjet bashkëpunimi për edukimin muzikor, duke përfshirë të gjitha palët e interesuara të komunitetit të shkollës: nxënës, prindër, kolegë mësues, anëtarë të bordit të shkollës dhe përfaqësues të institucioneve arsimore lokale;

7.1.2. Bashkëpunon me artistë dhe profesionistë të fushës së artit muzikor, përfshirë organizata muzikore performuese, institucione të arsimit të lartë (IAL), qendra komunitare dhe kulturore, shkolla e shoqata muzikore/artistike, etj., për të për të pasuruar përvojën artistike të nxënësve dhe mësuesve;

7.1.3. Fton palët e interesuara të vizitojnë orët e specialiteteve (kanto, frymorë, harqe, perkusion) për të njohur nga afër ndikimin e tyre në zhvillimin artistik të nxënësve dhe në jetën shkollore.

7.1.4. Krijon mundësi për zhvillim profesional përmes bashkëpunimit me universitete, duke ftuar studiues dhe studentë të diplomuar në muzikologji, dirigjim, kompozim dhe instrumente të ndryshme, nga brenda dhe jashtë vendit, për diskutime mbi çështje të përbashkëta të muzikës dhe arsimit;

7.1.5. Bashkëpunon vazhdimisht me pjesëtarë të përfshirë në edukimin muzikor (mësues, drejtues, prindër, artistë) për të përmirësuar dhe zhvilluar kurrikulën artistike në tërësi, si dhe programe specifike në shkollë;

7.1.6. Organizon performanca komunitare së bashku me nxënësit (në shtëpi të të moshuarve, spitale, qendra komunitare etj.) për të promovuar përmbajtjet e kurrikulës muzikore dhe për t'i afruar artin në shërbim të publikut.

Standardi 8. Mjedisi mësimor

Përshkrimi i standardit

Ky standard kërkon nga mësuesit dhe drejtuesit e shkollës krijimin e mjediseve mësimore që janë në përputhje me kërkesat e mësimiit dhe studimit të instrumenteve muzikore, ku nxënësit angazhohen në mënyrë aktive dhe zhvillojnë individualitetin e tyre artistik. Mjedisi mësimor duhet të mundësojë vlerësimin e llojeve të ndryshme të muzikës dhe të përkrahë formimin e një identiteti artistik personal. Mësuesit krijojnë mjedise të organizuara dhe të strukturuar mirë, duke përdorur hapësirën në mënyrë funksionale dhe krijuese. Ata përshtatin ose modifikojnë mjedisin për të nxitur pjesëmarrjen e nxënësve, duke siguruar një ambient të sigurt dhe të përshtatshëm për të mësuar. Gjithashtu, mësuesit menaxhojnë me efikasitet aktivitetet në klasë dhe përdorin mjete ndihmëse dhe materiale të ndryshme edukative që shërbejnë në funksion të mësimdhënies.

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

8.1 Mësuesit njohin dhe zbatojnë standardet e udhëzimet për mësimdhënien në Degën e Muzikës.

8.1.1. Mjediset/klasat/sallat:

Sigurojnë hapësira të mjaftueshme, të ngrohta dhe të pajisura me mjetet e nevojshme për zhvillimin e mësimiit dhe studimit, si individualisht ashtu edhe në grupe. Kujdesen që akustika, ndriçimi dhe mobilimi të favorizojnë një mjedis të rehatshëm dhe funksional për nxënësit dhe mësuesit.

8.1.2. Pajisjet:

Përgatitin dhe mirëmbajnë pajisjet bazë për mësimdhënie, përfshirë:

- piano, magnetofon, monitor, kompjuter/laptop, projektor, sistem audio;
- materiale të ndryshme mësimore nga biblioteka dhe media (CD, DVD, libra, revista, artikuj shkencorë, etj.).

8.1.3. Orari i mësimiit:

Organizohet në përputhje me kurrikulën e miratuar nga MAS, me planin mësimor të kurrikulës artistike të shkollës me status të veçantë (Dega Muzikë), si dhe orarin e hartuar nga vetë institucioni/shkolla në përputhje me këtë kurrikul.

8.2. Mjedise që nxisin përgjegjësinë sociale, disiplinën personale dhe barazinë.

Mësuesi:

- 8.2.1. Krijon një mjedis ku respektohet individi, vlerat e muzikës/instrumentit/kantos dhe vet procesi i të nxënit;
- 8.2.2. Krijon një mjedis të të nxënit ku inkurajohen dhe mbështeten aftësitë dhe vlerat artistike, intelektuale, si mendimi dhe shprehja krijuese, analiza dhe diskutimi kritik, vendimmarrja, pyetjet apo demonstrimi;
- 8.2.3. Përfshin nxënësit në një mjedis që nxit arritje të kënaqshme në fushën e muzikës;
- 8.2.4. Shpreh pritshmëri të barabarta për të gjithë nxënësit, pa dallim;
- 8.2.5. Respekton mendimet dhe gjykimet artistike të nxënësve, duke inkurajuar shprehjen e pikëpamjeve individuale artistike;
- 8.2.6. Garanton një qasje të drejtë dhe të barabartë për çdo nxënës gjatë procesit mësimor artistik;
- 8.2.7. Nxit aftësitë komunikuese të nxënësve, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të shprehin idetë dhe vlerat e tyre përmes krijimit artistik;
- 8.2.8. Menaxhon me zgjuarsi situatat që mund të krijojnë pakënaqësi apo trazira në klasë;
- 8.2.9. Zbaton masa disiplinore duke minimizuar ndërprerjet e orës mësimore.

8.3. Krijimi dhe mirëmbajtja e një mjedisi të sigurt dhe efektiv për procesin e të nxënit.

Mësuesi:

- 8.3.1. Krijon një mjedis të sigurt ku zhvillohen aktivitete të planifikuara, spontane dhe të ndryshme;
- 8.3.2. Siguron që mjedisi i të nxënit të mos paraqesë rrezik për nxënësit në asnjë rrethanë;
- 8.3.3. Udhëzon nxënësit në përdorimin e teknikave të studimit të shëndetshëm, me qëllim shmangien e dëmtimeve dhe ruajtjen e mirëqenies fizike, psikologjike dhe emocionale.

Të tjera:

Uji i pijshëm dhe tualetet:

Nxënësit dhe mësuesit duhet të kenë qasje të pandërprerë në ujë të pijshëm dhe në ambiente higjienike të ndara për djem dhe vajza, të vendosura pranë studios dhe hapësirave të performancës artistike.

Pajisjet:

Pajisjet standarde për mësimdhënie përfshijnë:

- monitor televiziv me lidhje VHS/DVD,
- luajtës VHS/DVD,
- videokamerë me trekëmbësh,
- kompjuter dhe/ose pllakë inteligjente me akses në internet,
- projektor LCD,
- sistem stereo me CD player dhe pajisje për regjistrim audio në kasetë,
- si dhe akses në një gamë të gjerë burimesh nga biblioteka/media (si CD, DVD, kasetë VHS, libra, revista, artikuj kërkimorë, etj.)

III. PJESA E TRETË: STANDARDET PROFESIONALE TË VETËVLERËSIMIT TË PERFORMANCËS SË MËSUESIT

Mësuesi është përgjegjës për arritjet e nxënësve të tij. Ai duhet të rishikojë periodikisht mënyrën se si përmbush këtë përgjegjësi. Një analizë serioze, e detajuar dhe e rregullt e vetes, bazuar në këto standarde, i ofron mësuesit mundësinë për të identifikuar në kohë pikat e forta dhe drejtimet që kërkojnë përmirësim. Përshkrimet e mëposhtme synojnë të mbështesin mësuesin në procesin e vetëvlerësimit dhe të orientojnë drejtuesit në vlerësimin e performancës së tij. Vetëvlerësimi kryhet në bazë të katër niveleve arritjeje, ku secilit nivel i korrespondon një numër i caktuar pikësh, si vijon:

Përshkrimi i nivelit	Niveli
Arritje shumë të mira	4
Arritje të mira që kanë nevojë për përmirësim	3
Arritje të mjaftueshme që kanë nevojë të konsiderueshme për përmirësim	2
Arritje të dobëta që kanë nevojë të domosdoshme për përmirësim	1

3.1 Përshkrimi i përgjithshëm i niveleve

Vlerësimi dhe vetëvlerësimi i mësuesit janë procese të mbledhjes së të dhënave dhe të gjyqimit mbi arritjet e tij, në bazë të kriterëve të përcaktuar. Arritja e një konkluzioni të besueshëm kërkon grumbullimin e informacionit në mënyrë të vazhdueshme, për të matur dhe vlerësuar të gjitha aspektet e zhvillimit profesional. Për të garantuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e vlerësimit, përdoren kriterë të unifikuar, të



shpallura më parë, të shprehur përmes katër niveleve arritjeje të kompetencave profesionale. Këto nivele përcaktojnë qartë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që lidhen me standardet profesionale. Përdorimi i një sistemi të strukturuar vlerësimi lejon që si vlerësuesit, ashtu edhe mësuesit, të gjykojnë në mënyrë të saktë performancën në përputhje me pritshmëritë institucionale, duke krijuar besim, siguri dhe transparencë në komunitetin arsimor.

Niveli 4: Arritje shumë të mira

Mësuesi planifikon të gjithë procesin mësimor mbi dokumentet themelore që garantojnë zhvillimin e qëndrueshëm të nxënësve, duke zbatuar me përpikëri dhe kreativitet bazën ligjore përkatëse. Ai zotëron në thellësi aspektet shkencore dhe artistike të lëndës, duke kuptuar rëndësinë themelore të zhvillimit të aftësive artistike, dhe ndërton mësimin mbi këtë themel, duke integruar kompetencat e përgjithshme dhe ato specifike në një proces gjithëpërfshirës të të nxënësve, që reflekton zotërimin e plotë të këtyre aftësive. Përmes një game të pasur teknikash artistike, mësuesi nxit zhvillimin e aftësive ndërkurrikulare, si: mendimin kritik dhe krijues, menaxhimin e informacionit, punën e pavarur dhe atë në grup. Gjithashtu, ai përdor metoda e burime të ndryshme mësimore, të përshtatura me nevojat individuale të çdo nxënësi, duke e vendosur suksesin e tyre në qendër të vëmendjes. Në vlerësim, mësuesi fokusohet tek progresi dhe procesi i të nxënësve, jo vetëm tek produkti përfundimtar: ai aplikon një gamë të gjerë teknikash vlerësimi dhe e shndërron vetëvlerësimin në një mjet mësimor. Duke u mbështetur në standardet profesionale, ai identifikon vazhdimisht nevojat e veta për zhvillim dhe merr pjesë rregullisht në trajnime dhe aktivitete profesionale, me synim përmirësimin e pandërprerë të praktikave të tij. Gjithashtu, mësuesi demonstroi vlera të forta profesionale dhe etikë komunikimi, të cilat ndikojnë në formimin dhe sjelljen e nxënësve. Ai kultivon marrëdhënie të ngushta dhe të qëndrueshme me prindërit, bashkëpunon në mënyrë konstruktive me ta dhe respekton mendimet e tyre lidhur me procesin mësimor, zhvillimin e fëmijës dhe veprimtaritë shkollore.

Niveli 3: Arritje të mira që kanë nevojë për përmirësim

Mësuesi planifikon punën e tij mbi bazën e dokumenteve themelore, të miratuara dhe të shpallura. Ai zbaton ato me përpikëri, por duhet të jetë më kreativ në interpretimin e kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë shkollore. Mësuesi ka përgatitje të mirë shkencore, parakusht i domosdoshëm për çdo pretendim të mëtejshëm. Ai përdor një



numër të konsiderueshëm metodash dhe i përshtat ato me veçoritë individuale të nxënësve. Mësuesi zhvillon vlerësimin sipas legjislacionit, por has vështirësi në integrimin e tij në procesin e të nxënësve. Mësuesi njih dhe kupton dobësi e zhvillimit të kompetencave artistike dhe shpesh ndërton punën e tij mbi këtë bazë. Ai lidh kompetencat artistike të përgjithshme me ato specifike, ndërsa herë pas here paraqet vështirësi në zhvillimin e tyre. Mësuesi zbaton disa teknika mësimore për të fuqizuar aftësitë ndërkurrikulare si: mendimin kritik, mendimin krijues, menaxhimin e informacionit, punën e pavarur dhe punën në grup. Ai merr pjesë në trajnime me synim zhvillimin e tij profesional, por nuk fokusohet mjaftueshëm në identifikimin e nevojave për trajnim. Mësuesi demonstroi vlera dhe qëndrime profesionale në aspektin etik dhe komunikues, por nuk kushton vëmendje të mjaftueshme zhvillimit të komunikimit me nxënësit dhe me aktorët e tjerë të komunitetit shkollor.

Niveli 2: Arritje të mjaftueshme që kanë nevojë të konsiderueshme për përmirësim

Mësuesi ka njohuri bazë mbi legjislacionin në fuqi që rregullon funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, por shfaq vështirësi në interpretimin, zbatimin dhe integrimin e tij në mënyrë efektive në procesin mësimor dhe veprimtarinë shkollore. Ai përdor një gamë të kufizuar metodash artistike dhe priret të mbështetet te metoda tradicionale, të cilat nuk stimulojnë bashkëpunimin, pjesëmarrjen aktive apo mendimin kritik të nxënësve. Procesi i vlerësimit zbatohet në përputhje me kërkesat ligjore, por mësuesi ka vështirësi në përdorimin e vlerësimit si mjet për nxitjen e të nxënësve dhe për rritjen e motivimit të nxënësve. Ai është në dijeni të rëndësisë së zhvillimit të kompetencave artistike, por përballlet me sfida në zbatimin praktik të tyre dhe në integrimin koherent të kompetencave të përgjithshme me ato specifike. Mësuesi merr pjesë herë pas here në trajnime profesionale, por nuk demonstroi përkushtim të qëndrueshëm ndaj zhvillimit të tij profesional. Ai nuk ka një plan të qartë dhe të strukturuar për përmirësimin e aftësive të tij dhe nuk identifikon me vetëdije nevojat për zhvillim të mëtejshëm profesional. Në aspektin etik dhe komunikues, mësuesi njih parimet bazë të etikës profesionale, por sjellja e tij është shpeshherë formale dhe e ngurtë. Ai nuk tregon përpjekje të mjaftueshme për të ndërtuar dhe zhvilluar marrëdhënie efektive komunikimi me nxënësit, prindërit dhe komunitetin, gjë që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përfshirjen dhe mbështetjen e nxënësve gjatë procesit mësimor.



Niveli 1: Arrije të dobëta që kanë nevojë të domosdoshme për përmirësim

Mësuesi ka njohuri të pakta dhe të kufizuara për legjislacionin mbi të cilin funksionojnë institucionet arsimore në arsimin parauniversitar. Ai ka përgatitje të kufizuar në drejtim të përmbajtjes shkencore të lëndës dhe trajtimit të saj gjatë veprimtarive mësimore në klasë. Mësuesi përdor një numër shumë të kufizuar teknikash dhe metodash, duke u përqendruar te ato që nuk sigurojnë ndërveprim dhe aktivizim të nxënësve gjatë orës së mësimi. Ai nuk bën përpjekje për të përshtatur metodat e mësimdhënies dhe të të nxënësit me nevojat specifike të nxënësve në klasën e tij. Procesin e vlerësimit e zhvillon në përputhje me legjislacionin në fuqi, por nuk ndërmerr asnjë hap për të motivuar nxënësit dhe nuk e konsideron vlerësimin si pjesë integrale të procesit të të nxënësit. Mësuesi merr pjesë rrallë në trajnime dhe vetëm në rastet kur kjo është e detyruar; nuk përqendrohet në identifikimin e nevojave personale për zhvillim profesional dhe i mungon aftësia për ta organizuar procesin e vetëzhvillimit. Edhe pse njeh parimet bazë etike, shpeshherë nuk i zbaton ato në praktikë. Gjithashtu, ai nuk i kushton vëmendje parimeve të komunikimit dhe nuk bën përpjekje të mjaftueshme për të përmirësuar ndërveprimin me nxënësit dhe partnerët e tjerë të shkollës.

3.2 Vetëvlerësimi për standardet e përgjithshme profesionale

Mësuesi mund të realizojë vetëvlerësimin për një bllok të caktuar treguesish (p.sh., për aftësitë e komunikimit), për një standard të vetëm, ose të kryejë një vetëvlerësim tërësor që përfshin të gjitha standardet, një nga një.

Vlerësimi duhet të mbështetet në fakte, prova, evidenca konkrete dhe veprimtari reale të zhvilluara nga mësuesi në kuadër të ushtrimit të detyrës së tij profesionale.

Shembull:

Standardi 6: Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët

Treguesi 6.1: Mësuesi bashkëpunon dhe krijon një frymë pozitive me kolegët, brenda dhe jashtë institucionit shkollor.

Ky tregues, si dhe disa të tjerë të ngjashëm, kërkon që mësuesi: të bashkëpunojë për përmirësimin e punës në institucionin arsimor artistik; të mirëpresë dhe nxisë risitë dhe propozimet kolegëve; të ofrojë mbështetje për mësuesit e rinj në zhvillimin e tyre profesional; të angazhohet në arritjen e objektivave të përbashkëta në nivel shkolle, etj. Në këtë kontekst, mësuesi duhet të gjykojë nëse i njeh, i kupton dhe i zbaton këto aftësi

dhe sjellje në marrëdhëniet me kolegët, duke kontribuar në forcimin e bashkëpunimit dhe të komunikimit profesional.

Nëse mësuesi është i interesuar të kuptojë në mënyrë të detajuar se sa mirë e përmbush një standard, ai mund të analizojë secilin tregues në mënyrë të veçantë. Pasi të ketë vlerësuar të gjithë treguesit që përbëjnë një standard, ai bën shumën e pikëve dhe e pjesëton me numrin total të treguesve. Rezultati rrumbullakoset me një shifër pas presjes dhjetore.

Standardi 6: Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët

<i>Përshkrimi i standardit</i>		
zotëron aftësi komunikative dhe profesionale në bashkëpunimin me kolegët e tij. Mësuesi që zhvillon lëndët e kurrikulës artistike nuk është vetëm dhe thjesht mësues që jep njohuritë artistike pavarësisht lëndës, por edhe pjesëtar i një komuniteti profesionistësh artistë që interesohet dhe punon për institucionin në të gjitha aspektet e tij. Ky standard përmban tregues mbi etikën, parimet e komunikimit dhe sjelljen e mësuesit, si themele mbi të cilat ndërtohen të gjitha meritat e tjera profesionale		
<i>Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit</i>		
6.1. Mësuesit bashkëpunon dhe krijon frymë pozitive me kolegët brenda dhe jashtë institucionit shkollor.		
<i>Mësuesi:</i>		
<i>Nr.</i>	<i>Treguesi</i>	<i>Niveli</i>
6.1.1	Bashkëpunon me kolegët për përmirësimin e punës në institucion e shkollës artistike.	2
6.1.2	Mirëpret dhe nxit risitë, propozimet dhe nismat e kolegëve për përmirësimin e kushteve të të nxënit.	2
6.1.3	Propozon ose ndërmerr nisma për përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe të nxënies në institucion.	4
6.1.4	Ndihmon mësuesit e rinj	2
6.1.5	Punon në grupe pune, në komisione lëndore dhe në përbërje të ekipeve funksionale të shkollës.	2
6.1.6	Angazhohet për të arritur objektiva të përbashkëta në nivel shkolle.	3
6.1.7	Respekton të drejtat e liritë e njeriut dhe të fëmijëve, duke krijuar atmosferë ku këto të drejta respektohen.	3

6.1.8	Krijon një mjedis miqësor dhe mbështetës për nxënësit.	2
6.1.9	Nuk ushtron diskriminim, dhunë, keqtrajtim apo dëm moral ndaj nxënësve dhe personelit.	2
6.1.10	Kultivon tek nxënësit respektin për dallimet individuale, për kulturat e ndryshme dhe për etnitë e tjera.	2
<i>Vlerësimi i standardit</i>		$24 : 10 = 2.4$

Mesatarja = $24 \div 10 = 2,4$

Përfundimi: Ky rezultat korrespondon me Nivelin 2 ("Arritje të mjaftueshme që kanë nevojë të konsiderueshme për përmirësim").

Vlerësimi i standardit "Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët" është në Nivelin 2.

Kur mesatarja e pikëve varion nga 1 deri në 1,8, standardi vetëvlerësohet në Nivelin 1.

Mesatarja nga 1,9 deri në 2,5 përkon me Nivelin 2.

Standardi vlerësohet në Nivelin 3 kur mesatarja është nga 2,6 deri në 3,3.

Kur mesatarja e pikëve luhet nga 3,4 deri në 4, standardi vetëvlerësohet në Nivelin 4.

Në shembullin e mësipërm, mësuesi vetëvlerësohet në Nivelin 2 për standardin "Bashkëpunimi dhe komunikimi me kolegët."



IV.PJESA E KATËRT: STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT SIPAS TRE GRUPE LËNDËSH: TEORIKE - ARTISTIKE, TEORIKE – PRAKTIKE, SPECIALITETET

4.1 Lëndët teorike muzikore (Historia e Muzikës)

Mësuesi:

- Zotëron njohuri të thelluara mbi zhvillimin e muzikës, përfaqësuesve dhe veprave muzikore;
- Njeh epokat historike të muzikës dhe veprat më përfaqësuese, duke nxitur mendimin kritik dhe krijues tek nxënësit;
- Transmeton njohuri të thelluara kritike dhe estetike për veprat muzikore, duke i analizuar dhe vlerësuar për karakteristikat dhe veçoritë e tyre;
- Përdor materiale audio dhe vizuale për konkretizimin e koncepteve muzikore;
- Zbaton teknika aktive të të nxënit si: analiza, debati, pyetjet hulumtuese;
- Ndhmon nxënësin të krijojë lidhje të qarta ndërmjet teorisë dhe interpretimit muzikor;
- Përdor teste që përfshijnë pyetje të hapura, analiza veprash dhe diktate të niveluara;
- Zotëron njohuri për problematika artistike në përgjithësi dhe në muzikë në veçanti, duke ruajtur një qëndrim profesional dhe estetik të qëndrueshëm;
- Përfshin vetëvlerësimin dhe bashkëvlerësimin si pjesë të rëndësishme të procesit mësimor.

4.2.Lëndët teorike artistike (Solfezh, Harmoni, Analizë Muzikore, Kor, Ansambël, etj.)

Mësuesi:

- Udhëzon nxënësit të lexojnë me saktësi ritmike dhe intonacionale materialet muzikore;
- Ndhmon në zhvillimin e veshit muzikor përmes ushtrimeve sistematike të diktatit;
- Zhvillon aftësitë analitike për të kuptuar dhe analizuar struktura formale dhe harmonike në kohë reale;
- Përdor materiale të niveluara dhe individualizon detyrat sipas nevojave dhe aftësive të nxënësve;
- Monitoron progresin praktik të nxënësve dhe ndërhyr aty ku identifikon vështirësi;

- Përdor ushtrime kreative që stimulojnë improvizimin, interpretimin dhe përfshirjen aktive të nxënësve;
- Përdor programe të specializuara si: Sibelius, Finale, Earmaster, etj. në funksion të mësimdhënies dhe përgatitjes së nxënësve;;
- Regjistron dhe analizon interpretimet e nxënësve me qëllim ofrimin e feedback-ut konstruktiv;
- Inkurajon përdorimin e platformave online për përgatitje shtesë dhe zhvillim të pavarur artistik.

4.3. SPECIALITETET (A+B+C+D)

A. Specialitetet Frymore (flaut, klarinetë, oboe, fagot, saksofon, etj.)

A. 4.3.1. Zhvillimi teknik dhe intonativ

Mësuesi:

- Udhëzon nxënësin për frymëmarrje diafragmatike, kontroll të frymës dhe përdorimin efektiv të diafragmës;
- Ndhmon në vendosjen e duhur të embouchure dhe në artikulimin korrekt (tonguing, staccato, legato);
- Përdor ushtrime të përditshme për zhvillimin e gamave, intervaleve dhe fleksibilitetit teknik;
- Punon për përmirësimin e intonacionit në të gjitha regjistrat dhe për stabilitetin e tingullit;
- Monitoron qëndrimin e trupit dhe pozicionin e duarve për të shmangur lodhjen apo tendosjen gjatë interpretimit.

A. 4.3.2. Zhvillimi interpretativ dhe stilistik

Mësuesi:

- Analizon frazimin muzikor dhe udhëzon në ndërtimin logjik të frazave;
- Shpjegon stilin dhe karakterin e veprës në përputhje me kontekstin historik dhe estetik të epokës muzikore;
- Udhëzon në përdorimin e dinamikës dhe artikulacionit si mjete të shprehjes emocionale;
- Nxit vetëvlerësimin dhe dëgjimin kritik përmes regjistrimeve të interpretimit;
- Përgatit nxënësin për interpretime publike si koncerte, provime dhe konkurse.

B. Specialiteti Kordofonë (violinë, violë, violonçel, kontrabas, harpë)

B.4.3.1. Teknikë instrumentale dhe qëndrim korrekt

Mësuesi:

- Udhëzon për pozicionin e duhur të trupit dhe dorës së majtë për të siguruar intonacion të qëndrueshëm;
- Zhvillon teknikën e harkimit, duke punuar mbi drejtimin e harkut, presionin, shpejtësinë dhe kontrollin e tingullit;
- Përdor ushtrime të përditshme për të përmirësuar lëvizshmërinë e gishtave dhe koordinimin e përgjithshëm;
- Ndhmon nxënësin në orientimin në pozicione të ndryshme dhe në përdorimin teknik të vibratos;
- Jep udhëzime për mirëmbajtjen dhe akordimin e instrumentit.

B.4.3.2. Ekspresiviteti interpretativ

Mësuesi:

- Analizon strukturën muzikore të veprës për të ndërtuar një frazim emocional të qëndrueshëm;
- Përdor shembuj referencë nga interpretimet e mjeshtrove për të ndihmuar zhvillimin e ndjeshmërisë estetike të nxënësit;
- Udhëzon në përshtatjen stilistike të interpretimit në përputhje me periudhën historike dhe natyrën e veprës muzikore;
- Ndhmon në zhvillimin e identitetit interpretativ personal të nxënësit dhe në formimin e stilit individual të shprehjes;
- Përgatit nxënësin për përfshirje aktive në formacione ansambli dhe orkestra.

C. Specialiteti Perkusion - me goditje (bateri, vibrafon, ksilofon, timpan, etj.)

C.4.3.1. Zotërimi i teknikave bazë dhe të avancuara

Mësuesi:

- Udhëzon nxënësin për mbajtjen korrekte të shkopinjve dhe pozicionimin e saktë të trupit gjatë interpretimit;
- Përdor metoda të ndryshme për mësimin e goditjeve të pastra, të kontrolluara dhe të qëndrueshme në instrumentet e goditjes;

- Ndhmon në zhvillimin e ndjesisë ritmike, sinkopimit dhe koordinimit të gjymtyrëve, duke përfshirë goditje të ndara dhe të kombinuara;
- Përdor ushtrime të fokusuara në kontrollin e dinamikave, nga pianissimo në fortissimo, në të gjitha regjistrat ritmikë;
- Ofron ushtrime specifike për çdo instrument goditës, përfshirë teknika të avancuara si rolls (dridhje), flams, dhe paradiddles.

C.4.3.2. Ndërveprimi ansambli dhe ekzekutimi

Mësuesi:

- Përdor partitura ansambli për të udhëzuar nxënësin në ndjekjen e dirigjentit dhe në bashkëveprimin efektiv me kolegët gjatë interpretimit në grup;
- Ndhmon në zhvillimin e saktësisë ritmike dhe sinkronizimit në grup;
- Simulon situata reale interpretimi për të forcuar vetëbesimin skenik dhe ndërveprimin muzikor në kushte koncertale;
- Analizon rolin dhe funksionin e instrumentit goditës në orkestër apo ansambël;
- Inkurajon përgjegjësinë individuale për instrumentin, si dhe zhvillimin e disiplinës kolektive në mjedise profesionale muzikore.

D. Specialiteti Kanto

D.4.3.1. Teknika vokale dhe higjiena e zërit

Mësuesi:

- Udhëzon nxënësin në frymëmarrjen diafragmatike, të thellë dhe të kontrolluar, si themel i teknikës vokale të qëndrueshme;
- Ndhmon në zhvillimin e rezonancës vokale dhe përdorimin e maskës vokale;
- Udhëzon për artikulum të pastër dhe përdorim të saktë të gjuhës në përputhje me kërkesat vokale të veprës;
- Jep këshilla për ruajtjen e higjienës vokale, përfshirë ushtrime para interpretimit dhe shmangien e tendosjes vokale;
- Ndhmon në kalimin teknik dhe të sigurt mes regjistrave vokale (chest voice, head voice, belcanto, etj.).

D.4.3.2. Interpretimi dhe ndjeshmëria emocionale

Mësuesi:

- 
- Analizon tekstin poetik dhe përbërësit muzikorë për të ndihmuar nxënësin në interpretimin e thelluar emocional dhe kuptimor të veprës;
 - Ndiemon në zhvillimin e frazimit dhe përdorimin e nuancave vokale;
 - Inkurajon lidhjen e natyrshme midis fjalës dhe muzikës, duke nxitur një interpretim emocionalisht autentik dhe të singertë;
 - Përdor regjistrime vokale për analizë, krahasim dhe vetëreflektim mbi përmirësimin e interpretimit;
 - Përgatit nxënësin për interpretim skenik të sigurt, si dhe për menaxhimin emocional të prezantimit publik në koncerte, provime apo konkurse.